



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 70/2021 regjistër (JR)
Datë 16.11.2021

Nr. 18 i vendimit
Datë 30.04.2024

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 30.04.2024, ditën e martë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 417, datë 08.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Pika 5 e nenit 179/b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, Dh, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, në aktet e paraqitura para seancës, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex-officio*, për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarës pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”).
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka zhvilluar hetimin administrativ për 3 (tri) kriteret e rivlerësimit, përkatësisht për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe të aftësive profesionale. Në zbatim të përcaktimeve të neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), sipas neneve 31 – 33 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), sipas neneve 34 – 39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), sipas neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016.

2.1 ILDKPKI-ja, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë, i ka dërguar Komisionit raportin e kontrollit¹, në të cilin konkludohet se: *Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja konstaton se për subjektin e rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj:*

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- ka kryer fshehje të pasurisë;
- ka kryer deklaram të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport², në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. *Në përfundim të veprimeve verifikuese, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të znj. Lindita Sinanaj.*

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 08.06.2018.

² Me shkresën nr. {***} prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 30.03.2021, të KDZh-së.

2.3 KLGj-ja, për subjektin e rivlerësimit ka hartuar raportin³ për analizimin e aftësive profesionale, të cilin ia ka përcjellë Komisionit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 417, datë 08.07.2021, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.*

4. Ky vendim është marrë nga Komisioni, bazuar në përcaktimet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, për deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, për të cilin ka konkluduar se:

Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, vërehet se subjekti nuk ka deklaruar saktë pasurinë dhe janë konstatuar elemente, që mund të ngrenë dyshime për fshehje të pasurisë. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të pamjaftueshme dhe rezultoi në mungesë burimesh të ligjshme financiare për krijimin e tyre.

III. Ankimimi i vendimit të Komisionit

5. Kundër vendimit të Komisionit nr. 417, datë 08.07.2021, ka paraqitur ankim subjekti i rivlerësimit, në të cilin ngre pretendime në drejtim të cenimit të parimeve të procesit të rregullt ligjor, si dhe kundërshton konkluzionet e vendimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë. Me ankimin dhe parashtrimet para seancës gjyqësore, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Kolegji: *shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike; administrimin në cilësinë e provës të akteve bashkëlidhur ankimit dhe parashtrimeve; ndryshimin e vendimit nr. 417, datë 08.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; konfirmimin në detyrë, si gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit.*

A. Shkaqet e ankimit që lidhen me procedurat e ndjekura në Komision, aplikimin e drejtë të ligjit dhe garantimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor

6. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në shqyrtimin e çështjes në Komision, ka pasur të meta dhe shkelje që i kanë shkaktuar pabarazi, aplikim jo të drejtë të ligjit dhe cenim të parimeve të procesit të rregullt ligjor, të cilat kanë të bëjnë me:

- a) cenimin e dinjitetit njerëzor;
- b) cenimin e procesit të rregullt ligjor;
- c) kufizimin e së drejtës për informim;
- ç) shkeljen e parimit të konfidencialitetit dhe cenimin e mbrojtjes së të dhënave personale.
- d) Procesi i rivlerësimit i kryer në Komision, nuk ka qenë i drejtë pasi: i) është cenuar siguria juridike; ii) ka pasur një kohëzgjatje të paarsyeshme; iii) është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit.

B. Shkaqe ankimi që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

7. Subjekti i rivlerësimit, për apartamentin 2+1, me sip. 83,3 m², në lagjen “{***}” në Fier, të blerë në vitin 2000, pretendon se konkluzioni i Komisionit, se gjendet në kushtet e mungesës

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 14.02.2019.

së burimeve të ligjshme në shumën (-) 2.018.362 lekë, është konkluzion i një analize të mangët e jo të bazuar në situatën faktike. Subjekti pretendon se ky konkluzion i Komisionit është si pasojë e mospërfshirjes si burim financimi të kësaj pasurie: (i) të shumës 1.950.000 lekë të dhënë si kontribut subjektit nga prindërit e saj, të cilët e kanë siguruar atë nga shitja e apartamentit në lagjen “{***}” po në Fier; si dhe (ii) të kontributit në shumën 600.000 lekë, nga prindërit e bashkëshortit, të siguruara nga shfrytëzimi i tokës bujqësore.

8. Subjekti i rivlerësimit konsideron të padrejta dhe të pabazuara në situatën faktike konkluzionet e Komisionit, se shitja e apartamentit 2+1, me sip. 83,3 m² në lagjen “{***}” në Fier, në dhjetor të vitit 2012, mund të ketë qenë një shitje fiktive, e kryer për të justifikuar blerjen e pasurisë apartament me sip. 111 m² në {***}, Tiranë⁴, në mars të vitit 2012, dhe të pasurisë garazh⁵ në po të njëjtin vend, në qershor të vitit 2012.
9. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit se gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e apartamentit me sip. 111 m² dhe garazhit me sip. 30 m² në Tiranë, për shkak të moskonsiderimit të huasë në shumën 80.000 euro, marrë nga shtetasit A. C. dhe U. C., është një qëndrim i padrejtë, i paargumentuar dhe jo i bazuar në situatën faktike dhe në ligj.
10. Subjekti i rivlerësimit, konkluzionet e vendimit të Komisionit për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Golf”, me targë {***}, vit prodhimi 2014, i pretendon se janë të pabazuara në të dhënat e provave të administruara lidhur me rrethanat e blerjes së këtij automjeti dhe se analiza e bërë nga Komisioni është tërësisht joobjektive.
11. Subjekti i rivlerësimit, në ankim kundërshton analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 2003-2016, të cilën e konsideron jo të saktë dhe jo në përputhje me situatën faktike.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

12. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë (*ratione materiae*) ankimet kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, bën pjesë në

⁴ Të përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes (pasuri e paluajtshme) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 8.3.2012, me palë shitëse shoqërinë “{***}” ShPK dhe palë blerëse M. S., të pasurisë apartament me sip. 111m², të ndodhur në {***}, Tiranë, regjistruar në {***}, me nr. pasurie {***}, vol. {***}, faqe {***}, në vlerën 8.500.000 lekë. Kjo vlerë është shlyer tërësisht prej blerësit përpara nënshkrimit të kësaj kontrate shitjeje.

⁵ Të përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes (pasuri e paluajtshme) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 5.6.2012, me palë shitëse A. P. e F. P. dhe palë blerëse M. S., të pasurisë garazh me sip. 30m², regjistruar në zonën kadastrale nr. {***}, me nr. pasurie {***}, volumi {***}, faqe {***}, në vlerën 7.000 euro, e konvertuar në 980.000 lekë. Kjo vlerë është likuiduar prej blerësit përpara nënshkrimit të kësaj kontrate shitjeje.

juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) *Legjitimimi i ankuesit*

13. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

14. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit të subjektit të rivlerësimit kundër vendimit të Komisionit, kryhet në dhomë këshillimi. Në rastin objekt shqyrtimi, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka ngritur pretendime në drejtim të shqyrtimit të çështjes së tij në Kolegj në seancë gjyqësore publike dhe se ka paraqitur prova të reja me ankimin⁶ dhe komunikimet⁷ para seancës gjyqësore. Trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi

⁶ Me ankimin, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur aktet:

(i) vërtetim dhe verifikim dokumentacioni nr. rep. {***}, datë 08.11.2021, vërtetuar nga noter A. M., me emërtimin “Vërtetim i e-mail-eve të ruajtura në postën elektronike të Lindita Sinanaj, titullare e adresës së e-mail-it: {***}” (komunikime nga faqja e KPK -së) – 11 fletë;

(ii) vërtetim njësia me origjinalin nr. {***} rep., datë 08.11.2021, lëshuar nga noteri A. M., i dokumentit: faturë tatimore, shoqëruar me foto të targës dhe llojit të makinës, 3 fletë;

(iii) vërtetim njësia me origjinalin nr. {***} rep., datë 08.11.2021, lëshuar nga noteri A. M., i dokumentit: kërkesë e znj. Lindita Sinanaj, drejtuar KPK-së, 2 fletë;

(iv) dokument i printuar nga interneti për vërtetimin e kostos së jetesës në Francë, 1 fletë.

⁷ Me komunikimet/parashtrimet para seancës gjyqësore, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur aktet:

1. vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit nr. {***}, datë 07.04.2016 me palë paditëse z. H. B., në të cilin rezulton se pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar këtë çështje, ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit;

2. e-mail-in e datës 16.04.2024, në adresën: {***}, nga adresa e shtetasit A. C.: {***}, bashkëlidhur të cilit janë dërguar aktet:

- deklaratë nga shtetasit A. e F. C.;

- kopje të dokumenteve të identifikimit të shtetasve A. e F. C.;

- Social Security Statement në USA për shtetasin A. C. (nxjerrë nga sistemi elektronik i Social Security Administration USA);

- Social Security Statement në USA për shtetasen F. C. (nxjerrë nga sistemi elektronik i Social Security Administration USA);

- certifikatë familjare për A. C., nxjerrë nga sistemi elektronik e-albania;

3. kontratë shitblerjeje banese nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.01.2012;

4. kopje e dosjes së pensionit të pleqërisë, e tërhequr në DRSSH Dibër, në të cilën ndodhen vërtetimet për të ardhurat nga punësimi për A. C. për periudhën para muajit qershor 1998;

5. kopje e dosjes së pensionit të pleqërisë, e tërhequr në DRSSH Dibër, në të cilën ndodhen vërtetimet për të ardhurat nga punësimi për F. C. për periudhën para muajit qershor 1998;

6. komunikimi me e-mail me KPK-në, në datat 18 e 21.06 2021;

7. e-mail drejtuar KPK-së në datën 11.01.2021, bashkëlidhur të cilit gjenden përgjigjet e pyetësorit të dërguar nga KPK-ja;

8. e-mail drejtuar KPK-së, datë 11.01.2021, “Akte për pyetjen nr. 6, pjesa e dytë”;

9. e-mail drejtuar KPK-së, datë 30.03.2021, “Dërgim aktesh”, bashkëlidhur të cilit, midis të tjerave, është dërguar akti i ekspertimit i përpiluar nga ekspertët K. H. e A. Z.;

10. e-mail drejtuar KPK-së, datë 21.06.2021, “Aktet shoqëruese të prapësimeve”, bashkëlidhur të cilit, midis të tjerave, janë dërguar:

- lista e çmimeve nga mobileri “{***}”, Fier;

- akt ekspertimi i ekspertëve I. S. e I. S.;

- kontrata e furnizimit me energji elektrike për abonentin I. B.;

- shkresë nr. {***}, datë 17.06.2021, e FShU-së etj.;

gjkues”) mori në shqyrtim aktet e paraqitura nga subjekti me ankimin dhe komunikimet në Kolegj para seancës gjyqësore, nëse ato plotësojnë kriteret ligjore për t’u administruar me cilësinë e provës së re në gjykim. Në funksion të kësaj analize, trupi gjykues konstatoi si vijon.

14.1. Nga analizimi i akteve të fashikullit të hetimit administrativ, rezulton se *e-mail*-et që subjekti i bashkëlidh ankimit, me anë të të cilave ka komunikuar me Komisionin, disponohen në fashikullin e hetimit të krijuar nga Komisioni, për pasojë nuk vlerësohen se janë prova të reja që përcjellin informacion të panjohur për Komisionin e aq më shumë që ka një ndikim në zgjidhjen e çështjes. Këto *e-mail*-e synojnë të provojnë parregullsitë e procedurave të kryera nga Komisioni lidhur me përbërjen e trupës gjyqësore dhe përjashtim/dorëheqjen e disa prej anëtarë të kësaj trupe. Pretendimet e ngritura në to, përpos sa më lart, janë pretendime që trupi gjykues i mori në shqyrtim në funksion të analizës së kryer për shkaqet e ankimit që i atribuohen cenimit të procesit të rregullt ligjor.

14.2. Po ashtu, dhe akti tjetër, fatura tatimore nr. {***}, datë 23.12.2016, lëshuar nga “{***}”, për shpenzimin e kryer për rregullimin e automjetit me targë {***}, e bashkëlidhur ankimit, gjendet e administruar në aktet e fashikullit të hetimit administrativ (*të debatuar edhe në seancën dëgjimore*), duke pasur edhe ky akt të njëjtin vlerësim si më sipër, se nuk plotësonte elementet e një prove të re, për sa kohë që është administruar në hetim prej Komisionit.

14.3. Subjekti ka paraqitur dokumentin e titulluar “Shtesë ankimi” dhe bashkëlidhur tij vendimin nr. {***}, datë 07.04.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit, më kërkesën që të administrohet si provë e re nga trupi gjykues. Nga përmbajtja e këtij vendimi, konstatohet se informacioni që ai evidenton lidhet me faktin se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar një çështje gjyqësore me palë paditëse bashkëshortin e komisioneres B. B., fakt i cili duket se ka shërbyer si shkak mbi të cilin kjo komisionere ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga trupa e Komisionit që do të shqyrtonte procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin. Në këto kushte, ndonëse formalisht ky vendim nuk është administruar në dosjen e Komisionit, të dhënat e tij kanë shërbyer për paraqitjen e dorëheqjes dhe miratimin e saj nga komisionere B. B., veprime që nënkuptojnë se faktet që subjekti kërkon të provojë nëpërmjet tij, janë marrë në konsideratë nga një trupë tjetër gjyqësore në Komision, e cila i ka vlerësuar ato në kuadër të shqyrtimit të kërkesës për dorëheqje. Në këto rrethana, as ky dokument nuk përbën një provë të re, të panjohur prej Komisionit dhe, si i tillë, nuk plotëson kriteret e ligjit për t’u konsideruar me këtë cilësi në gjykimin në apel.

14.4. Subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, ka përcjellë me parashtrimet para seancës gjyqësore, sipas parashikimit të nenit 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), disa akte të cilat, sipas saj, provojnë të ardhurat në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (në vijim “ShBA”) të huadhënësit A. C. dhe bashkëshortes së tij. Nga këqyrja e tyre, trupi gjykues konstatoi se të njëjtat akte gjenden të administruara edhe në fashikullin e hetimit administrativ, të cilat rezulton se i janë përcjellë Komisionit nga subjekti i rivlerësimit me përgjigjet e pyetësorit nr. 4. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se edhe këto akte nuk mund të konsiderohen në cilësinë e provës së re, duke abstraguuar nga momenti kohor i paraqitjes së tyre që tejkalon atë të parashikuar nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012.

11. formularët W2 Wage and Tax Statement për shtetasit A. e F. C. për periudhën 1998-2012 (printimet origjinale nga sistemi elektronik), akte të cilat janë dërguar të skanuara me e-mail-in drejtuar KPK-së, datë 11.01.2021, “Akte për pyetjen nr. 6, pjesa dytë”.

14.5. Përveç sa më sipër, subjekti, me parashtrimet para seancës gjyqësore, ka paraqitur edhe disa akte të tjera të cilat kërkohen të merren me cilësinë e provës, si: kontratë shitblerje banese nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.01.2012 nga shitësi A. C., si dhe një sërë aktesh të lëshuara nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore (DRSSh) Dibër, me anë të të cilave kërkon të provojë të ardhurat nga pensionet e pleqërisë për personat e tjerë të lidhur, A. C. dhe F. C., deri në muajin qershor të vitit 1998. Trupi gjykues konstaton se në parashtrimet para seancës, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë asnjë shpjegim në referim të kërkesave të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, e konkretisht, përse këto akte nuk mund të siguroheshin nga subjekti gjatë periudhës së hetimit administrativ në Komision. Në këto kushte, trupi gjykues konstaton se, përveç se nuk rezultojnë të jenë plotësuar kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, këto akte janë depozituar në Kolegj me parashtrimet, si një mjet procedural që parashikohet nga neni 49, pjesa e parë e ligjit nr. 49/2012, dhe nuk legjitimon përdoruesit e këtij mjeti të paraqesin dhe akte me kërkesën për t'u administruar si provë. Pavarësisht kësaj pengese procedurale për marrjen e tyre mbi kërkesën e subjektit, trupi gjykues i vlerësoi ato në kuptim të neneve 45 e 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 dhe, sipas një analize të vlerës së tyre provuese, konstatoi se ato nuk ishin të tilla që të legjitimonin marrjen e tyre kryesisht nga trupi gjykues, duke qenë se u konsideruan të panevojshme për zgjidhjen e çështjes sipas parashikimit të nenit 49, pika 6, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me procedurat e ndjekura nga Komisioni, si dhe parimet e procesit të rregullt ligjor

15. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në shqyrtimin e çështjes në Komision, ka pasur të meta dhe shkelje që i kanë shkaktuar pabarazi, aplikim jo të drejtë të ligjit dhe cenim të parimeve të procesit të rregullt ligjor, të cilat lidhen me: (i) cenimin e dinjitetit njerëzor; (ii) cenimin e procesit të rregullt ligjor; (iii) kufizimin e së drejtës për informim; (iv) shkelje të parimit të konfidencialitetit dhe cenim të mbrojtjes së të dhënave personale; (v) padrejtësinë e procesit të rivlerësimit të kryer në Komision, pasi: a) është cenuar siguria juridike; b) ka pasur një kohëzgjatje të paarsyeshme; c) është cenuar standardi i arsytimit të vendimit.

15.1. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, për cenim të dinjitetit njerëzor, trupi gjykues konstaton se ajo e ka trajtuar nën dritën e shkeljes së disa të drejtave në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, të cilat, në tërësinë e tyre, janë perceptuar si të tilla që kanë prekur/cenuar dinjitetin njerëzor të subjektit. Sipas këtyre pretendimeve, subjekti i rivlerësimit, duke bërë një përshkrim të dinjitetit njerëzor në nivel akademik, ka potencuar se jo vetëm vendimmarrja, por edhe sjellja procedurale e Komisionit e ka cenuar atë në të gjitha elementet, pasi zhvilloi procesin e saj të rivlerësimit duke zbatuar ligjin në mënyrë të pabarabartë për një periudhë të paarsyeshme kohe, me parregullsi formale në proces, me komunikim të papërshtatshëm, me afate të paarsyeshme, duke e përdorur subjektin si mjet gjatë këtij procesi. Në kushtet kur dinjiteti njerëzor nuk përfaqëson një të drejtë të mbrojtur shprehimisht nga Konventa, subjekti ka elaboruar në ankim secilin prej pretendimeve të saj që adresohen brenda këtij shkaku dhe që përfaqësojnë, sipas saj, shkeljen e kësaj të drejte për të cilën trupi gjykues analizon si vijon.

15.2. Subjekti ka pretenduar brenda këtij shkaku se ligji nuk është zbatuar në mënyrë të barabartë për të dhe subjekte të tjera rivlerësimi. Lidhur me këtë pretendim të subjektit, i cili do të gjejë trajtim të plotë në analizimin e shkaqeve të ankimit që kanë të bëjnë me kriterin e

vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues konstaton se në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, është mbajtur një qëndrim i qartë lidhur me shitjen e apartamenti në lagjen “{***}”, në Fier, në vitin 2012, duke u shprehur⁸ se në vlerësimin tërësor të situatës: [...] *Të gjitha elementet e mësipërme ngrenë dyshime të arsyeshme që pasuria apartament, në Fier, mund të jetë pasuri e subjektit të rivlerësimit dhe shitja e kësaj pasurie te persona të afërt familjarë, është fiktive, për të justifikuar blerjen e një pasurie tjetër.* Sipas përmbajtjes së arsyesimit të vendimit, ky konkluzion i Komisionit është arritur, ndër të tjera, edhe duke konsideruar pamundësinë ekonomike të blerësve për të financuar me të ardhura të ligjshme blerjen e apartamentit në Fier. Duke konsideruar se pretendimi i subjektit për cenim të dinjitetit njerëzor për shkak të trajtimit të pabarabartë, në këtë rast i referohet analizës së burimeve për krijimin e pasurisë së blerësve, trupi gjykues sjell në vëmendje se jurisprudenca⁹ e deritanishme e Kolegjit ka konsideruar të drejtë kryerjen e analizës financiare për të identifikuar burimet e ligjshme edhe për blerësit (pra, për persona që nuk janë në kushtet e kërkuara nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016), në rastet kur ka vlerësuar se ka elemente të mjaftueshme që të çojnë drejt dyshimit se kemi të bëjmë me pasuri të fshehur. Në këto kushte, në vlerësimin e trupit gjykues, analizimi prej Komisionit i mundësisë financiare të blerësve për të financuar blerjen e apartamentit me burime të ligjshme, duket i justifikuar. Ndërsa trupi gjykues e vlerësoi këtë shkak se nuk mbështet pretendimin për cenim të dinjitetit njerëzor në kuadër të një procesi të rregullt, pas analizës që i bëri këtij elementi në vijim të këtij arsyesimi, brenda kriterit të vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues mbajti një qëndrim të ndryshëm nga Komisioni lidhur me peshën e këtij konkluzioni në drejtim të fshehjes së pasurisë, i cili do të shtjellohet në vijim. Në këtë kontekst, ky pretendim i subjektit rezulton jo vetëm i pambështetur, por edhe jorelevant për zgjidhjen e çështjes.

15.3. Lidhur me pretendimin e subjektit për “komunikime të papërshtatshme” nga ana e Komisionit, trupi gjykues konstaton se në ankim subjekti cilëson si të tilla: (i) kryerjen e komunikimeve të saj me Komisionin, nëpërmjet një poste elektronike “anonime”, të cilësuar si: “procesirivlerësimit11”; (ii) pretendon se nuk është njoftuar në asnjë rast se kujt i përket kjo adresë elektronike; (iii) pretendon se në këto komunikime, Komisioni nuk i është drejtuar në emër; (iv) specifikon faktin se njoftimet me *e-mail* i janë komunikuar “në orare të papërshtatshme”, jashtë orarit zyrtar. Po ashtu, subjekti pretendon se edhe publikimi i vendimit nga Komisioni në faqen zyrtare të këtij organi, para se t’i komunikohet subjektit të rivlerësimit, është një tjetër arsye që çon në cenim të dinjitetit njerëzor.

15.4. Lidhur me këto pretendime, *së pari*, trupi gjykues vlerëson të sjellë në vëmendje se, referuar nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës, mandati i organeve të rivlerësimit është me afat të përcaktuar, ato janë ngritur si organe që do të kryejnë procesin brenda një kohe të përcaktuar dhe jo në mënyrë të përhershme, afate të cilat diktojnë edhe një ritëm dhe komunikim të veçantë brenda kuadrit ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit. Për rrjedhojë, të gjitha institucionet e rivlerësimit, si prioritet të veprimtarisë së tyre të përditshme, kanë kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për të gjitha subjektet e përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të nenit 179/b të Kushtetutës, me përgjegjshmëri e rigorozitet brenda afatit të përcaktuar nga Kushtetuta. Në këtë kuptim, edhe pse në veprimtarinë e organeve të rivlerësimit, ashtu si edhe të administratës publike apo sistemit gjyqësor, nuk ka rregulla apo kufizime lidhur me kohën e dërgimit të e-

⁸ Shih paragrafin e parafundit, faqe 16, të vendimit të Komisionit.

⁹ Shih vendimet e Kolegjit (JR) 26/2019; (JR) 52/2023.

mail-eve, trupi gjykues çmon se kufizimet e kohës që organet e rivlerësimit kanë në dispozicion për përmbylljen e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duket se janë elementet që kanë kushtëzuar komunikimin e këtyre organeve (*dërgimi i e-mail-eve*) me subjektet edhe përtej orarit zyrtar. Ndërsa, për sa i përket kohës që i lihet në dispozicion subjektit të rivlerësimit për të dhënë shpjegime dhe për të paraqitur prova gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues, edhe në rastin objekt analize, ashtu si përgjithësisht në çështjet e tjera të rivlerësimit kalimtar, konstaton se në tërësi nga Komisioni afatet janë përcaktuar duke vlerësuar elementet specifike¹⁰, si: kompleksiteti i çështjes dhe tërësia e dokumenteve që pretendohet të paraqiten nga subjektet.

Së dyti, lidhur me pretendimin e subjektit se komunikimi me *e-mail* është bërë nga një adresë anonime, për të cilën nuk ka dijeni se kujt i përket, trupi gjykues vëren se komunikimi i kryer në procesin e rivlerësimit me subjektin e rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, ashtu si edhe me të gjitha subjektet e tjera, është bërë me anë të postës elektronike sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Përgjithësisht, në veprimtarinë e organeve të rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin, komunikimi elektronik është kryer pa i atashuar korrespondencës së dërguar nga këto organe një emër individ, për të mos i dhënë atij nuancat e një komunikimi individual. Nga komunikimet e dërguara nga Komisioni subjektit të rivlerësimit, të cilat gjenden të administruara në fashikullin e hetimit administrativ, rezulton se të gjitha këto komunikime në fund mbajnë nënshkrimin: “Komisioni i Pavarur i Kualifikimit”. Ky element, në vlerësimin e trupit gjykues, tregon se këto *e-mail-e* në mënyrë të qartë kanë të identifikuar autoritetin publik dërgues, duke i bërë të ditur subjektit autoritetin me të cilin po komunikon.

Së treti, lidhur me pretendimin e subjektit për publikim të vendimit fillimisht në faqen zyrtare në internet të Komisionit përpara se t’i njoftohej asaj personalisht, nga të dhënat e akteve të administruara në fashikullin e hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se: vendimi i Komisionit objekt gjykimi, sipas të dhënave të administruara në fashikullin e Komisionit, rezulton se i është përcjellë subjektit me shkresën nr. {***} prot., datë 20.10.2021, e cila rezulton se është e njëjta ditë në të cilën Komisioni ka publikuar këtë vendim në faqen zyrtare në internet. Ndërkohë, nga aktet e administruara në fashikull, rezulton se dëftesa postare e njoftimit të vendimit është kthyer në Komision më datë 22.10.2021, me shënimin “adresë e pamjaftueshme”, dhe ky fakt është reflektuar në komunikimet e stafit të Komisionit, të cilët evidentojnë se adresa e vendosur në shkresën e sipërcituar është marrë nga dosja e ILDKPKI-së, e plotësuar nga vetë subjekti, dhe se subjekti, pas komunikimeve telefonike, ka konfirmuar se do të paraqitet personalisht në Komision më datë 25.10.2021, për të tërhequr dorazi vendimin. Përfundimisht, rezulton se dëftesa postare e komunikimit të vendimit mban nënshkrimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, me shënimin: “marrë dorazi më datë 25.10.2021”. Në këtë kuptim, rezulton se Komisioni krahas nisjes së procedurës për komunikimin e vendimit të subjekti i rivlerësimit, në zbatim të detyrimeve që vijnë nga neni 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, ka kryer edhe veprimet e nevojshme për publikimin e tij sipas së njëjtës dispozitë, por edhe si një detyrim që vjen nga një dispozitë kushtetuese, e parashikuar në nenin Ç, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Në këtë këndvështrim, rezulton se Komisioni ka

¹⁰ Në shqyrtimin e çështjes që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, nga të dhënat e administruara në fashikullin e hetimit administrativ, rezulton se Komisioni ka marrë në konsideratë kërkesën e subjektit për shtyrje afati të dhënies së shpjegimeve për shkaqe pamundësie shëndetësore, duke i konfirmuar me *e-mail-in* e datës 10.12.2020 se: “Ju njoftojmë se afati për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar, do të jetë 7 ditë, duke filluar ky afat në ditën që do të jeni e aftë për të ushtruar detyrën”.

kryer komunikimet e tij në zbatim të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore. Përveç sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit është vënë në dijeni të vendimit të Komisionit, me shpalljen e dispozitivit të tij në përfundim të seancës dëgjimore, dhe vendimi i arsyetuar vetëm sa përcjell arsyetimin mbi të cilin do të hartohet edhe ankimi përkatës. Për sa më sipër, veprimtaria procedurale e Komisionit nuk rezulton të ketë shkelur ndonjë dispozitë ligjore që rregullon njoftimet e vendimeve, për pasojë nuk mund të interpretohet një procedurë ligjore e realizuar brenda diskrecionit të Komisionit për sa i përket kohës së kryerjes së tij, se ka cenuar dinjitetin njerëzor të subjektit, si një cenim që do të duhej të shoqërohej me qëllimin për ta shkaktuar atë.

Së katërti, pretendimi i subjektit se Komisioni e ka trajtuar atë si një mjet/instrument të qëllimit të veprimtarisë së vet, nuk rezulton të jetë adresuar drejt një veprimtarie konkrete të Komisionit, por duket se përfaqëson një deduksion të pretendimeve të saj për cenim të dinjitetit njerëzor, i cili, për sa kohë që u vlerësua se nuk ka ndodhur për shkaqet konkrete të analizuara më lart, vlerësohet se nuk është i mbështetur edhe në deduksionin e cituar më sipër.

15.5. Në përfundim të analizës sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e ngritura në këtë shkak ankimi, lidhur me komunikimet e subjektit dhe Komisionit, nuk vlerësohen të drejta e të bazuara dhe, si të tilla, ato nuk konsiderohen se cenojnë dinjitetin njerëzor të subjektit.

15.6. Në vijim, trupi gjykues mori në analizë edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit *për cenim të procesit të rregullt ligjor dhe kufizim të së drejtës për informim*, duke arsyetuar sa vijon.

15.7. Subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, ka mbështetur pretendimet e saj për cenim të procesit të rregullt ligjor kryesisht në faktin se Komisioni nuk i ka bërë me dije ndryshimet e përbërjes së trupës gjykuese, e cila është e ndryshme nga ajo e përcaktuar me short nga ky organ, veprim i cili evidenton parregullsi në kryerjen e procedurave, të cilat, sipas saj, i kanë cenuar edhe të drejtën për informim.

15.8. Sipas këtyre pretendimeve, trupa gjykuese e Komisionit, e përzgjedhur me short më datë 15.11.2018, ka qenë e përbërë nga komisionarët: P. Q., A. F. dhe S. Zh.¹¹, sipas njoftimit që i është përcjellë subjektit me *e-mail*, më datë 31.01.2019, të cilin subjekti e ka bashkëlidhur me ankimin. Ndërsa, subjekti evidenton se nga përmbajtja e vendimit objekt shqyrtimi, rezulton se fillimisht në trupë ka qenë komisionere G. B.¹², e cila ka dhënë dorëheqjen, që është pranuar me vendimin nr. 1, datë 04.12.2018, të trupit gjykues, të caktuar me vendimin nr. 60, datë 27.11.2018, të Komisionit. Në vend të komisioneres G. B. është zgjedhur komisionere B. B.¹³, e cila gjithashtu ka paraqitur kërkesë për dorëheqje, që po ashtu, është pranuar me vendimin nr. 67, datë 11.12.2018, të një trupe tjetër gjykuese. Për të gjitha këto ndryshime të trupës

¹¹ Në fashikullin 16, faqe 3096, gjendet i administruar vendimi me date 13.12.2018, për shqyrtimin e kërkesës për dorëheqje të komisioneres B. B., i cili në "Rrethanat e çështjes", pika 1, evidenton se: "Në shortin e datës 15.11.2017, për shortimin e subjekteve të rivlerësimit, një ndër subjektet e shortuara është znj. Lindita Sinanaj, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Administrativ. Anëtarët e trupit gjykues të shortuar janë: komisionere G. T. (B.), komisionere A. F. dhe komisionere S. Zh..

¹² Për shkak të dhënies së vendimit nr. {***}, datë 21.9.2018, me gjyqtare relatores subjektin e rivlerësimit, në favor të babait të komisioneres G. B..

¹³ Për shkak të dhënies së vendimit gjyqësor nga subjekti i rivlerësimit në favor të bashkëshortit të saj. Në fashikull nuk gjendet e administruar kërkesa për dorëheqje e komisioneres B. B. dhe as vendimi gjyqësor që subjekti ka dhënë në favor të bashkëshortit të saj. Procesverbali i mbledhjes së trupit gjykues të shqyrtimit të kërkesës për dorëheqje të komisioneres B. B., i ngritur me vendimin nr. 67, datë 11.12.2018, evidenton arsyen e kërkesës për dorëheqje të komisioneres B., e cila është pranuar me vendimin e trupës të datës 13.12.2018.

gjykuese, subjekti pretendon se nuk është vënë në dijeni nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

15.9. Gjithashtu, subjekti evidenton se pas pranimit të dorëheqjes së komisioneres G. B. dhe komisioneres zëvendësuese B. B., Komisioni, me vendimin nr. 68, datë 20.12.2018, ka vendosur të caktojë me short si anëtare të trupës gjykuese komisioneren P. Q., dhe se nuk ka asnjë akt që të ketë vendosur për përfshirjen në trupë të komisionerit L. H., i cili, për më tepër, rezulton të jetë pjesë e kësaj trupe që në vendimin nr. 1, datë 21.12.2018. Ky fakt bie në kontradiktë, sipas pretendimit të subjektit, me faktin që Komisioni ka njoftuar subjektin me *e-mail-in* e datës 20.05.2020 (të cilin subjekti ia ka bashkëlidhur ankimit), se komisionere A. F. për arsye objektive, zëvendësohet me komisionerin L. H.. Sipas këtij komunikimi, subjekti i rivlerësimit pretendon se është e pamundur që komisioneri L. H. të jetë zgjedhur/caktuar si pjesë e trupit gjykues me vendimin nr. 17 të datës 09.03.2020¹⁴, dhe ndërkohë kohë më parë, më datë 21.12.2018, të ketë marrë pjesë në vendimmarrjen për caktimin e komisioneres kryesuese. Përveç sa më sipër, subjekti pretendon se Komisioni asnjëherë nuk i ka bërë asaj të ditura "arsyet objektive" që çuan në zëvendësimin e komisioneres F. me komisionerin H..

15.10. Përveç sa ka ngritur në ankim, subjekti i rivlerësimit, në komunikimet/parashtrimet e përcjella në Kolegj para gjykimit të çështjes, ka ngritur disa shkaqe të tjera që synojnë me potencimin dhe evidentimin e kësaj problematike, duke evidentuar se: **(i)** Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2021, i ka bërë me dije subjektit se aktet e ndryshimit të trupës së saj gjykuese ishin akte të brendshme me të dhëna konfidenciale që nuk mund t'i viheshin në dispozicion, veprim i cili i ka cenuar parimin e transparencës dhe gjykatën e paanshme të krijuar me ligj; **(ii)** shkaqet e evidentuara nga komisioneret G. B. dhe B. B., për dorëheqjen nga shqyrtimi i çështjes, nuk legjitimojnë përjashtimin e tyre nga përbërja e trupit gjykues; **(iii)** në rastin në fjalë, vlerësimi nëse ishim para një situatë për përjashtim të komisionerëve nga trupi gjykues, duhej vlerësuar jo sipas ligjit nr. 9367/2005, por sipas nenit 72 të Kodit Procedurës Civile, i cili parashikon rastet kur gjyqtari ka detyrimin të heqë dorë nga gjykimi i çështjes.

15.11. Në analizë të situatës së përshkruar më sipër lidhur me ndryshimin dhe zëvendësimin e anëtarëve të trupës gjykuese të Komisionit të caktuar me short, trupi gjykues konstaton se: *Së pari*, nga aktet e administruara në fashikullin e hetimit administrativ të krijuar në Komision, ka mungesë informacioni lidhur me vënien në dijeni të subjektit për sa i përket: **(a)** përcaktimit të trupës gjykuese të Komisionit të përzgjedhur me shortin e datës 15.11.2018, e cila do të shqyrtonte procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj; **(b)** caktimit në trupë të komisioneres B. B. (për zëvendësimin e anëtares G. B.) dhe dorëheqjes së saj; **(c)** largimit të komisioneres A. F. dhe caktimit në trupë të komisionerit L. H., i cili në vendimin e datës 21.12.2018, të caktimit të komisioneres P. Q. si kryesuese e trupës, përmendet se ka qenë anëtar i trupit gjykues të shortuar. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se ndërsa zëvendësimi i dy komisionereve B. dhe B. nuk konstatohet se ka krijuar ndonjë parregullsi në procesin e rivlerësimit përderisa kjo veprimtari është kryer para se subjekti të kishte marrë

¹⁴ Ky vendim mungon në fashikullin e përcjellë në Kolegj nga Komisioni. Por me ankimin, subjekti ka përcjellë *e-mail-in* e datës 20.05.2020, me të cilin informohet nga Komisioni se me vendimin nr. 17, datë 09.03.2020, të KPK-së u vendos zëvendësimi për arsye objektive i anëtares së trupit gjykues A. F. me z. L. H., Ndërkohë, në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, nr. 417, datë 08.07.2021, ndër të tjera jepet informacioni sa vijon:

"Trupi gjykues i përbërë nga komisionerët: L. H., S. Zh. dhe P. Q., i mbledhur në datën 21.12.2018, në mbledhjen e parë, caktuan me mirëkuptim kryesuese të trupit gjykues, znj. P. Q."

dijeni për përbërjen e trupit gjykues, dhe brenda kompetencave administrative të Komisionit për ngritjen e trupave gjyquese të paanshme dhe objektive, zëvendësimi i komisioneres F. me komisionerin H. paraqet problematikë në drejtim të kundërshtive që paraqesin dy akte të njoftuara subjektit prej Komisionit. Trupi gjykues nuk ka evidentuar nga aktet në dosje se si dhe kur është kryer ky proces, dhe as ka gjetur një përgjigje të arsyeshme për moskoherencën e dy vendimeve të Komisionit. Në këto kushte, duket se pretendimi i subjektit se ka pasur parregullsi në procesin e zëvendësimit të komisioneres F. me komisionerin H., gjendet i drejtë për sa i përket rrethanave të faktit. Trupi gjykues, pavarësisht nga ky konstatim, në vijim, analizoi peshën e kësaj parregullsie/shkeljeje, në raport me procesin e rregullt ligjor dhe se si ajo mund të ketë afektuar të drejtat e subjektit në proces.

Së dyti, nga analizimi i akteve të fashikullit të hetimit administrativ, konstatohet se të gjitha veprimet hetimore të kryera nga trupa gjyquese e Komisionit, e përbërë nga komisionerët: P. Q., kryesuese; S. Sh., relatore dhe L. H., anëtar – janë iniciuar e ndërmarrë nga komisionerja relatore e çështjes, e cila po ashtu ka propozuar vendimmarrjet në kuptim të përcaktimeve të neneve 45-61 të ligjit nr. 84/2016. Nga të dhënat e fashikullit, rezulton se veprimet hetimore për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur apo të tjerë të lidhur kanë nisur¹⁵ pas datës 11.12.2018, kur është marrë vendimi nr. 1¹⁶, për caktimin e kryesuesit të trupit gjykues, komisioneres P. Q. dhe komisionere relatore S. Zh.. Vendimi nr. 1, datë 21.12.2018, është nënshkruar nga e gjithë trupa gjyquese, e përbërë nga: komisionere P. Q., kryesuese; komisionere S. Zh., relatore dhe komisioner L. H., anëtar. Bashkëlidhur këtij vendimi, gjenden edhe deklaratat për konfliktin e interesit të nënshkruara nga komisionerët Q., Zh. dhe H., nëpërmjet të cilave ata deklarojnë se në zbatim të përcaktimeve të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016, të neneve 30 dhe 31 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim “ligji nr. 9367/2005”), nuk janë në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, situatë të cilën as subjekti i rivlerësimit nuk e konteston në asnjë prej shkaqeve të ngritura në ankimin e saj. Për rrjedhojë, nuk evidentohet asnjë veprim në fashikullin e Komisionit në të cilin të ketë qenë pjesë e vendimmarrjes komisionerja F., pasi praktikisht e gjithë veprimtaria hetimore e drejtuar nga relatorja Zh., është kryer nën administrimin e procesit nga e njëjta trupë gjyquese me atë që ka marrë vendimin objekt gjykimi.

15.12. Gjithashtu, rezulton se edhe vetë subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, nuk shpjegon se pse ndryshimet e trupës gjyquese, si më sipër përshkruar, kanë ndikuar negativisht në procesin e saj të rivlerësimit, por mjaftohet të konsiderojë si shkelje të procesit vetëm faktin e mungesës së informacionit lidhur me to dhe parregullsitë në formimin e trupit gjykues.

15.13. Lidhur me këtë pretendim, nga sa u evidentua më sipër, në kushtet kur e gjithë veprimtaria hetimore për subjektin e rivlerësimit ka nisur më datë 01.10.2019, pra pasi janë shqyrtuar të gjitha kërkesat për dorëheqje të komisionerëve, për sa kohë këto ndryshime nuk kanë afektuar procesin hetimor, duket se Komisioni, në zbatim të së drejtës së tij diskrecionale për të administruar procesin, ka vlerësuar të mos njoftojë subjektin për ndryshimet e anëtarëve të

¹⁵ Nga të dhënat e fashikullit të hetimit administrativ të krijuar nga Komisioni, rezulton se kërkesat për marrjen e të dhënave nga ASHK, ISSH, DPSHTRR, UKT, OSHEE, bankat etj., janë përcjellë nga Komisioni më datë 01.10.2019. Përpara kësaj date, nuk figurojnë të jenë kryer veprime hetimore për subjektin e rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj.

¹⁶ Në këtë vendim, në paragrafin e tretë, është shprehur se: “Më datë 21.12.2018, trupa zhvilloi takimin e parë, me rendin e ditës si më poshtë: Data 11.12.2018 duhet të jetë një gabim material në pjesën hyrëse të vendimit nr. 1”.

trupës. Ndërsa, sipas rregullores së miratuar nga Komisioni, për “Hapat proceduralë të unifikuar”, konstatohet se në pikën 19 të kësaj rregulloreje, përcaktohet se: *Për të gjitha shortet pararendëse të hedhura, njoftimi i subjekti i rivlerësimit për përbërjen e trupës gjyquese dhe të drejtën e deklaramit të konfliktit të interesit, do të kryhet sipas pikës 3, fjalia 5 e kësaj rregulloreje e cila parashikon se: 3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hedhja e shortit sipas rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, çdo trupë gjyquese zhvillon mbledhjen e parë, në të cilën ndërmerren këta hapa: deklarohet konflikti i interesit nga anëtarët e trupës gjyquese; zgjidhet kryesuesi i trupës gjyquese për çdo dosje; bëhet prezantimi paraprak i dosjes nga çdo relator; vendoset për njoftimin e subjektit të rivlerësimit për fillimin e procedurave të rivlerësimit; njohjen me përbërjen e trupës gjyquese dhe të drejtën e deklaramit të konfliktit të interesit, si dhe dërgimin e pyetësorit tip; vendoset për fillimin e hetimit kryesisht, si dhe vlerësimit të fakteve dhe rrethanave. Deri në përfundim të hetimit, relatori mund t’i kundërdrejtojë subjektin pyetje shtesë, të cilat i konsideron të nevojshme për hetimin. Ky përcaktim i rregullores së Komisionit për veprimtarinë e trupës gjyquese të përcaktuar me short, duket se evidenton rolin inaktiv të komisionerëve të tjerë (në funksionet kryesues dhe anëtar) në raport me rolin e komisionerit relator deri në përfundim të hetimit administrativ.*

15.14. Në rastin objekt shqyrtimi, konstatohet se komisionerët B. dhe B., pasi janë zgjedhur në trupë, kanë paraqitur kërkesë për dorëheqje, kërkesa të cilat i janë nënshtruar procesit të shqyrtimit nga trupat e krijuara posaçërisht për shqyrtimin e tyre, rrethanë që dëshmon se trupa nuk ka qenë e krijuar përfundimisht dhe, për pasojë, Komisioni nuk ka pasur çfarë të komunikojë me subjektin, për sa kohë ishin në shqyrtim ende çështje të konfliktit të interesit të komisionerëve (dorëheqjet).

15.15. Pretendimet e subjektit të paraqitura në parashtrime, të cilat duket se kontestojnë vendimet e trupave gjyquese që kanë miratuar dorëheqjet e komisionerëve B. e B., qoftë për themelin¹⁷, qoftë për bazën ligjore të përdorur¹⁸, gjenden nga kjo trupë gjyquese jo vetëm të paarsyeshme në thelbin e tyre, për sa kohë që komisionerët kanë pretenduar mungesë objektiviteti për shkak të qenies, sipas perceptimit të tyre, në kushte kur dukej se mund të favorizonin subjektin¹⁹, por janë edhe pretendime të cilat ligjërisht subjekti i rivlerësimit nuk mund t’i ngrejë. Subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, mund të kundërshtojë në gjykatën më të lartë, në këtë rast në Kolegj, vendimet e marra në kundërshtim me kërkesat e saj për përjashtim të ndonjë prej komisionerëve, për shkak të ndodhjes në një prej situatave të konfliktit të interesit, por ajo nuk legjitimohet të kundërshtojë vendimet për miratimin e kërkesave për dorëheqje, të cilat janë akte që nuk varen nga vullneti i subjektit apo që japin përgjigje për kërkesat e saj, duke qenë se në këto procese, subjekti i rivlerësimit nuk është palë. Parë edhe në këtë dritë, pretendimet e subjektit se zëvendësimi i komisionerëve B. dhe B. ka cenuar procesin e rregullt ligjor të zhvilluar ndaj saj, gjenden nga trupi gjyqesues të pambështetura në prova e në ligj.

¹⁷ Subjekti ka pretenduar se shkaqet e paraqitura në kërkesat për dorëheqje nuk janë të tilla që justifikojnë miratimin e tyre.

¹⁸ Subjekti ka pretenduar se ligji i zbatueshëm për t’u dhënë përgjigje kërkesave duhet të ishte neni 72 i Kodit të Procedurës Civile dhe jo ligji nr. 9367/2005.

¹⁹ Arsyet që komisionerët G. B. dhe B. B. kanë përdorur për të dhënë dorëheqjen nga trupa gjyquese e Komisionit lidhen me faktin se prej subjektit janë dhënë vendime gjyqësore në favor të familjarëve të afërt të komisionerëve, përkatësisht të babait të komisioneres B. dhe të bashkëshortit të komisioneres B..

15.16. Në përfundim të analizimit të kësaj situatë, trupi gjykues vlerëson se ndonjë konstatohet një problematikë lidhur me momentin e zëvendësimit të komisioneres F. me komisionerin H., si e vetmja ndër ato që subjekti ka ngritur në ankim, ajo nuk rezulton të ketë afektuar në ndonjë mënyrë procesin e rivlerësimit të subjektit në kuptimin e procesit të rregullt ligjor. Subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur asnjë pretendim për qenien në konflikt interesi të komisionerit H., situatë që do të kishte cenuar potencialisht vendimmarrjen e Komisionit dhe do të kishte detyruar Kolegjin të ndreqte këtë shkelje procedurale nëpërmjet seancës gjyqësore publike. Shkelja e konstatuar si e tillë, mbetur vetëm në parregullsitë e kryerjes së zëvendësimit apo parregullsitë e pasqyrimin të këtij veprimi në dokumentacionin ligjor të administruar në fashikull, vlerësohet se nuk cenon vendimin e Komisionit objekt gjykimi dhe, për rrjedhojë, nuk rezulton të ketë cenuar në ndonjë mënyrë domethënëse të drejtat e subjektit në proces.

15.17. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni i ka kufizuar në mënyrë tërësisht të pajustificuar dhe të paligjshme të drejtën për t'u njohur me aktet e procedurës së procesit të rivlerësimit, trupi gjykues analizon sa vijon.

15.18. Subjekti i rivlerësimit, pas dhënies së vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, me anë të kërkesës së datës 25.10.2021, i ka kërkuar Komisionit t'i vërë në dispozicion: **(i)** aktet që përcaktojnë mënyrën e formimit të trupit gjykues, kopje të kërkesave për heqje dorë të komisionerëve B. dhe B. si dhe vendimet përkatëse për pranimin e këtyre kërkesave, aktet që provojnë si është caktuar komisioneri L. H. në përbërje të trupës në procesverbalin e mbledhjes së datës 21.12.2020; **(ii)** kopje të procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 06.07.2021, në CD dhe të transkriptuar; **(iii)** kopje të procesverbalit të mbledhjes së trupit gjykues për marrjen e vendimit përfundimtar. Në përgjigje të kësaj kërkesë²⁰, Komisioni, me shkresën nr. {**} prot., datë 02.11.2021, i bën me dije subjektit se i vë në dispozicion kopje në CD të audios së seancës dëgjimore të datës 06.07.2021 dhe të procesverbalit të transkriptuar të seancës 6 dhe 8 korrik 2021. Në këtë shkresë, Komisioni i bën subjektit me dije se kërkesat e tjera që kanë të bëjnë me procesverbalet e brendshme të trupave të Komisionit, në bazë të pikës 7 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe të pikës 2 të nenit 31 të rregullores “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, refuzohen për shkak se e drejta e subjektit për t'u informuar lidhur me to është e kufizuar, pasi informacioni në këto akte të brendshme është konfidencial dhe në të nuk kanë akses as palët dhe as publiku.

15.19. Për analizimin e këtij shkak ankimi, trupi gjykues mori në analizë rregullat e vendosura nga Komisioni për informimin e subjekteve të rivlerësimit, nga të cilat konstatoi se: në pikën 2 të nenit 31 të rregullores “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, përcaktohet se: *[...] Raporti i relatorit, projektvendimi, çfarëdo informacioni për diskutimin dhe për votimin e trupit, projektvendimet dhe çfarëdo shënimesh të anëtarëve të trupit gjatë diskutimit dhe gjatë shqyrtimit të rastit, mendimet e këshilltarëve, si dhe materiali tjetër i përcaktuar nga mbledhja e Komisionit duhet të jenë konfidencialë dhe në të nuk do të kenë akses as palët e as publiku.*

15.20. Në vlerësimin e trupit gjykues, ky parashikim i rregullores së veprimtarisë së Komisionit, i aplikuar gjerësisht deri aktualisht, duket se ka përcaktuar qartë se aktet që përshkruhen më sipër, lidhur me vendimmarrjet e trupave, nuk mund t'u bëhen të ditura palëve. Në këtë kuptim, veprimi i Komisionit për mospërcjellje të procesverbalit që dokumenton diskutimin e kryer në

²⁰ Të cilën subjekti ia ka bashkëlidhur ankimit.

funksion të vendimmarrjes së trupës për dhënien e vendimit përfundimtar, ka qenë i drejtë dhe i mbështetur në akte ligjore. Kufizimi i së drejtës për informim, i parashikuar në nenin 4, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, duket se ka gjetur pasqyrim në aktin nënligjor të miratuar nga Komisioni për administrimin e procesit të rivlerësimit, dhe përgjigjja e kthyer subjektit në këtë rast, rezulton të jetë e mbështetur pikërisht në këto parashikime, për pasojë trupi gjykues e gjen këtë pretendim të pambështetur në ligj.

15.21. Lidhur me pretendimin e subjektit për shkelje nga ana e Komisionit të parimit të konfidencialitetit dhe cenimit të parimit të mbrojtjes së të dhënave personale, trupi gjykues analizon sa vijon.

15.22. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni, në shkelje të plotë të parimit të ruajtjes së konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, në vendimin e publikuar më datë 20.10.2021, ka pasqyruar të dhëna personale të personave që janë në lidhje të afërt familjare me subjektin, të cilat i bëjnë ata plotësisht të identifikueshëm, duke potencuar se subjekti jo më kot i ka deklaruar ata në deklaratimet periodike si pjesë e informacionit të përfshirë në rubrikën e të dhënave konfidenciale.

15.23. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, konstatohet se vendimi i Komisionit objekt gjykimi është publikuar në faqen zyrtare në internet të këtij organi, i anonimizuar, në respektim të udhëzimit nr. 15, datë 23.12.2011, “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”²¹ të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale²², dalë në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, duke publikuar të dhënat e personave të tretë me iniciale. Nëse, ashtu siç pretendon subjekti, në vendimin e Komisionit nuk do të jepej asnjë e dhënë që ka të bëjnë me shumatat e marra hua nga subjekti dhe bashkëshorti, si dhe me burimet e krijimit të tyre nga huadhënësit (si persona të tjerë të lidhur me subjektin), atëherë vendimi do të ishte i pakuptueshëm nga publiku, besimin e të cilit synon të rikuperojë reforma në drejtësi nëpërmjet procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për këtë arsye, ky pretendim i subjektit gjendet jo i drejtë dhe i paargumentuar ligjërisht.

15.24. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se është cenuar drejtësia e procesit duke sjellë cenimin e parimit të sigurisë juridike për shkak të zbatimit të ligjit në mënyrë të pasaktë, jokonsistente, jo të qëndrueshme dhe me prapaveprim, trupi gjykues analizon sa vijon.

15.25. Subjekti në ankim parashtron se parimi i sigurisë juridike ka si qëllim të mbrojtë individin që është subjekt i ligjit, nga përdorimi arbitrar i pushtetit prej ligjvënësit, por edhe prej zbatuesit të ligjit, pasi vetëm në këtë mënyrë individit mund të mbështetet te ligji dhe të ketë besim te shteti i së drejtës. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit për cenim të parimit të sigurisë juridike, trupi gjykues konstaton se edhe pse subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, identifikon në ankim elementet, cenimi i të cilave, sipas saj, passjell shkelje të parimit të

²¹ Në kreun III të këtij udhëzimi përcaktohet se: “4. Personat përgjegjës, gjatë publikimit të vendimeve penale, vendimeve civile (të cilat janë dhënë mbi kërkesëpadi) në faqen zyrtare në internet, detyrohen të zbatojnë rregullat e mëposhtëm, në mbrojtje të privatësisë:

a) Gjeneralitetet e palëve, personave të tretë, dëshmitarëve dhe ekspertëve të thirrur në gjykim, paraqiten me iniciale ose kodohen.

b) Në pjesën arsyetuese të vendimit, ndalohet publikimi i të dhënave personale që cenojnë privatësinë e palëve në gjykim (si p.sh.: adresa, targa të makinës, numra të telefonit dhe çdo element tjetër, i cili identifikon subjektin e të dhënave).

²² <https://idp.al/rreth-nesh/>

sigurisë juridike – siç janë saktësia e bazës ligjore të aplikuar; konsistenca që ligjet e aplikuara të mos kundërshtojnë njëra-tjetrën; qëndrueshmëria që instrumentet ligjore të mos ndryshojnë aq shpesh sa të çojnë në konfuzion, dhe se gjykata nuk duhet të largohet nga një interpretim i mbajtur më parë; si dhe joprapaveprueshmëria që kërkon që instrumentet ligjore të mos zbatohen me prapaveprim – cenimin e këtyre nocioneve teorike nuk e adreson në situata konkrete të cenimit/mosaplikimit të tyre në procesin e saj të rivlerësimit të kryer në Komision, duke i lënë këto pretendime në planin teorik, qasje e cila pamundëson kontrollin e tyre nga ana e Kolegjit.

15.26. Trupi gjykues mori në shqyrtim edhe pretendimet që subjekti i rivlerësimit ngre në ankim, lidhur me kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit si dhe cenimin e standardit të arsyesimit të vendimit, për të cilat analizon sa vijon.

15.27. Në drejtim të kohëzgjatjes së procesit, subjekti pretendon se në referim të përcaktimeve të nenit 91 të Kodit Procedurës Administrative, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë, e cila sipas nenit vijues, 92, të këtij kodi, në raste të justifikuara për shkak të kompleksitetit të çështjes, mund të zgjatet vetëm një herë, ndërsa procesi i saj i rivlerësimit ka zgjatur në një afat kohor që tejkalon parashikimet ligjore të cituara

15.28. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues sjell në vëmendje se procesi i rivlerësimit kalimtar i subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, ka filluar nga Komisioni *ex-officio*, në zbatim të përcaktimeve të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit kalimtar, duke qenë një proces i jashtëzakonshëm, ka rregullimet e tij specifike në dispozitat kushtetuese dhe ligjore, të cilat përcaktojnë edhe procedurat mbi të cilat ai zhvillohet. Neni 91 dhe vijues i Kodit të Procedurës Administrative, të cilin referon në ankim subjekti, ka të bëjë me përcaktimin e afateve të shqyrtimit të procedurave administrative që zhvillohen nga organet publike në procese të zakonshme administrative dhe, për më tepër, të nisur *me kërkesë*, të shtetasve të cilët kërkojnë që organet publike të shprehen për nevojat e tyre sipas rastit apo të zgjidhin një konflikt administrativ. *Lex specialis* që vepron dhe rregullon procesin e rivlerësimit kalimtar, prevalon dhe përcakton rregullat mbi të cilat zhvillohet ky proces, sipas parimit që *lex specialis derogat legi general*, parim i parashikuar edhe në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, në të cilin parashikohet se normat e Kodit të Procedurave Administrative do të zbatohen në këtë proces për aq sa është e mundur. Për më tepër, pretendimi, përveçse duket i pambështetur lidhur me bazën ligjore të pretenduar se duhet të përdoret, rezulton i pambështetur edhe në një vlerësim të kujdesshëm të problematikave dhe natyrës së procesit të rivlerësimit. Trupi gjykues vëren se edhe në këtë çështje, ashtu si në raste të tjera, procesi hetimor i kryer nga Komisioni merr një kohë të gjatë që përcaktohet në varësi të kompleksitetit të çështjes, natyrës e llojit të veprimeve hetimore që duhen të kryhen, elementeve specifike që lidhen jo vetëm me pasurinë, por edhe me figurën dhe aftësitë profesionale të subjekteve, problematika që në asnjë rast nuk rezultojnë të jenë zhvilluar brenda afateve që referon subjekti në ankim. Në këtë mënyrë, trupi gjykues vlerëson se pretendimi për shkelje të ligjit mbetet i pambështetur, por edhe në një vlerësim të situatës, koha e marrë prej Komisionit për hetimin e rastit, duket e arsyeshme dhe në koherencë me kohëzgjatjen e proceseve të subjekteve të tjera me problematika të ngjashme.

15.29. Lidhur me pretendimin e subjektit se vendimi i Komisionit cenon standardin e arsyesimit të vendimit, trupi gjykues analizon sa vijon.

15.30. Subjekti i rivlerësimit ka evidentuar si elemente që dëshmojnë për cenim të standardit të arsyetimit të vendimit nga Komisioni: **(i)** mungesën e arsyetimit mbi provat e paraqitura nga subjekti, rrethanat e faktit dhe shpjegimet e dhëna mbi rezultatet paraprake të hetimit; **(ii)** zbatim të gabuar të ligjit, duke sajuar rregulla që nuk ekzistojnë. Nga analizimi i ankimit dhe përmbajtjes së vendimit të Komisionit, trupi gjykues vëren se duket që pretendimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, për mungesë të vlerësimit të provave të paraqitura prej saj, lidhet me mungesën e një vlerësimi për provat që subjekti ka paraqitur për të ardhurat e prindërve të saj (*çështje e trajtuar gjerësisht në vijim*), të cilat Komisioni, meqenëse ka arritur në përfundimin se prindërit nuk kanë kontribuar në ekonominë familjare të subjektit, i ka vlerësuar si të panevojshme t'ia nënshtrojë analizës. Ndërsa situata të tjera që subjekti identifikon se tregojnë mungesën e shqyrtimit të provave që ajo ka paraqitur me shpjegimet për rezultatet paraprake të hetimit (*siç është raporti i vlerësimit të automjetit*²³), siç do të evidentohet në vijim, duket se lidhen me rastet kur Komisioni, të dhënat që japin këto prova, i ka vlerësuar në mënyrë të ndryshme nga sa ka pretenduar subjekti. Në këto kushte, nga analizimi i këtij pretendimi, rezulton se nga Komisioni nuk ka munguar vlerësimi i provave dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti, por ato janë çmuar brenda diskrecionit të këtij organi, në mënyrë të ndryshme nga pritshmëritë e saj.

15.31. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit *se arsyetimi i vendimit përmban zbatim të gabuar të ligjit*, konstatohet se ai lidhet me qëndrimin që Komisioni ka mbajtur duke ia nënshtuar analizës financiare, mundësinë e blerësve të apartamentit në Fier, për të kontrolluar burimet e ligjshme të tyre për të blerë këtë pasuri. Subjekti pretendon se blerësit e apartamentit në Fier, nuk duhen konsideruar si persona të tjerë të lidhur me subjektin, pasi në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk janë në marrëdhënie huaje apo dhurimi me subjektin, por janë blerës të apartamentit të shitur prej saj. Lidhur me këtë pretendim, i cili gjithashtu gjen një trajtim të hollësishëm në vijim, konstatohet, siç është evidentuar edhe në paragrafin 15.2 më sipër, se në vendimin e Komisionit është saktësuar se analiza për mundësitë ekonomike të blerësve të apartamentit në Fier, është bërë nisur nga disa elemente që kanë çuar para Komisionin drejt dyshimit se kishte të bënte me një shitje fiktive (apo *pasuri të fshehur të subjektit*) të bërë për të justifikuar blerjen e apartamentit në Tiranë. Nisur nga kjo premisë që vetë vendimi i Komisionit qartëson, siç Kolegji ka elaboruar tashmë në jurisprudencën e tij, edhe siç është arsyetuar edhe më lart, nuk evidentohen shkelje apo zbatim i gabuar i ligjit, por zgjerimi i hetimit duket se është kryer brenda kompetencave hetimore të Komisionit në raste të tilla në këndvështrim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 45 të ligjit nr. 84/2016²⁴.

15.32. Në përfundim, pas analizimit të shkaqeve të ankimit që kanë të bëjnë me parimet e procesit të rregullt ligjor, si dhe me zbatimin e procedurave nga Komisioni, trupi gjykues, mangësitë e konstatuara në procedurën e zëvendësimit e njoftimit të anëtarëve të trupës gjyquese të Komisionit, për sa rezulton se është bërë në kohën kur për çështjen nuk ishte kryer asnjë veprim hetimor administrativ dhe, për më tepër, kur subjekti nuk identifikon asnjë pasojë konkrete që i ka ardhur prej këtyre procedurave, i gjen ato të pamjaftueshme për të cenuar vendimin e Komisionit, me pasojë riparimin e tyre në seancë gjyqësore publike. Shkeljet e

²³ Akt i cili edhe ky mungon në fashikullin që Komisioni ka përcjellë në Kolegj dhe, me komunikim elektronik, është kërkuar të përcillet në Kolegj.

²⁴ Trupi gjykues ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga Komisioni lidhur me këtë çështje që çrelativizon edhe këtë aryetim.

procedurës në këtë rast nuk vlerësohen se janë të rënda dhe nuk kanë cenuar procesin e rregullt ligjor të zhvilluar në Komision dhe, mbi të gjitha, nuk rezulton asnjë lidhje mes tyre dhe shkeljes së të drejtave të subjektit për një hetim e gjykim të paanshëm e transparent.

15.33. Në përfundim të vlerësimit të shkaqeve procedurale të ngritura në ankim, krahas qëndrimit që trupi gjykues mori për kërkimin e subjektit për marrjen e provave të reja, të arsyetuar në paragrafin 14 më sipër, u arrit në konkluzionin se nuk provohej të ekzistonte asnjë prej situatave të parashikuara nga neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, që do të kërkonte nevojën e zhvillimit të gjykimit në seancë gjyqësore publike. Për pasojë, e gjeti kërkesën e subjektit edhe në këtë drejtim të pambështetur dhe vendosi të vijojë gjykimin në dhomë këshillimi mbi bazën e akteve të administruara përgjatë hetimit administrativ nga Komisioni.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

- 16.** *Lidhur me pasurinë apartament 2+1, me sip. 83,3 m², të ndodhur në lagjen “{***}” në Fier, të blerë në vitin 2000, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit se gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme në shumën prej (-) 2.018.362 lekësh për krijimin e kësaj pasurie, është konkluzion i një analize të mangët, jo të bazuar në situatën faktike, i ndikuar negativisht prej: (i) moskonsiderimit si burim i financimit të shumës prej 1.950.000 lekësh, të dhënë si kontribut subjektit nga prindërit e saj, të cilët e kanë siguruar atë nga shitja e apartamentit në lagjen “{***}” po në Fier, si dhe (ii) moskonsiderimit si burim financimi të shumës prej 600.000 lekësh, si kontribut nga prindërit e bashkëshortit, të siguruara nga shfrytëzimi i tokës bujqësore. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues analizon sa vijon.*

16.1. Komisioni, pasi ka kontrolluar mundësinë e subjektit për të financuar me burime të ligjshme blerjen e apartamentit 2+1 në Fier, në vitin 2000, duke iu referuar burimit të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, si të krijuar me *kursime familjare* dhe duke mos njohur mes tyre ato të dhëna prej prindërve të subjektit dhe personit të lidhur, ka konkluduar sa vijon.

[...] nga analiza e kryer, ka rezultuar pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme në shumën 2.018.362 lekë, për blerjen e apartamentit në Fier në vitin 2000.

*[...] Pas shqyrtimit të shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe akteve të depozituara prej saj, Komisioni konstaton mospërputhje deklarimesh, në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë apartament në Fier, pasi burimet e deklaruar në deklaratën *vetting*, nuk përputhen me burimet e deklaruar gjatë hetimit. Për mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e apartamentit në Fier, subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, si dhe nuk provoi me dokumentacion provues shumat e dhëna si nga prindërit e bashkëshortit, ashtu dhe nga prindërit e saj. Subjekti nuk arriti që të provonte burimet e ligjshme në shumën 600.000 lekë, të dhuruar nga prindërit e bashkëshortit, të krijuar me të ardhurat nga bujqësia. Subjekti, gjithashtu, nuk arriti të provonte burimet e ligjshme për shumën 1.950.000 lekë.*

16.2. Në funksion të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues mori në analizë deklarinet e bëra nga subjekti në deklaratën *vetting*, në deklarinet vjetore periodike (në vijim “DVP”), si dhe shpjegimet e dhëna gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision lidhur me burimet e financimit të kësaj pasurie, nga të cilat konstatoi se:

16.3. Nga shqyrtimi i deklaratës *vetting* dhe DVP-ve që subjekti ka bërë për apartamentin në lagjen “{***}” në Fier, konstatohet sa vijon:

- (i) Në deklaratën *vetting* për apartamentin në lagjen “{***}” në Fier, subjekti ka deklaruar: [...] *ky apartament është blerë me kursimet familjare ndër vite. Ky apartament është shitur i mobiluar me kontratën premtim shitje nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 06.12.2012, kundrejt shumës 73.000 euro, vlerë e cila është përdorur për blerjen me kontratën nr. {***}, datë 08.03.2012, të apartamentit me sip. 111 m² në {***}, Tiranë ({***}), me vlerë 8.500.000 lekë, si dhe garazhit i cili është blerë me anë të kontratës nr. {***}, datë 05.06.2012, me vlerë 7000 euro.*
- (ii) Në DVP-të 2003 - 2011, subjekti i rivlerësimit, si adresë banimi në Fier, ka deklaruar lagjen “{***}”, rruga “{***}”.
- (iii) Në DVP-në fillestare 2003, subjekti ka deklaruar pronësinë mbi një apartament në lagjen “{***}” në Fier, me vlerë 3,9 milionë lekë, për të cilën ka deklaruar burim financimi: “nga kursimet ndër vite”.
- (iv) Në DVP- 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen²⁵ e apartamentit në lagjen “{***}” në Fier në dhjetor të këtij viti, së bashku me orenditë shtëpiake të ndodhura në të, me vlerë totale 73.000 euro (55.000 euro banesa + 18.000 euro orenditë), nga të cilat ka mbetur pa u shlyer nga pala blerëse, shuma 5.000 euro.
- (v) Në DVP-2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen përfundimtare të banesës në lagjen “{***}” në Fier, me anë të kontratës nr. {***} rep., e nr. {***} kol., të datës 21.01.2016, duke përfituar shumën 5.000 euro (diferenca e mbetur nga kontrata premtim shitje e vitit 2012).

16.4. Nga të dhënat e fashikullit të hetimit administrativ, rezulton se nëpërmjet pyetësorit nr. 4, më datë 23.12.2020, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të deklarojë burimet e ligjshme të financimit që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në lagjen “{***}” në Fier, (të cilin, siç u evidentua edhe më sipër, e ka deklaruar në deklaratën *vetting*) si dhe depozitimin e dokumentacionit justifikues. Gjithashtu, Komisioni, me këtë pyetësor, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, të deklarojë kohën deri kur ky apartament është përdorur si banesë prej saj. Më datë 14.01.2021, në përgjigjet për këto pyetje, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime lidhur me burimet e financimit të kësaj pasurie duke detajuar/saktësuar se kursimet familjare kanë qenë në shumën prej 1.500.000 lekësh, dhe se për blerjen e kësaj pasurie kanë shërbyer edhe burimet, si: (a) të ardhurat e dhëna nga prindërit e saj në shumën prej 1.950.000 lekësh (që kanë buruar nga shitja e një shtëpie në qytetin e Fierit në vitit 2000), si dhe (b) të ardhurat e krijuara nga prindërit e bashkëshortit, në shumën prej 600.000 lekësh (nga bujqësia). Për pretendimet e mësipërme, subjekti ka depozituar në Komision dokumentacion mbështetës për të ardhurat e prindërve të saj dhe të bashkëshortit.

16.5. Lidhur me të ardhurat e prindërve të saj dhe të bashkëshortit, gjatë hetimit administrativ, si dhe në ankim, subjekti ka shpjeguar se në DVP-në fillestare të vitit 2003, ka deklaruar se zotëron ¼ e pasurisë apartament në lagjen “{***}”, në Fier, dhe se në deklarimin e pjesës

²⁵ Në fashikullin e hetimit administrativ, gjendet e administruar kontrata me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 06.12.2012, e lidhur midis subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit, si palë shitëse në të ardhmen dhe z. I. B. si palë blerëse në të ardhmen, me objekt “Premtim shitje e pasurisë apartament banimi me sip. 83,3 m², në lagjen “{***}”, Fier”. Në këtë kontratë, palët kanë përcaktuar se ekzistojnë këto kushte paraprake: “Pala shitëse dhe blerëse kanë rënë dakord që të shesë këtë apartamenti dhe orenditë shtëpiake, mobilie e pajisje hidrosanitare kundrejt shumë së përgjithshme 73.000 euro. Vlera e shitjes së apartamentit, për të cilën ata kanë rënë dakord, është 55.000 euro dhe vlera e orendive, mobilieve është 18.000 euro. Në kontratën noteriale “Premtim shitje”, nr. {***}, të datës 06.12.2013, palët deklarojnë se pala blerëse i ka paguar palës shitëse në ditën e lidhjes së kontratës, shumën 68.000 euro dhe se shuma e mbetur prej 5.000 eurosh do të likuidohet nga pala blerëse brenda një viti nga nënshkrimi i kësaj kontrate”.

zotëruese, ka pasur parasysh pikërisht kontributin e dhënë prej saj në blerjen e këtij apartamenti, në pjesë ideale. Subjekti shpjegon se përveç kursimeve nga pagat e shpërblimet nga puna e saj dhe e bashkëshortit, në mbledhjen e të ardhurave të nevojshme për blerjen e apartamentit, kanë kontribuar: **(i)** prindërit e bashkëshortit, Sh. dhe H. Sinanaj, të cilët kishin të ardhura të siguruara nga ushtrimi i veprimtarisë bujqësore e blegtorale në fshatin {***}, Mallakastër, të ardhura të deklaruara në mënyrë të përafërt nga subjekti në deklaratën fillestare të deklarimit të pasurisë në 2003; **(ii)** prindërit e subjektit Shefqet e S. R., me të ardhurat në shumën 1.950.000 lekë të siguruara nga shitja e apartamentit 1+1 në lagjen “{***}” në Fier, në të cilin ka jetuar subjekti deri në momentin e blerjes së apartamentit në lagjen “{***}”, objekt kontrolli.

16.6. Komisioni, pasi është njohur me shpjegimet e mësipërme, me rezultatet paraprake të hetimit, i ka kaluar subjektit barrë prove për sa vijon:

(i) Në lidhje me të ardhurat e dhëna nga prindërit e subjektit, Sh. e S. R. – në shumën prej 1.950.000 lekësh, të cilat janë përfituar nga shitja e apartamentit në Fier, më 22.06.2000, duke qenë se ka konstatuar se ato nuk mund të kenë shërbyer si burim për blerjen e pasurisë objekt kontrolli dy muaj para se të përfitoheshin, në datën 26.04.2000, dhe se përveç se nuk janë deklaruar nga subjekti si burim në deklaratën *vetting* dhe as në deklaratën fillestare të deklarimit të pasurisë, dhe se nuk provohet as transferimi i tyre nga prindërit te subjekti.

(ii) Në lidhje me shumën e dhënë si dhuratë nga prindërit e bashkëshortit, në vlerën prej 600.000 lekësh, me burim nga bujqësia, ka konstatuar se këto të ardhura nuk janë deklaruar nga subjekti në deklaratën *vetting* dhe as në deklarimin e fillestar si burim, si dhe nuk provohet burimi i ligjshëm i krijimit, ashtu dhe transferimi i tyre nga prindërit e personit të lidhur te subjekti i rivlerësimit.

Gjithashtu, me të njëjtin akt, Komisioni i ka bërë me dije subjektit se nga analiza financiare e kryer për të identifikuar të ardhurat e ligjshme për blerjen e apartamentit në Fier, në prill të vitit 2000, në të cilën janë përfshirë: **a)** si të ardhura vetëm ato të siguruara nga subjekti dhe bashkëshorti nga paga dhe shpërblimet (për periudhën 1994 – prill 2000), dhe **b)** si shpenzime kostot e jetesës së kësaj periudhe, rezulton se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e këtij apartamenti, pasi ka rezultuar me një balancë negative në shumën (-) 2.018.362 lekë.

16.7. Subjekti i rivlerësimit, më datë 21.06.2021, në prapësimet e paraqitura për rezultatet paraprake të hetimit administrativ, lidhur me burimet e financimit të apartamentit në lagjen “{***}”, Fier, ka mbështetur shpjegimet e dhëna me përgjigjet për pyetësonin nr. 4, duke prezantuar detaje për të ardhurat e familjes së saj të origjinës, si dhe të prindërve të bashkëshortit, Sh. dhe H. S., sipas të cilave:

(i) Në lidhje me shumën 1.950.000 lekë, pavarësisht faktit se kontrata e shitblerjes²⁶ është formalizuar në datën 22.06.2000, pra pas lidhjes së kontratës së shitblerjes për apartamentin objekt kontrolli, çmimi i shitjes është paguar nga blerësit në muajin prill të këtij viti. Sipas subjektit, kjo marrëveshje u bë me blerësin, pasi kjo shumë do t’u paguhej më parë për shkak të nevojës që subjekti kishte për blerjen e banesës 2+1 në lagjen “{***}” në Fier, dhe se familja e subjektit do të qëndronte në këtë banesë edhe për dy muaj të tjerë, derisa të përfundonin kryerjen e disa punimeve të domosdoshme në banesën e re. Pikërisht për këtë shkak edhe kontrata e shitjes është lidhur pas lirimit dhe dorëzimit të apartamentit, në fund të qershorit të

²⁶ Me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., e datës 22.06.2000, e lidhur para noterit Z. B., me palë shitëse Sh. R. e S. R. e palë blerëse B. F..

vitit 2000. Subjekti ka theksuar se shitja e apartamentit në rrugën “{***}”, Fier, formalisht është bërë nga prindërit e saj, meqenëse pronësia ishte në emër të tyre, por në fakt ajo shpjegon se kjo banesë i ishte dhuruar subjektit nga prindërit që në momentin që ishte blerë, si dhe është zotëruar prej saj pasi prindërit kishin banesë tjetër, të përfituar me privatizim. Subjekti gjithashtu evidenton se të ardhurat e siguruar prej prindërve nga shitja e banesës në lagjen “{***}”, Fier, në shumën 1.950.000 lekë, i janë dhënë asaj në formën e kontributit për blerjen e banesës së re, por edhe në këmbim të pjesës takuese që ajo kishte në apartamentin e përfituar me privatizim nga Ndërmarrja Komunale Banesa më datë 10.03.1993, në të cilin, për shkak të moshës madhore, në momentin e privatizimit, u bë bashkëpronare së bashku me prindërit, me 1/3 pjesë takuese.

(ii) Lidhur me shumën prej 600.000 lekësh, dhuruar prej prindërve të bashkëshortit, Sh. dhe H. S., subjekti ka shpjeguar se ata, në momentin e blerjes së banesës, kanë qenë në gjendjen civile me familjen e saj, pavarësisht faktit se nuk kanë jetuar së bashku. Pikërisht për këtë shkak janë deklaruar edhe të ardhurat dhe pasuritë e tyre në deklaratën fillestare të deklarimit të pasurisë të vitit 2003²⁷. Prindërit e bashkëshortit i kanë realizuar këto të ardhura nga veprimtaria bujqësore dhe blegtorale e ushtruar prej tyre, kjo e mbështetur edhe në deklaratimet e subjektit për tokën bujqësore të përfituar me ligjin nr. 7501/1991, me anë të të cilit kanë përfituar 17.470 m² tokë arë dhe ullishte në fshatin {***}, Mallakastër. Duke qenë se familja e bashkëshortit ka jetuar gjithmonë në fshat, ata janë marrë me bujqësi dhe kanë realizuar të ardhura nga kjo tokë. E drejta e pronësisë mbi sipërfaqen e tokës në fjalë është deklaruar prej saj në deklaratën e vitit 2003, madje në rubrikën “Të ardhura vjetore në milion/lekë”, është shënuar “0,5”. Kjo e dhënë, sipas subjektit, provon se konstatimi i Komisionit se këto të ardhura nuk janë deklaruar, nuk qëndron.

16.8. Nga sa evidentuar më sipër, trupi gjykues çmon se në funksion të shqyrtimit të shkakut të ankimit që i adresohet përfshirjes së të ardhurave nga prindërit e subjektit dhe bashkëshortit në mesin e burimeve të financimit të pasurisë apartament objekt kontrolli, *së pari* duhet të analizohen deklaratimet e subjektit në deklaratën *vetting*, në DVP, apo gjatë hetimit administrativ, lidhur me identifikimin këtyre të ardhurave si burim për krijimin e kësaj pasurie dhe *së dyti*, nëse do të përfshihen ato nën përcaktimin “kursimet familjare ndër vite”, të dhënë në deklaratën *vetting* si burim.

16.9. Kësaj analize iu nënshtroan të dyja shumat e pretenduara se kanë shërbyer si burim financimi, ajo prej 1.950.000 lekësh e dhuruar prej prindërve të subjektit dhe ajo prej 600.000 lekësh e dhuruar prej prindërve të bashkëshortit të subjektit. Lidhur me shumën e parë, referuar deklaratimeve për burimin e krijimit të pasurisë, si prej “kursimeve familjare në vite”, të përcaktuar në deklaratën *vetting*, trupi gjykues fillimisht evidenton se prindërit e subjektit nuk bënin pjesë në familjen saj në kohën e krijimit të pasurisë, në vitin 2000, duke qenë se ajo kishte lidhur martesën ligjore dhe kishte krijuar familjen e saj të re. Në këtë kuptim, interpretimi i deklarimit se me “kursime familjare në vite” do të duhet të përfshijë edhe të ardhura të krijuara jo prej pjesëtarëve të familjes, sipas përbërjes së familjes si institut ligjor, nuk vlerësohet i bazuar dhe nuk mund të shërbejë, në vlerësimin e kësaj trupe, për të konsideruar edhe këto ardhura të krijuara prej prindërve të subjektit si burim krijimi të kësaj pasurie.

²⁷ Në DVP-në para fillimit të detyrës të vitit 2003, subjekti ka deklaruar: “Pronësinë e një sipërfaqeje toke prej 17.470 m², e ndodhur në fshatin {***}, Mallastër, e regjistruar në emër të Sh. S., e përfituar nga ligji nr. 7501, “Për tokën”, datë 19.07.1991, për të cilën ka deklaruar të ardhura në shumën 0,5 milion lekë.

16.10. Përveç kësaj analize, nga aktet e hetimit administrativ, rezultojnë se:

Së pari, shuma prej 1.950.000 lekësh, si e ardhur nga shitja e një apartamenti në pronësi të babait të saj, është deklaruar prej subjektit si burim financimi (në formë kontributi nga prindërit), vetëm në përgjigjet e pyetësorit nr. 4, gjatë hetimit administrativ, dhe nuk është deklaruar si e tillë në deklaratën *vetting* dhe as në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003. *Së dyti*, ashtu si edhe Komisioni, trupi gjykues konstaton se nuk ka të dhëna të kohës, përveç faktit se pasuria e cila ka shërbyer për krijimin e shumës, është përdorur prej subjektit për banim, se të ardhurat e krijuara prej shitjes së saj të kenë kaluar efektivisht në favor të subjektit, në ndonjë nga mënyrat që mund të provohen qoftë edhe në nivel indiciesh, siç mund të ishte një kontratë dhurimi, një transaksion financiar i dokumentuar apo një akt në të cilin të deklarohet vullneti në kohën e pretenduar se ka ndodhur marrja e shumës. Në këtë kuptim, mbetet në nivel deklarativ pretendimi se kjo shumë është përfituar prej subjektit të rivlerësimit në kohën e krijimit të pasurisë objekt kontrolli.

Së treti, trupi gjykues, pavarësisht analizës së mësipërme që u dedikohet deklaramëve të subjektit dhe provueshmërisë së marrëdhënies mes saj dhe prindërve lidhur me këtë shumë, tentoi një vlerësim dhe i nënshtroi analizës financiare verifikimin e mundësisë së prindërve të subjektit për të blerë me të ardhura të ligjshme apartamentin 1+1 në Fier, në vitin 1998, në shumën 1.950.000 lekë, e cila rezultojnë të mos jetë kryer në Komision, pasi e ka konsideruar të panevojshme në kushtet kur subjekti nuk e ka deklaruar këtë burim financimi të apartamentit 2+1 në Fier, në deklaratën *vetting* dhe as në deklaratën fillestare të pasurisë në vitin 2003. Nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj (në vijim “NJShL”), u krye një analizë hipotetike në versionin që prindërit e subjektit do të konsideroheshin si persona të tjerë të lidhur për dhurimin e kësaj shume, në kuptim të përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Analiza bazike (të ardhura dhe shpenzime jetese) u krye mbi bazën e akteve që subjekti kishte paraqitur në Komision për të provuar të ardhurat që kishin në dispozicion asokohe prindërit e saj, për të cilat subjekti pretendonte se më së shumti, ishin krijuar nga aktiviteti i bar-kafesë që ishte në pronësi të nënës së saj. Në kushtet kur në tërësinë e akteve të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, mungonin të dhëna të kohës së krijimit të të ardhurave që provonin xhiron e aktivitetit të bar-kafesë, si dhe pagesën e detyrimeve tatimore lidhur me to, NJShL-ja e pati të pamundur të evidentojë fitimin e gjeneruar nga ky aktivitet. Për rrjedhojë, në analizën financiare të prindërve të subjektit, u përfshinë vetëm të ardhurat për të cilat kishte akte të kohës që provonin përfitimin e tyre (siç ishin ato të pensioneve dhe të pagës së prindërve), dhe nga kjo analizë rezultoi se prindërit e subjektit nuk kishin mundësi për të financuar me të ardhura të ligjshme blerjen e apartamentit 1+1 në lagjen “{***}” në Fier në vitin 1998.

16.11. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se të ardhurat e siguruara prej prindërve nga shitja e banesës në lagjen “{***}” në Fier, në shumën 1.950.000 lekë, i janë dhënë asaj në formën e kontributit për blerjen e banesës së re, por edhe në këmbim të 1/3 pjesës takuese që ajo kishte në apartamentin e përfituar me privatizim nga Ndërmarrja Komonale Banesa më datë 10.03.1993²⁸, u gjend nga trupi gjykues pa peshë, në kuadër të fakteve dhe analizës së kryer më sipër për këtë burim. Përfundimisht, lidhur me këto të ardhura, në analizë të të gjitha fakteve të renditura më lart, dhe kryesisht për shkak se deklarimi i subjektit të rivlerësimit i bërë në funksion të procesit të rivlerësimit kalimtar në deklaratën *vetting*, si edhe deklarimi i bërë në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003, se si burime financimi për blerjen e kësaj pasurie

²⁸ Në këtë apartament, subjekti i rivlerësimit, meqenëse në momentin e privatizimit kishte moshë madhore, u bë bashkëpronare së bashku me prindërit, me 1/3 pjesë takuese.

kanë shërbyer “kursimet familjare ndër vite”, janë deklarime të cilat lënë jashtë përfshirjes në tërësinë e burimeve të financimit të përdorura për blerjen e saj, të ardhurat e prindërve të subjektit të siguruara po në vitin 2000, nga shitja e një apartamenti 1+1 në lagjen “{***}” në Fier, në pronësi të tyre. Trupi gjykues arriti në konkluzionin se me të drejtë Komisioni nuk i ka përfshirë ato mes burimeve të financimit të apartamentit të blerë në Fier në vitin 2000 prej subjektit dhe personit të lidhur.

16.12. Lidhur me shumën prej 600.000 lekësh të pretenduar se është dhuruar si kontribut prej prindërve të bashkëshortit, trupi gjykues ndoqi të njëjtën metodologji si më lart. Në funksion të dhënies përgjigje të pretendimit të subjektit lidhur me të, mori fillimisht në analizë rrethanat që përcaktojnë nëse kjo shumë mund të përfshihet mes burimeve “kursime familjare në vite”, të deklaruara si të tilla në deklaratën *vetting*.

16.13. *Së pari*, nga të dhënat e fashikullit të hetimit administrativ, rezulton se subjekti i rivlerësimit në vitin 2000, kur ka blerë apartamentin 2+1 në Fier, ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me prindërit e bashkëshortit, Sh. dhe H. S., ndonëse nuk kanë jetuar së bashku, por në ekonomi të veçanta. Në këtë kuptim, në ndryshim nga analiza që u bë për prindërit e subjektit më lart, këta të fundit (vjehri) mund të konsiderohen se bëjnë pjesë në njësinë familjare të subjektit, referuar gjendjes së përbashkët familjare dhe përcaktimeve që bën ligji nr. 84/2016, i cili konsideron si persona të lidhur anëtarët e përbashkët të gjendjes familjare. Trupi gjykues vlerësoi se nën një qëndrim garantist dhe interpretim teleologjik të dispozitave, familja e subjektit në vitin 2000, kur ajo ka blerë apartamentin objekt kontrolli, përbëhej edhe prej prindërve të bashkëshortit, përderisa ata ishin në të njëjtën gjendje familjare me të.

16.14. *Së dyti*, nga të dhënat e deklaratës fillestare të vitit 2003, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, ka deklaruar se në përbërje të familjes së saj, përveç bashkëshortit dhe dy fëmijëve, janë edhe prindërit e bashkëshortit, Sh. dhe H. S.. Në shpjegimet që subjekti ka dhënë gjatë hetimit administrativ, si edhe në ankim, deklaroi se prindërit e bashkëshortit edhe pse ishin në të njëjtën gjendje familjare me subjektin, kanë jetuar gjithmonë në fshatin {***}, Mallakastër. Në këtë deklaratë, në formularin A-1, të emërtuar “Pasuri të paluajtshme dhe të drejta reale mbi to”, subjekti ka deklaruar se në emër të Sh. S. është e regjistruar një sipërfaqe toke prej 17.470 m², e ndodhur në fshatin {***}, Mallakastër, e përfituar nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991, me shpjegimin se pjesën që zotëron “0%”, për të cilën ka deklaruar se përfiton të ardhura vjetore në masën “0.500.000 milion lekë”

16.15. Për sa më lart, trupi gjykues e vlerëson të besueshëm pretendimin e subjektit se prindërit e bashkëshortit kanë kontribuar në krijimin e pasurisë së apartamentit objekt kontrolli, për shkak të faktit se ata kanë qenë në një gjendje familjare me subjektin dhe se në deklaratën fillestare, subjekti ka pasqyruar të dhëna rreth pasurisë së tyre dhe të ardhurave të krijuara prej saj, ndonëse nuk i ka përcaktuar shprehimisht këto të ardhura si burim për krijimin e pasurisë në deklaratën *vetting* apo në deklaratën fillestare të pasurisë. Për këtë arsye, në vijim të analizës financiare, familja e subjektit të rivlerësimit do të konsiderohet duke përfshirë në të edhe prindërit e bashkëshortit të subjektit, duke u ndalur në verifikimin e mundësisë së tyre për të krijuar me burime të ligjshme shumën prej 600.000 lekësh për blerjen e apartamentit në Fier, në prill të vitit 2000.

16.16. Subjekti ka pretenduar në ankim se, shuma prej 600.000 lekësh është kontribut i prindërve të bashkëshortit, e krijuar nga shfrytëzimi i tokës bujqësore me sip. 17.470 m² e ndodhur në fshatin {***}, Mallakastër, e përfitur nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991. Gjithashtu, rezulton se gjatë hetimit administrativ²⁹, subjekti i ka vënë në dispozicion Komisionit edhe të dhëna lidhur me të ardhurat nga pensionet që përfitonin prindërit e bashkëshortit të saj. Në ankim, subjekti, për të ardhurat nga toka bujqësore, kërkon të merren në konsideratë të dhënat e ofruara në aktin e vlerësimit të përpiluar nga ekspert i fushës së agronomisë³⁰, që sipas subjektit, konfirmon mundësinë e realizimit të një shume të konsiderueshme të ardhurash nga aktiviteti i ushtruar në kushtet dhe rrethanat konkrete në të cilat janë ndodhur vjehri dhe vjehrra e saj, të vendndodhjes së pronës dhe të karakteristikave që paraqet zona. Gjithashtu, subjekti deklaron se aktiviteti bujqësor për periudhën në fjalë, nuk ishte aktivitet që mund të regjistrohej sipas parashikimit ligjor të kohës, ndaj edhe është e pamundur aktualisht të evidentohet saktësisht shuma konkrete e të ardhurave të realizuara. Në ankim, ashtu si edhe gjatë hetimit administrativ, subjekti shpjegon se për të gjithë periudhën, nga marrja e tokës në pronësi e deri aktualisht, prindërit e bashkëshortit kanë shlyer detyrimet tatimore, fakt i provuar nga vërtetimi me nr. {***} prot., datë 19.12.2019, i lëshuar nga Bashkia Mallakastër, i cili pasqyron shlyerjen e të gjitha taksave dhe tarifave nga z. Sh. S..

16.17. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, edhe pse gjen bindës pretendimin e subjektit se toka bujqësore në fshatin {***}, Mallakastër, me sip. 17.470 m², është e mjaftueshme për të përballuar jetesën e familjes bujqësore së cilës ajo i është dhënë, nga ana tjetër, konstaton se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi të provojë se sa kanë qenë të ardhurat e siguruar nga shfrytëzimi i kësaj toke, për sa kohë akti i vetëm i cili referon të dhëna mbi të ardhurat e gjeneruara prej saj, është një akt vlerësimi i lëshuar nga studio “{***}, nënshkruar nga ekspertja agronome e licencuar R. M. i hartuar në funksion të procesit të rivlerësimit, mbi të dhënat e ofruara nga vetë subjekti dhe jo i bazuar në të dhëna të kohës që provojnë mbjelljen e tokës bujqësore, shitjen e produkteve dhe, për pasojë, gjenerimin e të ardhurave. Në këto kushte, trupi gjykues, në konsideratë edhe të faktit se kontrolli dhe analiza duhet të shtrihen në një periudhë të largët, e cila për më tepër daton para miratimit të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare nga të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003), duke vlerësuar se: **(i)** subjekti i rivlerësimit, në momentin e blerjes së apartamentit 2+1 në Fier, në vitin 2000, ishte në të njëjtën përbërje familjare së bashku me prindërit e bashkëshortit; **(ii)** në deklarimin fillestar të pasurisë, subjekti ka deklaruar përfitimin e shumës 500.000 lekë nga

²⁹ Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ për të ardhurat e Sh. dhe H. S., ka paraqitur aktet si vijojnë: **(i)** DVP fillestare 2003, në të cilën ka deklaruar të ardhura nga bujqësia për prindërit e bashkëshortit, që ishin në të njëjtën përbërje familjare me të, në shumën 0,5 milion lekë; **(ii)** të dhënat e AMTP-së, që tregojnë bashkëpronësinë e bashkëshortit të subjektit, si pjesë e familjes bujqësore në vitin 1991; **(iii)** sigurimin e nënës së bashkëshortit të subjektit në skemën e sigurimeve shoqërore si e “vetëpunësuar në bujqësi”; **(iv)** si dhe konfirmimin që për të gjithë periudhën nga marrja e tokës në pronësi e deri aktualisht, prindërit e bashkëshortit kanë shlyer detyrimet tatimore, fakt i provuar nga vërtetimi me nr. {***} prot., datë 19.12.2019, i lëshuar nga Bashkia Mallakastër, i cili provon shlyerjen e të gjitha taksave dhe tarifave nga z. Sh. S.; **(v)** aktin e vlerësimit të përpiluar nga ekspert i fushës së agronomisë që, sipas subjektit, konfirmon mundësinë e realizimit të një shume të konsiderueshme të ardhurash nga aktiviteti i ushtruar në kushtet dhe rrethanat konkrete në të cilat janë ndodhur vjehri dhe vjehrra e saj, të vendndodhjes së pronës dhe të karakteristikave që paraqet zona. Gjithashtu, subjekti shpreh se aktiviteti bujqësor për periudhën në fjalë nuk ishte aktivitet që mund të regjistrohej sipas parashikimit ligjor të kohës, ndaj edhe është e pamundur aktualisht të evidentohet saktësisht shuma konkrete e të ardhurave të realizuara; **(vi)** deklaratat noteriale nr. {***} rep., e nr. {***} kol., të lëshuara nga prindërit e bashkëshortit të subjektit.

³⁰ Raport vlerësimi, hartuar nga “{***}”, nënshkruar nga ekspertja agronome e licencuar R. M..

shfrytëzimi i tokës bujqësore me sip. 17.470 m², vlerëson si të besueshëm përdorimin si burim të krijimit të kësaj pasurie, të të ardhurave që vijnë nga ky aktivitet, të cilat iu nënshtruan kontrollit nga trupi gjykues. Për një version sa më garantist të analizës financiare, trupi gjykues konsideroi se për shkak të përdorimit të tokës bujqësore, prindërit e bashkëshortit kanë pasur mundësi të mbulojnë kostot e jetesës, me të ardhurat e krijuara nga pasuria bujqësore e blegtorale, rrethanë e cila hipotetikusht ka mundësuar që ata të kontribuojnë në ekonominë e përbashkët familjare, të paktën me të ardhurat e siguruar nga pensionet e tyre e për të cilat gjenden dokumente shkresore që provojnë vlerat e përmuajshme të siguruar.

16.18. Si rezultat i kësaj analize, në mungesë të të dhënave që konfirmojnë të ardhurat e realizuara nga veprimtaria bujqësore e tyre, trupi gjykues vlerësoi se shumica e cila mund të konsiderohet në vlerësimin e aftësive financiare për prindërit e bashkëshortit, mund të shkojë deri në vlerën prej 333.163 lekësh, e realizuar prej përfitimit të pensionit të pleqërisë, si e vetmja e ardhur që përmbush kriteret e së ardhurës së ligjshme sipas standardit kushtetues e ligjor në këtë proces dhe është e evidentueshme për nga ekzistenca dhe sasia.

16.19. Lidhur me burimet e krijimit të pasurisë apartament, të ndodhur në Fier, subjekti i rivlerësimit ka ngritur edhe pretendime që lidhen me disa përlllogaritje të pasakta të kryera nga Komisioni, të cilat duhet të korrigjohen nga Kolegji, e që konsistojnë në: **(i)** llogaritjen e të ardhurave nga punësimi i bashkëshortit të subjektit në shoqërinë “{***}” ShA, për periudhën 1994 - 2000, si dhe **(ii)** përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës para vitit 2000, për të cilat trupi gjykues analizon sa vijon.

16.20. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga punësimi në shoqërinë “{***}” ShA³¹, për periudhën 1994 - prill 2000, konstatohet se Komisioni i ka llogaritur ato në shumën 1.184.764 lekë, e cila rezulton të jetë me një diferencë prej 115.585 lekësh më pak se shumica e pretenduar nga subjekti, prej 1.300.349 lekësh. Komisioni, për periudhën në fjalë, është bazuar në informacionin që ofron një dokument i depozituar nga subjekti³², në të cilin janë saktësuar pagat *neto* të bashkëshortit sipas formularëve të ISSh-së, me shumatat përkatëse të cilat Komisioni qartëson se janë reflektuar në analizën financiare, duke evidentuar se në total janë në shumën prej 1.183.185 lekësh. Subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, pretendon se të ardhurat e pretenduara prej saj e të cilat duhet të konsiderohen prej Kolegjit, u referohen të dhënave të dy vërtetimeve të lëshuara nga shoqëria, pasi ato plotësojnë njëra-tjetrën për periudhat e munguara. Sipas subjektit, për muajt qershor 1997, prill, tetor dhe nëntor 1998, për të cilat mungon listëpagesa/borderoja, duhet të konsiderohen të dhënat e vërtetimit nr. {***}, datë 23.01.2017, të lëshuar nga “{***}” ShA, ndërsa shifrat e tjera në formë tabelare duhet të merren nga të dhënat që rezultojnë nga korrespondenca e dorëzuar në Komision me pyetësin e datës 23.12.2020.

16.21. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, sipas të cilit, në shifrën e llogaritur nga Komisioni, mungojnë të ardhurat e katër muajve nga paga e bashkëshortit, në një shumë totale prej 115.585 lekësh, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision, shkresën me nr. 481, datë 23.01.2017, të lëshuar nga shoqëria “{***}” ShA dhe të firmosur nga personi

³¹ Shkresë e lëshuar nga “{***}” ShA me nr. {***} prot., datë 23.01.2017, bashkëlidhur së cilës janë dorëzuar vërtetimet mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare neto për periudhën 1994-2013.

Në përgjigje të pyetësorit të dërguar më datë 23.12.2020, subjekti ka kërkuar përsëri informacion nga “{***}” ShA për dokumentacion justifikues në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit.

³² Referencat e dokumentit.

përgjegjës³³, në të cilën për periudhën janar 1997 deri në prill 2000, vërtetohet se të ardhurat e përfituara nga punonjësi M. S., janë në shumën prej 1.183.185 lekësh, shifër kjo e marrë në konsideratë edhe nga Komisioni në analizën financiare për blerjen e apartamentit në vitin 2000. Bashkëlidhur kësaj shkrese, gjenden formularët sipas standardit të miratuar të ISSh-së, me emërtimin “Vërtetimi për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare”, nga i cili rezulton se për muajt e pretenduar nga subjekti si të munguar³⁴ në analizën e Komisionit, ka të evidentuar vlerat përkatëse të të ardhurave të përfituara.

16.22. Gjithashtu, konstatohet se me përgjigjet e dhëna për pyetësorin nr. 5, datë 23.12.2020, subjekti i rivlerësimit për vitet 1994 – 2006, për bashkëshortin, ka paraqitur në Komision dhe disa formularë të tjerë me emërtimin “Vërtetim page”, të lëshuara përsëri nga shoqëria “{***}” ShA dhe të firmosura nga 4 nëpunës³⁵, në të cilët të ardhurat e siguruara nga z. M. S., për periudhën specifike janar 1994 – prill 2000, rezultojnë në shumën prej 1.226.440 lekësh, vlerë kjo më e madhe (prej 43.255 lekësh) nga vlera e të ardhurave të deklaruara në vërtetimin e cituar në paragrafin më sipër. Në këtë formular, të emërtuar “Vërtetim page”, për muajt e pretenduar nga subjekti, gjendet shënimi “Grisur” ose “Mungon fleta në bordero”, dhe qeliza në tabelën respektive e të ardhurave nuk ka vlerë mujore. Në këto kushte, subjekti pretendon që të ardhurave të formularëve me emërtimin “Vërtetim page”, duhet t’u shtohen të ardhurat e muajve të munguar, për të cilët ka të evidentuara vlera në vërtetimet e lëshuara nga shoqëria “{***}” ShA, nëpërmjet shkresës nr. {***}, datë 23.01.2017. Vlera e pretenduar nga subjekti sipas kësaj logjike, është 1.300.350 lekë (1.226.440 lekë + 73.910 lekë).

16.23. Në analizë të situatës faktike të përshkruar më lart, trupi gjykues, duke u referuar në shpjegimet e mësipërme, si dhe në të dhënat e shkresave të lëshuara zyrtarisht nga shoqëria “{***}” ShA, çmon se pavarësisht se ka mospërputhje midis formularëve, vlera e të ardhurave që duhet t’i përllogaritet bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në analizën financiare, duhet të jetë shuma e derivuar nga të dy formularët së bashku, pasi të dy formatet e të dhënave janë të certifikuara/miratuara/firmosura nga po i njëjti institucion. Në vlerësimin e trupit gjykues, arsyeja e mungesës së të dhënave, sipas përshkrimit të formularëve, “për shkak të fletës së grisur apo të munguar e borderosë”, duke mos qenë e lidhur/shkaktuar nga mungesa e ditëve të punës apo largimit nga puna të bashkëshortit të subjektit, nuk është një rrethanë që duhet të ketë ndikim negativ në analizën financiare, duke reduktuar shumën e të ardhurave të krijuara realisht nga punësimi i bashkëshortit të subjektit në këtë periudhë.

16.24. Në përfundim, trupi gjykues konkludoi se shuma e të ardhurave për t’u konsideruar në analizën financiare të subjektit për blerjen e apartamentit në Fier në vitin 2000, si e ardhur nga punësimi i bashkëshortit në shoqërinë “{***}” ShA, do të jetë në shumën e pretenduar nga subjekti, prej 1.300.350 lekësh.

16.25. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se shpenzimet e jetesës për vitet 1994 – 1999, në analizën financiare të Komisionit nuk duhet të ishin përllogaritur në masën sa 66%

³³ Firmosur nga drejtori i Drejtorisë së Financës, z. P. B..

³⁴ Respektivisht, qershor 1997 (12.072 lekë), prill 1998 (20.083 lekë), tetor 1998 (19.654 lekë) dhe nëntor 1998 (22.102 lekë).

³⁵ Personat që kanë firmosur vërtetimet e lëshuara nga “{***}” për të ardhurat e z. M. S.:

- specialistja e financës E. Z.;
- drejtori i financës A. L.;
- drejtoresha e burimeve njerëzore F. A., si dhe
- administratori B. Z..

e të ardhurave nga pagat, por duhet të ishin përlllogaritur duke iu referuar të dhënave për frymë për këtë periudhë, bazuar në të dhënat që referon INSTAT, duke konsideruar si shpenzime respektivisht: **(i)** në vitin 1994 – 4.000 lekë/person në muaj; **(ii)** në vitin 1995 dhe 1996 – 5.000 lekë/person në muaj; **(iii)** në vitin 1997 – 6.000 lekë/person në muaj; **(iv)** në vitin 1998 – 7.000 lekë/person në muaj; dhe **(v)** në vitin 1999 dhe 2000 – shpenzimet e jetesës duhen përcaktuar sipas INSTAT, trupi gjykues analizon sa vijon.

16.26. *Së pari*, në vendimin objekt shqyrtimi të Komisionit, është arsyetuar se për vitet 1994 – 1999, përlllogaritja e shpenzimeve të jetesës nuk mund të bëhet duke iu referuar të dhënave për frymë që referon INSTAT, pasi ky qëndrim vjen në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit, e cila për situata të ngjashme ka arsyetuar se: “Shpenzimet e jetesës deri në vitin 1999, janë llogaritur në masën 66% e të ardhurave”, duke argumentuar se, për rrjedhojë, kjo përlllogaritje është aplikuar edhe në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për periudhën në fjalë.

Së dyti, gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit, në funksion të analizës financiare për periudhën 1994-1999, ka identifikuar shpenzime jetese në masën prej 1.223.592 lekësh, e cila u korrespondon rreth 41,2 % të të ardhurave të periudhës objekt analize. Nisur nga kjo situatë, trupi gjykues vlerëson se në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, ka qenë e aftë të identifikojë shpenzime për periudhën 1994-1999, të cilat i ka ofruar në funksion të procesit të rivlerësimit kalimtar, në një vlerë më të lartë se ajo që do të rezultonte nëse do të aplikoheshin metodologjia e orientuar prej vendimit nr. 15/2021 të Kolegjit, e cila më së shumti, si një analizë garantiste me nivele shpenzimesh minimale, gjen aplikim kur subjektet nuk janë në gjendje të identifikojnë shpenzimet, e gjen të drejtë pretendimin se duhen vendosur si vlera shpenzimesh ato të përcaktuara prej vetë subjektit.

Së treti, edhe pasi NjShL-ja korrektoi të dhënat e analizës financiare, duke vendosur në të shifrën e pretenduar prej subjektit, si vlerë të shpenzimeve të jetesës për periudhën 1994-1999, sërish rezulton se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e apartamentit në Fier, në prill të vitit 2000.

16.27. Në përfundim të analizimit të shkaqeve të ankimit lidhur me pasurinë apartament 2+1, të ndodhur në lagjen “{***}”, Fier, të blerë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2000, me çmimin 3.900.000 lekë, trupi gjykues, në konsideratë të konkluzioneve më sipër, pas kontrollit të analizës financiare të kryer nga Komisioni, duke reflektuar në analizën financiare të subjektit njihjen e vlerës prej 333.163 lekësh, si kontribut prej prindërve të bashkëshortit, korrektuar të ardhurat nga pagat e bashkëshortit për periudhën 1999 - prill 2000, në vlerën prej 1.300.350 lekësh, si edhe duke korrektuar shpenzimet e jetesës për periudhën 1994 – 1999, në vlerën prej 1.223.592 lekësh, të pretenduar prej subjektit, konstatoi sërish se subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme në masën (-) 1.823.877 lekë, duke u gjendur për pasojë, në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

17. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se: *konkluzioni i Komisionit, se shitja e apartamentit 2+1, me sip. 83,3 m², në lagjen “{***}” në Fier, në dhjetor të vitit 2012, mund të ketë qenë një shitje fiktive, e kryer për të justifikuar blerjen e pasurisë apartament, me sip.*

111 m², në {***}, Tiranë³⁶, në mars të vitit 2012, dhe të pasurisë garazh³⁷ në qershor 2012, është një qëndrim i padrejtë dhe i pabazuar në situatën faktike, trupi gjykues analizon sa vijon.

17.1. Lidhur me shitjen e kësaj pasurie, Komisioni ka konkluduar se, mbështetur në disa elemente, ngrihen dyshime të arsyeshme që ajo mund të jetë pasuri e subjektit të rivlerësimit dhe shitja e kësaj pasurie te persona të afërt familjarë, është fiktive, për të justifikuar blerjen e një pasurie tjetër.

17.2. Komisioni e ka mbështetur konkluzionin e tij të mësipërm në faktet se: (i) apartamenti u shit, ndërkohë që vazhdonte të përdorej nga subjekti edhe një vit më pas; (ii) ky apartament nuk rezulton të jetë përdorur nga blerësi, ndërkohë që subjekti ka vijuar të paguajë faturat e furnizimit me energji elektrike; (iii) blerësi rezultoi në pamundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie, ndërkohë që gjatë hetimit, subjekti shpjegoi se ky apartament de fakto, është blerë dhe paguar nga shtetasi A. B.; (iv) çmimi i shitjes së apartamentit rezultoi më i lartë se sa çmimi i referencës sipas EKB-së; (v) blerësi ka paguar për pajisjet dhe mobiliet e përdorura një vlerë të lartë, ndërkohë apartamenti nuk banohet prej tij; si dhe (vi) të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit në Fier, janë deklaruar nga subjekti si burim për blerjen e shtëpisë apartament në Tiranë.

17.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë qëndrim të Komisionit, duke pretenduar se: (i) nuk është e justifikuar as ligjërisht dhe as e bazuar në jurisprudencën e Kolegjit³⁸, kryerja e analizës financiare për blerësit e apartamentit, I. e D. B., dhe përfshirja e tyre në kategorinë e personave të tjerë të lidhur të subjektit, pasi neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 ua jep këtë cilësi vetëm personave që me subjektet e rivlerësimit janë në marrëdhënie huaje apo dhurimi. Në këto kushte, subjekti pretendon se në rastin konkret, marrëdhënia e krijuar nga shitblerja e apartamentit nuk passjell konsiderimin e tyre si persona të tjerë të lidhur; (ii) nuk qëndron konkluzioni se shitja e apartamentit në Fier është një shitje fiktive për të justifikuar blerjen e një pasurie tjetër (apartamentit dhe garazhit në {***}, Tiranë), i cili rezulton të jetë blerë para shitjes së apartamentit në Fier. Konstatimet e Komisionit që e kanë çuar drejt konkluzionit se kemi të bëjmë me shitje fiktive të apartamentit në Fier, e që kanë të bëjnë me çmimin e shitjes, përdorimin e apartamentit, pamundësinë e blerësve për ta blerë atë, me pagesën e energjisë elektrike prej subjektit, i kundërshton si të pabazuara.

17.4 Në funksion të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues mori në analizë qëndrimin e Komisionit se shitja e apartamentit në Fier te persona të afërt, familjarë të subjektit, është fiktive për të justifikuar blerjen e një pasurie tjetër, duke arsyetuar mbi rrethanat e faktit të konstatuara nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ dhe të përdorura prej Komisionit për të mbështetur këtë konkluzion.

17.5 Së pari, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën vetting, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, se: *Për blerjen e banesës në {***}, Tiranë, në muajin janar*

³⁶ Të përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes (pasuri e paluajtshme) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 8.3.2012, me palë shitëse shoqërinë “{***}” ShPK dhe palë blerëse z. M. S., të pasurisë apartament me sip. 111 m², të ndodhur në {***}, Tiranë, regjistruar në {***}, me nr. pasurie {***}, vol. {***}, faqe {***}, në vlerën 8.500.000 lekë. Kjo vlerë është kryer tërësisht prej blerësit përpara nënshkrimit të kësaj kontrate shitjeje.

³⁷ Të përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes (pasuri e paluajtshme) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 5.6.2012, me palë shitëse A. P. e F. P. dhe palë blerëse M. S., të pasurisë garazh me sip. 30 m², regjistruar në zonën kadastrale nr. {***}, me nr. pasurie {***}, volumi {***}, faqe {***}, në vlerën 7.000 euro, e konvertuar në lekë 980.000 lekë. Kjo vlerë është likuiduar prej blerësit përpara nënshkrimit të kësaj kontrate shitjeje.

³⁸ Në ankim, subjekti referon arsyetimin e vendimit të Kolegjit të dhënë në vendimin (JR) nr. 21, datë 10.09.2020.

2012, fillimisht bashkëshorti im ka marrë hua në shumën 80.000 euro nga shtetasi A. C., [...] ky fakt është pasqyruar në kontratën noteriale me nr. {***} rep., e nr {***} kol., datë 17.01.2012. Pas shitjes së banesës që kam pasur në pronësi në qytetin e Fierit, në muajin dhjetor 2012, kjo shumë e marrë hua është shlyer totalisht [...]”. Sipas këtij deklarami, por edhe të dhënave të tjera që evidentohen nga aktet e fashikullit të hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se si burim fillestar të ardhurash për të kryer pagesën për blerjen e apartamentit në {***}, Tiranë, në mars të vitit 2012, si dhe të garazhit në qershor të këtij viti, ka shërbyer shuma 80.000 euro, e marrë hua nga z. A. C. (çështje objekt analize në pjesën vijuese të këtij vendimi). Në këto kushte, argumenti i përdorur nga Komisioni se shitja e apartamentit në Fier besohet se ka qenë fiktive për të justifikuar blerjen e një pasurie tjetër, duket jo krejtësisht i mbështetur në rrethanat e faktit. Për sa ka rezultuar nga deklaramet e subjektit, por edhe nga mënyra se si vetë Komisioni ka analizuar krijimin e pasurisë në Tiranë, duke verifikuar si burim krijimi të saj, huanë e deklaruar si të marrë prej dajës së subjektit, duket se nuk qëndron ajo që Komisioni jep si arsyen e hartimit të një kontrate fiktive për shitjen e pasurisë në Fier. Blerja e pasurisë në Tiranë rezulton të jetë kryer në janar të vitit 2012 dhe pagesat për shlyerjen e çmimit të saj po në këtë kohë, nëpërmjet huasë të deklaruar si burim, rrethana këto që e shkëpusin lidhjen shkakësore mes shitjes së apartamentit në Fier dhe blerjes së apartamentit në Tiranë. Ngjarjet juridike në këtë rast nuk provohet të jenë të ndërvarura nga njëra-tjera, por janë krijuar dhe kanë ekzistuar në mënyrë autonome. Për pasojë, trupi gjykues e gjen të pabazuar përdorimin e kësaj rrethane të analizuar nga Komisioni, si një prej arsyeve të cilat plotësojnë panoramën e një shitjeje fiktive. Subjekti, për të shlyer huanë e marrë dhe të përdorur si burim për blerjen e pasurisë në janar të vitit 2012, mund të kishte përdorur mënyra të ndryshme financimi dhe zgjedhja e shitjes së një pasurie të saj për ta shlyer atë, pas gati një viti nga lindja e marrëdhënies së huasë, nuk vlerësohet si një argument i mjaftueshëm për t’u përdorur në funksion të konkluzionit se ka pasur një shitje fiktive.

17.6 Së dyti, trupi gjykues mori në analizë argumentin tjetër të përdorur nga Komisioni për të mbështetur konkluzionin e shitjes fiktive, se *familja e subjektit të rivlerësimit ka vijuar ta përdorë këtë apartament edhe pas shitjes së tij*, rrethanë që është vlerësuar se ka potencuar dyshimin se subjekti nuk e ka shitur realisht këtë pasuri. Subjekti i rivlerësimit e kundërshton këtë qëndrim, duke sjellë në vëmendje se përdorimi i apartamentit pas shitjes së tij, nuk është një gjetje e Komisionit, por një e dhënë e evidentuar prej vetë asaj në kontratën premtim shitje nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 06.12.2012. Në kontratën premtim shitje, është përcaktuar se: *Palët kanë rënë dakord që shuma e mbetur, në vlerën 5.000 euro, do të likuidohet nga pala blerëse brenda vitit, duke filluar ky afat nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate. Palët kanë rënë dakord se në përfundim të afatit një vjeçar që do të konsiderohet 13.12.2013, pala shitëse do të bëjë dorëzimin e objektit (apartamentit dhe pajisjeve shtëpiake), si dhe do të realizojnë me njëri-tjetrin kontratën përfundimtare të shitblerjes të pasurisë apartament banimi*”. Më tej, në deklaratën noteriale nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 17.01.2014, deklaruesit M. S., Lindita Sinani dhe I. B. kanë deklaruar se në referim të përcaktimeve të kontratës premtim shitje nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 06.12.2012, *pala shitëse, duke vlerësuar gjendjen financiare dhe shëndetësore të palës blerëse, bie dakord që këstin e fundit, pala blerëse i detyrohet shitësit t’ia shlyejë brenda vitit 2015*. Nga aktet, konstatohet se kontrata e shitblerjes për këtë pasuri, është lidhur më datë 21.01.2016, me nr. {***} rep., e nr. {***} kol. Në ankim, subjekti shpjegon se fëmijët e saj kanë filluar të kryejnë shkollimin në Tiranë në shtator 2012, dhe se në kushtet kur në këtë periudhë, ajo dhe bashkëshorti ishin ende me punësim në Fier,

edhe pse rezultonin me banim të përhershëm në Tiranë, nuk duhet lënë jashtë vlerësimit fakti se apartamenti në Fier ka vijuar të jetë në posedim të tyre.

17.7 Për sa më sipër, trupi gjykues evidenton se nga aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, rezulton se përdorimi prej saj i apartamentit të ndodhur në Fier edhe pas kontratës së premtim shitjes, të nënshkruar në dhjetor të vitit 2012, është një element përbërës i kësaj kontrate dhe për të cilin palët janë dakordësuar që në hartimin e saj. Pas këtij kushti kontraktor, duket se gjendet nevoja e familjes së subjektit për përdorimin e apartamentit edhe një kohë pas dakordësimit për shitjen e tij, referuar nevojave të punësimit, por edhe pamundësisë së blerësve për pagimin e gjithë çmimit të shitjes së pasurisë, siç rezulton nga deklarata noteriale e vitit 2014, sipas së cilës shtyhet afati i pagesës së këstit të fundit, kusht i cili sipas kontratës së premtim shitjes, ishte i lidhur me përpilimin e kontratës së shitjes, por edhe me dorëzimin e apartamentit. Në këtë kuptim, dorëzimi i apartamentit në një kohë të mëvonshme jo vetëm ishte i parashikuar në kontratë dhe është deklaruar si i tillë prej subjektit, por edhe duket si një veprim që justifikohet, referuar të gjitha rrethanave të rastit. Për pasojë, fakti që subjekti e ka lidhur kontratën e shitblerjes së apartamentit në Fier më datë 21.01.2016, moment që duhet të përkojë me pagesën e këstit të fundit të çmimit të shitjes së apartamentit dhe që shuan të drejtat e pronësisë së subjektit mbi këtë pasuri së bashku me ato të përdorimit, lejon, në kuptim të të drejtave që gëzonte subjekti, që ajo të përdorte apartamentin deri në këtë kohë, rrethanë e cila, duke pasur një bazë ligjshmërie, nuk mund të përdoret në dëm të interesave të subjektit dhe të cenojë vlefshmërinë e kontratës së shitjes. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se ky argument nuk mund të ketë peshën e potencuar prej Komisionit në vlerësimin e fiktivitetit të dyshuar të kontratës së shitjes.

17.8 *Së treti*, lidhur me argumentin e Komisionit se *apartamenti në Fier nuk rezulton të jetë përdorur nga blerësi, ndërkohë që subjekti ka vijuar të paguajë faturat e furnizimit me energji elektrike*, rezulton sa vijon.

Në ankim, ashtu si dhe gjatë hetimit në Komision, subjekti i rivlerësimit shpjegon se blerësi, z. I. B., realisht këtë pasuri e ka blerë për llogari të vëllait të tij A. B., asokohe emigrant në Greqi, i cili, për shkak të problemeve familjare, nuk dëshironte që të figuronte si blerës i saj. Me këtë qëndrim, subjekti kërkon të potencojë faktin se blerësi real i kësaj pasurie, z. A. B., nuk kishte nevojë emergjente për të banuar në këtë apartament dhe, në të tilla kushte, ky element nuk mund të përdoret për të argumentuar se kemi të bëjmë me pasuri të fshehur të subjektit. Në ankim, subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, sqaron gjithashtu se pagimi nëpërmjet llogarisë së saj bankare i faturave të energjisë elektrike për apartamentin në Fier, deri në gusht të vitit 2016, është bërë për shkak se në muajin mars 2013, ajo ka autorizuar bankën për të kryer automatikisht pagesat e furnizimit me energji elektrike si për apartamentin në {***}, Tiranë, ashtu edhe për apartamentin në Fier, të cilin e kishte ende në zotërim për shkak se, sipas kontratës së premtim shitjes, do ta dorëzonte atë në fund të muajit dhjetor 2013. Në ankim, ashtu siç ka deklaruar edhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 4 të drejtuar nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar se këto pagesa janë bërë nga llogaria e saj bankare në BKT Bank, që kreditohej me pagën nga Gjykata e Shkallës së Parë Fier, e cila, pas transferimit të subjektit me punë në Tiranë, kreditohej edhe nga bashkëshorti dhe babai i saj me fonde që shkonin vetëm për pagimin e shpenzimeve të energjisë elektrike edhe të apartamentit në Fier, edhe atij në Tiranë (meqenëse pas transferimit në Tiranë, subjektit paga i kreditohej në Bankën Raiffeisen). Gjithashtu, subjekti në ankim shpjegon se këto pagesa për periudhën pas dhjetorit 2013, janë bërë automatikisht pasi ajo i ka dhënë bankës autorizim për kryerjen nga llogaria bankare, të

pagesës së energjisë elektrike të apartamentit në Tiranë, duke mos qenë e qartë se ka dhënë autorizim për të paguar çdo kontratë të furnizimit të energjisë që figuron në emër të saj. Subjekti parashtron se po ashtu, duhet mbajtur në vëmendje se në kushtet kur lidhja e kontratës përfundimtare të shitjes së këtij apartamenti, është bërë në janar të vitit 2016, është pamundësuar ndryshimi i emrit në kontratën e furnizimit me energji të këtij apartamenti para lidhjes së saj. Subjekti sjell në vëmendje në ankim edhe faktin se në harkun kohor nga viti 2013 e deri në gusht të vitit 2016, faturat e energjisë elektrike të paguara prej saj, nëpërmjet llogarisë bankare, për apartamentin në Fier, janë me vlera shumë të vogla për konsum familjar.

17.9 Në analizë të të dhënave të përshkruara si më sipër, rezulton se, nëpërmjet llogarisë bankare në BKT Bank, subjekti i rivlerësimit ka kryer pagesat e furnizimit me energji elektrike, ujë dhe ato të shërbimit të telefonisë si për apartamentin në Fier, edhe për atë në {***}, Tiranë. Për më tepër, rezulton se pagesat e energjisë elektrike për apartamentin në Fier, në harkun kohor nga viti 2013 e deri në vitin 2016, janë pothuajse në vlerë fikse kryesisht, 340 lekë në muaj. Këto vlera duket se përveçse jenë shumë të ulëta për një konsum familjar periodik, rezultojnë edhe ndjeshëm shumë më të ulëta nga vlerat që subjekti paguan nga e njëjta llogari për furnizimin me energji elektrike për apartamentin në {***}, Tiranë, dhe si të tilla ato duket se përfaqësojnë pagesën e tarifës fikse për shërbimin e lidhjes me rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe nuk provojnë në mënyrë domethënëse përdorimin e apartamentit nga familja e subjektit. Referuar të dhënave si më sipër, sipas të cilave nga dhjetori 2013 e deri në gusht të vitit 2016, apartamenti në Fier ka pasur konsum shumë të ulët të energjisë eklektike, si dhe faktit që kontrata përfundimtare e shitjes së kësaj pasurie është bërë në janar të vitit 2016, duket se kjo pasuri nuk është përdorur realisht përgjatë kësaj periudhe, qoftë nga subjekti apo nga dikush tjetër. Kjo e dhënë nuk duket se mbështet argumentin se apartamenti ka vijuar të përdoret prej subjektit e familjes së saj edhe gjatë kësaj periudhe, për shkak të të cilit subjekti ka paguar detyrimet për furnizimin me energji elektrike e ujë, si pasojë e një posedimi efektiv mbi këtë pasuri, sikur të ishte në pronësi të vetë subjektit.

17.10 *Së katërti*, lidhur me konstatimin e vendimit të Komisionit se *nuk provohet se kjo pasuri është përdorur nga blerësit, bazuar në sa evidentuar më sipër, ndonëse duket se qëndron si konkluzion, nuk mund të lexohet apriori në të kundërt, se apartamenti është përdorur prej subjektit apo familjes së saj, pasi siç u analizua më sipër, konsumi i energjisë elektrike sugjeron për mospërdorim të apartamentit nga askush.*

17.11 Lidhur me qëndrimin e Komisionit se *çmimi i shitjes së apartamentit rezultoi më i lartë se sa çmimi i referencës sipas EKB-së; dhe se blerësi ka paguar për pajisjet dhe mobiliet e përdorura një vlerë të lartë, ndërkohë apartamenti nuk banohet prej tij*, trupi gjykues analizon sa vijon.

17.12 Fillimisht, në ndryshim nga trajtimi i veçantë që Komisioni u bën këtyre dy elementeve, (çmimit të shitjes dhe vlerës së lartë të mobilimit), për shkak të faktit që vlera e siguruar nga shitja e orendive/mobilimit të apartamentit në Fier, është pjesë integrale e kontratës së shitblerjes së këtij apartamenti, trupi gjykues vlerëson se ato duhet të trajtohen së bashku. Nga analizimi i përmbajtjes së kontratës “Premtim shitje” të datës 06.12.2012, konstatohet se palët kanë përcaktuar se çmimi i shitjes së apartamentit është në vlerën 55.000 euro dhe se vlera e shitjes së orendive të tij është në shumën 18.000 euro. Komisioni ka arritur në konkluzionin për përcaktimin e një çmimi të lartë shitjeje, bazuar në krahasimin e tij me çmimet e tregut të lirë, të përlllogaritura sipas udhëzimit të Entit Kombëtar të Banesave (në vijim “EKB”), për

vitin 2012. Në ankim, subjekti e kundërshton këtë qëndrim të Komisionit, duke potencuar arsyetimin se koncepti i çmimit mesatar prej 58.500 lekësh/m² në vitin 2012, si vlera mesatare e shitblerjeve të banesave në tregun e lirë në Fier, është përcaktuar mbi parashikimet e udhëzimit nr. 3, datë 23.11.2011, të Këshillit të Ministrave, i cili ka dalë në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 34/1 të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane”, të cilat, sipas subjektit, janë objekte të destinuara për shtresat sociale në nevojë, që nuk mundën të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave apo atë të kredive hipotekore.

17.13 Lidhur me këtë pretendim të subjektit, në drejtim të analizimit të çmimit prej 58.500 lekësh/m², miratuar nga EKB-ja³⁹ për vitin 2012, trupi gjykues vlerëson se referimi i Komisionit të ky çmim, si një analizë përcaktuese, për të arritur në konkluzionin se çmimi i shitjes së apartamentit është tepër i lartë, nuk gjendet me peshë të veçantë. Rezulton se ligji nr. 9232/2004, i cituar më lart, në zbatim të të cilit EKB-ja përcakton çdo vit koston mesatare vjetore të ndërtimit të banesave, ka si qëllim sigurimin e strehimit për personat në nevojë, si pjesë e politikave sociale të qeverisë, që duhet të përballohen sidoqoftë me kosto të ulët, sipas parashikimit të nenit 33, pika 2 e këtij ligji. Në këtë kuptim, ndonëse këto çmime janë referuese dhe mund të sugjerojnë sidoqoftë përcaktimin e çmimeve dysHEME për apartamentet në tregun e lirë, nuk kanë të njëjtën peshë edhe për përcaktimin e vërtetësisë së çmimeve më të larta në raport me to. Në këtë kuptim, çmimi i EKB-së do të duhej t’i nënshtrohej një analize më të hollësishme për të arritur në konkluzionin që ka arritur Komisioni, në raport edhe me të dhënat e tjera që lidhen me situatën konkrete. Në këtë kontekst, trupi gjykues konstaton se në drejtim të vlerësimit të çmimit të shitjes së apartamentit në Fier, në analizën e Komisionit duket se nuk ka gjetur pasqyrim/reflektim çmimi i blerjes nga subjekti të apartamentit në vitin 2000, i cili nëse ndjekim/aplikojmë edhe në këtë rast treguesit e EKB-së për këtë vit⁴⁰, në mënyrë të dukshme rezulton se ka qenë më i lartë se çmimi prej 26.600 lekësh/m² që EKB⁴¹-ja përcakton, për sipërfaqe shfrytëzimi në Fier (çmim i cili, për sipërfaqe ndërtimi, reduktohet duke shkuar në vlerën 21.202 lekë/m²). Në këto kushte, meqenëse vërehet se jo vetëm shitja, por edhe blerja e apartamentit në Fier ka qenë me një çmim që tejkalon vlerat që EKB-ja referon si çmime mesatare të shitjes së apartamenteve në tregun e lirë në vitet respektive, trupi gjykues çmon se duket bindës argumenti që ka dhënë subjekti, se përcaktimi i vlerave të shitblerjeve në kontratat e analizuara më sipër, është ndikuar nga elemente të tjera të tregut, si: pozicioni i objektit, cilësia e ndërtimit etj., dhe se nuk mund të konkludohet se ka një rritje anormale të çmimit të shitjes.

17.14 Lidhur me konstatimin e Komisionit se *blerësi ka paguar për pajisjet dhe mobiliet e përdorura një vlerë të lartë, ndërkohë që apartamenti nuk banohet prej tij*, trupi gjykues vlerëson të sjellë në vëmendje disa elemente, si:

(i) vlera e shitjes së orendive gjendet e fiksuar në kontratën e premtim shitjes së apartamentit në Fier, të lidhur më datë 06.12.2012, pra larg ndikimit të procesit të rivlerësimit kalimtar;

³⁹ EKB-ja, me udhëzimin nr. 4, datë 23.12.2011, ka miratuar koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2012, tek i cili është përfshirë një tabelë me të dhëna për vlerat mesatare të shitblerjeve në tregun e lirë për vitin 2011, sipas qyteteve. Shih: https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2015/07/udhzim_2012.pdf.

⁴⁰ Çmimi i paguar nga subjekti në vitin 2000, për blerjen e këtij apartamenti, është në vlerën prej 3,9 milionë lekësh, e cila i korrespondon vlerës 32.370 lekë/m².

⁴¹ Të dhëna të marra nga faqja zyrtare e Entit Kombëtar të Banesave: <https://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit-viti-2000/>.

(ii) shumën 18.000 euro për shitjen e orendive/mobilimit të apartamentit, subjekti e ka deklaruar edhe në DVP-2012, dhe po ashtu e ka deklaruar edhe në deklaratën *vetting*;

(iii) në përgjigjet për pyetësin nr. 4 të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se mobilimi i apartamentit në Fier ka qenë bërë nga familja e saj ndërmjet viteve 2006 – 2010, me një kosto të përgjithshme prej 2.600.000 lekësh, të shpërndarë në këtë periudhë. Komisioni nuk e ka vlerësuar të besueshëm këtë shpjegim të subjektit, duke arsyetuar se në lidhje me vlerat e mobilimit të apartamentit, të shtrira/shpërndara në kohë, nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore, ka rezultuar se subjekti nuk i ka deklaruar këto shuma në seksionin “Ndryshimet e interesave private pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme”, edhe pse këto vlera janë në shuma të konsiderueshme, të cilat duhet të ishin deklaruar. Trupi gjykues e gjen këtë qëndrim të Komisionit të pambështetur në ligj e në të dhënat e rezultuara gjatë hetimit. Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), konstatohet se vetëm me ndryshimet që ky ligj ka pësuar me ligjin nr. 84/2012, në nenin 3, është shtuar pika “h”, e cila kërkon që subjektet deklaruese të deklarojnë *edhe çdo shpenzim të deklarueshëm me vlerë 500.000 lekë, të kryer gjatë vitit të deklarimit*. Për sa më sipër, në kushtet kur rezulton se Komisioni nuk ka kontestuar shpërndarjen e shpjeguar nga subjekti për realizimin e shpenzimeve të mobilimit përgjatë viteve 2006-2010, të cilat janë nën këtë vlerë, mosnjohja e kryerjes së këtyre shpenzimeve për mobilimin e apartamentit, mbi argumentin e mosdeklarimit të shpenzimeve në DVP-në respektive, nuk është një qëndrim i cili konfirmohet nga trupi gjykues dhe vlerësohet se nuk ka peshë në analizën që i bëhet vlerës së çmimit të shitjes së apartamentit, si një element mbi të cilin mbështetet konkluzioni për fiktivitetin e shitjes.

(iv) Gjithashtu, konstatohet se pavarësisht qëndrimit të Komisionit rreth pabesueshmërisë së kryerjes së shpenzimeve për mobilim, në analizën financiare të bërë pjesë të vendimit, është përfshirë si shpenzim edhe vlera prej 2.600.000 lekësh, e deklaruar prej subjektit se është përdorur për mobilim, shtrirë në vitet 2006-2010. Edhe në analizën që i bëhet vlerës së shitjes së orendive, trupi gjykues sjell në vëmendje të njëjtin argument, si për çmimin e shitjes së apartamentit, duke qenë se rezulton se orenditë janë deklaruar dhe pranuar nga Komisioni se janë blerë me një çmim të konsiderueshëm, i cili më pas është reflektuar edhe në shitjen e tyre, ndonëse në vlerë më të ulët se blerja. Përveç arsytimit të mësipërm, vlerësohet të silltet në vëmendje edhe fakti se vlera e shitjes së tyre është bërë pjesë integrale e kontratës noteriale të shitjes së apartamentit në vitin 2012, duke gjetur në këtë mënyrë pasqyrim në një dokument ligjor.

17.15 Një element tjetër i cili duket se mbështet kontratën e shitjes së apartamentit, është e dhëna që rezulton nga raporti i vlerësimit të pasurisë së kryer nga eksperti vlerësues Pandeli Gjeka, në tabelën fotografike të të cilit rezulton se pasqyrohet të ketë në objekt një tabelë, me shënimin “Shitet”, vendosur për të identifikuar nevojën/vullnetin për shitjen e pasurisë prej subjektit të rivlerësimit, e cila pasqyrohet se është kryer në shtator të vitit 2012⁴², pra pak kohë më parë se të hartohet kontrata e premtim shitjes e realizuar në dhjetor të këtij viti. Kjo e dhënë rastësore, e cila gjenerohet nga një burim i cili nuk ka synuar të provojë këtë fakt, por vlerën e apartamentit për efekt të procesit të legalizimit, demonstroi se subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, dhe familja e saj kishin synim dhe dëshirë të shisnin apartamentin në tregun e

⁴² Në pikën 4 të aktit të titulluar “Raport vlerësimi”, shprehet se vlerësimi është përpiluar në datën 22 shtator 2013, pas inspektimit që iu bë pronës në datën 22 shtator 2012.

lirë edhe për individë me të cilët nuk kishin asnjë lidhje familjare, element që provon vullnetin për të shitur pasurinë dhe jo për të ruajtur pronësinë e saj, siç do të duhej të ishte nëse dyshimet për kontratën fiktive do të ishin të sakta.

17.16 Një ndër argumentet e përdorura prej Komisionit për të mbështetur konkluzionin për fiktivitetin e shitjes së pasurisë apartament në Fier, ka qenë edhe verifikimi i pamundësisë financiare të blerësit të pasurisë, z. I. B., por edhe paprovueshmëria e faktit të deklaruar prej subjektit, se blerës real i pasurisë është A. B., konsideruar këto rrethana brenda kontekstit të një marrëdhënieje familjare mes bashkëshortit të subjektit dhe blerësit të pasurisë.

17.17 Trupi gjykues, në analizë të këtij shkak ankimi, vlerëson të sjellë në vëmendje, së pari, qëndrimin e mbajtur edhe në raste të tjera të jurisprudentës së tij, se pretendimi i subjektit lidhur me kufijtë e kontrollit të burimeve të ligjshme për blerësit e apartamentit, ndonëse nuk bie nën rregullin e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk është i bazuar. Komisioni, në rastin konkret, duket se ka kryer kontrollin e burimeve të shitësit për blerjen e pasurisë, jo për shkak të një marrëdhënieje që e bën blerësin e pasurisë person tjetër të lidhur, por në zbatim të nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, që i jep të drejtë Komisionit të hetojë çdo çështje që ai e sheh të nevojshme, aq më tepër në kuadër të hetimit për një pasuri të fshehur. Në këtë kuptim, Komisioni gjendet se ka qenë brenda kompetencës së tij për të kryer hetime në këtë drejtim.

17.18 Nga analizimi i të dhënave që rezultojnë nga aktet e paraqitura prej subjektit gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues arrin në të njëjtin konkluzion me Komisionin se blerësit nuk provojnë të kenë pasur të ardhura të ligjshme për të justifikuar blerjen e apartamentit, sipas standardit të së ardhurës së ligjshme, të parashikuar në nenin 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Pretendimet e subjektit se familja e z. I. B. ka pasur të ardhura të cilat po të arrinin të provoheshin, do të justifikonin shumën e përdorur për blerjen e saj, mbetën deklarative dhe të pambështetura në dokumentacionin ligjor që do të provonte qoftë krijimin e tyre, qoftë ligjshmërinë në raport me pagimin e detyrimeve tatimore. Për këto arsye, trupi gjykues i gjen të padrejta pretendimet e subjektit lidhur me këtë qëndrim të Komisionit.

17.19 Trupi gjykues ndan të njëjtin qëndrim me Komisionin edhe për sa i përket paprovueshmërisë së pretendimit të subjektit të rivlerësimit se blerësi real i kësaj pasurie, është në të vërtetë vëllai i blerësit formal, z. A. B.. Subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë këtë pretendim, duke qenë se të vetmet prova të sjella kanë qenë deklaratat noteriale të familjarëve të blerësve, të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit, të cilat kanë vlera të kufizuara provuese, aq më tepër karshi vlerës provuese të kontratës noteriale të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, e cila provon kalimin e pronësisë nga subjekti te z. I. B..

17.20 Pavarësisht faktit se këto qëndrime të Komisionit gjenden të drejta, trupi gjykues e vlerësoi këtë situatë në raport me konkluzionet e arritura për argumentet e tjera të përdorura nga Komisioni për të mbështetur qëndrimin se shitja e pasurisë dukej si fiktive, duke pasur në vëmendje edhe faktin se mungesa e burimeve në këtë rast, u adresohet personave të cilët janë jashtë rrethit të personave që kanë detyrim për deklarim e që figurojnë të jenë blerësit zyrtarë të pasurisë. Në këtë kontekst, trupi gjykues pati në konsideratë edhe faktin se çmimi i shitjes nuk ka shërbyer në mënyrë të drejtpërdrejtë për të financuar krijimin e ndonjë pasurie, pasi apartamenti i blerë në Tiranë është finalizuar/financuar gati një vit më parë nga shitja e apartamentit në Fier, për pasojë subjekti nuk mund të ketë përdorur drejtpërdrejt të ardhurat e

realizuara nga “shitja fiktive”, për blerjen e kësaj prone, ndryshe nga arsyetimi i Komisionit që pranon të kundërtën.

17.21 Përfundimisht, lidhur me shitjen prej subjektit të rivlerësimit të apartamentit 2+1 në lagjen “{***}” në Fier, bazuar në kontratën noteriale “Premtim shitje” me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 06.12.2012, në të cilën përcaktohet se çmimi i shitjes së kësaj pasurie si dhe i pajisjeve të saj, është në shumën 73.000 euro, trupi gjykues, duke përmbledhur konkluzionet e arritura më sipër në këtë arsyetim, vlerëson se:

17.22 Qëndrimi i Komisionit në vendim, se shitja e kësaj pasurie ka elemente që ngrenë dyshime të arsyeshme që pasuria apartament në Fier, mund të jetë pasuri e subjektit të rivlerësimit dhe se shitja te persona të afërt/familjarë është fiktive, për të justifikuar blerjen e një pasurie tjetër, nuk mbështetet në të dhëna që krijojnë bindjen për këtë konkluzion për shkaqet në vijim, por jo vetëm: **(i)** në kontratën noteriale premtim shitje, të lidhur në dhjetor 2012, palët kanë cilësuar vijimin e përdorimit nga subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, dhe familja e saj të apartamentit në Fier, deri në pagimin e plotë të çmimit të shitjes nga pala blerëse, e cila duket se e ka paguar atë plotësisht në janar vitit 2016⁴³; **(ii)** qëndrimi i Komisionit se çmimi i shitjes së kësaj pasurie është më i lartë se çmimi i referencës sipas Entit Kombëtar të Banesave për qytetin e Fierit në vitin 2012, duket se ka lënë jashtë analizës faktin se edhe çmimi i blerjes së këtij apartamenti në vitin 2000, në shumën 3,9 milionë lekë, ndjeshëm ka qenë më i lartë se çmimi i shitjes së banesave në tregun e lirë, referuar çmimeve të të njëjtit ent; **(iii)** Komisioni nuk ka konsideruar se vetëm me ndryshimet ligjore të bëra në ligjin nr. 9049/2003 me ligjin nr. 84/2012, subjektet deklaruese të pasurive, nga ky moment e më tej, kishin detyrimin për të deklaruar edhe çdo shpenzim të deklarueshëm me vlerë mbi 500.000 lekë, të kryer gjatë vitit të deklarimit, lidhur me mobilimin: **(iv)** shitja e kësaj pasurie duket se nuk i shërben ndonjë nevojë emergjente të subjektit për pasjen e likuiditeteve; **(v)** pagimi i faturave të energjisë elektrike, në shifra të vogla e jodomethënëse jo vetëm që duket se përfaqëson në shumicën e rasteve tarifën fikse për shërbimin e lidhjes me rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, por edhe justifikon mungesën e vëmendjes ndaj këtij veprimi të kryer automatikisht, për shkak të një marrëveshjeje me bankën përkatëse; **(vi)** mungesa e burimeve të blerësve të kësaj pasurie, mbetur si i vetmi argument i qenësishëm në analizën më sipër, vlerësohet e pamjaftueshme për të mbështetur konkluzionin e Komisionit për fiktivitetin e shitjes së kësaj pasurie.

17.23 Në këto kushte, trupi gjykues e vlerësoi si jopërcaktuese analizën financiare për verifikimin e mundësisë financiare të blerësve për pagimin e çmimit të këtij apartamenti. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues, për efekt të analizës financiare, përfshiu si të ardhur shumën 73.000 euro, të siguruar nga shitja e apartamentit në lagjen “{***}” në Fier.

- 18** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se konkluzioni i Komisionit që *subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e apartamentit me sip. 111 m² dhe garazhit me sip. 30 m² në Tiranë, me burim huanë prej 80.000 eurosh, marrë nga shtetasit A. C. dhe U. C., është një qëndrim i padrejtë, i paargumentuar dhe jo i bazuar në situatën faktike dhe në ligj, trupi gjykues analizon sa vijon.*

⁴³ Në DVP-2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen përfundimtare të banesës në lagjen “{***}”, në Fier, me anë të kontratës nr. {***} rep., e nr. {***} kol., të datës 21.01.2016, duke përfituar shumën 5.000 euro (diferenca e mbetur nga kontrata premtim shitje e vitit 2012).

18.1 Komisioni, lidhur me huanë si burim krijimi të pasurisë apartament, ndodhur në Tiranë, ka konkluduar se: *Duke qenë se nga hetimi i kryer, as huadhënësi A. C. dhe as U. C. si individ, nuk provuan burimet e ligjshme, për dhënien e kësaj shume, rezultoi në pamundësi financiare, si dhe asnjë nga këto veprime nuk u gjurmua me dokumentacion/historik bankar, apo prova të tjera të disponimit të të ardhurave për të cilat të ishin paguar tatimet, Komisioni arsyetoi se huadhënësi s'ka burime të ligjshme për dhënien e huasë, s'ka prova që kjo hua të jetë dhënë nga huadhënësi A. C., apo ndërmjetësi U. C.. Nisur nga fakti se subjekti nuk ka deklaruar kursime cash në DPV në vite, si dhe për faktin se si burim për blerjen e kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat nga shitja e apartamentit në Fier, për këto arsye, në analizën financiare të kryer nga Komisioni, nuk u analizuan të ardhurat e ligjshme të krijuara nga pagat e saj dhe të bashkëshortit. Për sa më sipër, nuk u provuan bindshëm të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezultoi të jetë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e apartamentit në Tiranë.*

18.2 Në funksion të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues u ndal në evidentimin e deklaramëve që subjekti i rivlerësimit ka bërë në deklaratën *vetting*, në DVP-të, si dhe në akte/dokumente të tjera lidhur me huanë në shumën 80.000 euro, të përdorur si burim financimi fillestar për blerjen e apartamentit dhe të garazhit në {***}, Tiranë, në vitin 2012, nga të cilat konstatoon se:

(i) Në deklaratën *vetting*, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar: *Deklaroj se për blerjen e banesës në {***}, Tiranë, në muajin janar fillimisht bashkëshorti ka marrë hua shumën prej 80.000 eurosh nga shtetasi A. C., i cili është i afërmi im (daja). Ky fakt është pasqyruar në kontratën noteriale përkatëse me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 17.01.2012. Pas shitjes së banesës që kam pasur në Fier në muajin dhjetor 2012, kjo shumë e marrë hua është shlyer totalisht, por në pamundësi për t'ia kthyer shtetasit A. C., i cili është rezident në USA, ia kam kthyer nipit të tij, shtetasit U. C., i cili është personi që në fakt edhe i ka administruar këto të holla para se të merreshin hua prej nesh. Për këtë fakt, në pamundësi për të marrë konfirmimin nga A. C., për shkak të vendndodhjes së tij, ju vë në dispozicion deklaratën noteriale të lëshuar nga shtetasi U. C. nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 23.01.2013. Aktualisht nuk mbartim asnjë detyrim.*

(ii) Në DVP-2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Shitur pasurinë 2+1 në Fier, në shumën 55.000 euro banesa + 18.000 euro orenditë shtëpiake, në total 73.000 euro, me kontratën premtim shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.12.2012, dhe blerë pasurinë apartament në Tiranë (2+1) në shumën 8.500.000 lekë, me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.03.2012”. Në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar se, duke qenë se shtëpia ekzistuese në Fier nuk ishte shitur ende, për blerjen e banesës në {***}, në muajin janar 2012, bashkëshorti ka marrë hua në shumën prej 80.000 eurosh, nga shtetasi A. C.⁴⁴, i cili është dhe i afërmi i saj (daja), me kontratën e huasë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.01.2012.

(iii) Sipas kontratës së huadhënies nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.1.2012, lidhur ndërmjet z. A. C. dhe z. M. S., për dhënien hua të shumës prej 80.000 eurosh, huadhënësi A. C. deklaroi se i ka dorëzuar huamarrësit M. S. shumën prej 80.000 eurosh, në datë 17.1.2012.

⁴⁴ Nga verifikimi në sistemin TIMS, ky shtetas, në datën e nënshkrimit të kontratës së huasë, ka rezultuar në Shqipëri.

Huamarrësi M. S. deklaroi se e ka marrë në dorëzim shumën 80.000 euro nga huadhënësi në datën 17.1.2012, me afat 10 vjet.

(iv) Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.1.2013 (dorëzuar nga subjekti së bashku me deklaratën vetting në ILDKPKI), deklaruesit M. S. dhe U. C. deklarojnë: *Unë deklaruesi M. S. deklaroj se me kontratë huadhënie, datë 17.1.2012, i kam marrë hua pa interes shtetasit A. C., një shumë të hollash prej 80.000 eurosh për blerjen e apartamentit me vendndodhje në Tiranë. Meqenëse unë në datën 6.12.2012, realizova me I. B. kontratën e premtimit të shitjes së pasurisë time në Fier, kundrejt çmimit 73.000 euro, duke u likuiduar nga blerësi për këtë shitje në vlerën prej 68.000 euro, në mënyrë të njëanshme dhe me pëlqimin e palës huadhënëse A. C., e revokoj kontratën e huasë duke i kthyer z. A. C. të gjithë shumën e marrë hua në masën prej 80.000 eurosh. Meqenëse jemi brenda rrethit familjar, pasi huadhënësi është daja i bashkëshortes sime Lindita Sinanaj, por dhe për faktin që huadhënësi nuk ndodhet në Shqipëri, unë dhe, me miratimin e tij, këtë hua ia dorëzoj nipit të tij U. C., i cili ka marrë miratimin e A. C. për të marrë në dorëzim këtë shumë. Deklaruesi U. C. deklaroi se: Ne cilësinë e të besuarit dhe nipit të A. C., marr në dorëzim cash në dorë nga M. S., shumën prej 80.000 eurosh (shlyerje huaje sipas kontratës së huasë datë 17.1.2012).*

(v) Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 7.2.2015, z. U. C. deklaroi se: *Shtetasi A. C. është xhaxhai im dhe është larguar nga Shqipëria në ShBA në vitin 1998. Po në këtë vit, para largimit të tij, kam marrë prej këtij shtetasi shumën prej 5.000.000 lekësh të reja, me përqindje 10% në vit. Kjo shumë është përdorur prej meje për aktivitetin tim privat. Në muajin janar 2012, shtetasi A. C. është kthyer përkohësisht në Shqipëri. Në këtë periudhë, prej meje i është kthyer shuma e marrë hua së bashku me kamatat, gjithsej në vlerën prej 80.000 eurosh. Kjo për faktin se këtë shumë ai ia ka dhënë hua për ta përdorur për nevoja të familjes së tij, shtetasit M. S., i cili është i afërmi ynë. Bashkëshortja e tij Lindita Sinanaj është vajza e motrës së Aliut dhe njëherësh dhe vajza e hallës sime. Këtë shumë, shtetasi M. S. ma ka kthyer mua sërish në muajin dhjetor 2012, në pamundësi për t'ia kthyer vetë shtetasit A. C., i cili jeton në ShBA. Kjo shumë sërish përdoret prej meje në ushtrimin e aktivitetit tim privat.*

18.3 Konstatohet se Komisioni, me rezultatet e hetimit administrativ për këtë hua, i ka kaluar barrë prove subjektit, duke i bërë të ditur gjetjet e tij, sipas të cilave:

- *Nuk është siguruar asnjë provë bindëse që tregon mundësinë financiare të A. ose U. C. për të financuar huanë.*
- *Nuk rezulton asnjë provë direkte apo indirekte për marrjen/dhënien e shumës së huasë.*
- *Subjekti rezulton në pamundësi financiare për blerjen e apartamentit në Tiranë në shumën 8.500.000 lekë.*
- *Subjekti rezulton në pamundësi financiare për shlyerjen e huasë së marrë A. apo U. C..*

18.4 Referuar përmbajtjes së vendimit objekt gjykimi, vërehet se konstatimet e rezultateve të hetimit administrativ kanë mbetur të pandryshuara edhe pas dhënies së shpjegimeve lidhur me to nga subjekti i rivlerësimit. Sipas vendimit, rezulton se Komisioni i ka konsideruar si z. A. C., ashtu edhe z. U. C. si persona të tjerë të lidhur me subjektin, për të cilët, në zbatim të përcaktimeve të nenit 32 pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer analizën ekonomike, ka konkluduar se asnjë prej tyre nuk ka pasur burime të ligjshme për të krijuar shumën 80.000 euro në janar të vitit 2012, e cila i është dhënë hua subjektit dhe ka shërbyer për pagesën e apartamentit në {***}, Tiranë.

18.5 Me ankimin⁴⁵, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që për shumën e marrë hua në vlerën 80.000 euro, analiza e kërkuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, të bëhet për z. U. C., pasi ndërmjet z. A. C. dhe z. U. C. ka pasur më herët, në vitin 1998, një marrëdhënie huaje të cilën palët, duke qenë se gëzonin mirëbesim ndërmjet tyre, i motivuar edhe për shkak të lidhjeve familjare, nuk e kanë formalizuar në një akt të shkruar, por kjo marrëdhënie ka gjetur pasqyrim në kontratën e huasë që ka lidhur bashkëshorti i subjektit⁴⁶. Nisur nga këto rrethana, subjekti në ankim pretendon se: *burimi i drejtpërdrejtë i shumës së marrë prej meje shtetasit A. C., në formën e huasë, është shtetasi U. C..*

18.6 Ndërsa me parashtrimet e paraqitura në Kolegji para seancës gjyqësore⁴⁷, subjekti i rivlerësimit pretendon se: *Por, pavarësisht kësaj marrëdhënieje, burimi i drejtpërdrejtë i shumës së marrë prej meje shtetasit A. C. në formën e huasë, është shtetasi U. C., i cili e administronte fizikisht shumën përkatëse. Në parashtrimet para seancës gjyqësore, të përcjella në Kolegji, subjekti gjithashtu ka pretenduar se: Kolegji i Posaçëm i Apelit duhet të vendosë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore pasi debati gjyqësor është i nevojshëm për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, lidhur me burimet e ligjshme të huadhënësit A. C., në kushtet kur Komisioni është kufizuar vetëm në verifikimin e burimeve financiare të huadhënësit A. C. deri në vitin 1998, duke mos kryer asnjë lloj verifikimi për periudhën 1998 - janar 2012, nuk ka marrë fare në vlerësim aktet e paraqitura prej meje, si dhe nuk ka kryer analizën financiare të huadhënësit A. C. për periudhën deri në janar të vitit 2012.*

18.7 Nisur nga sa evidentuar më sipër, si dhe nga qëndrimet që subjekti mban në ankim dhe në parashtrime, trupi gjykues evidenton se çështjet që shtrohen për zgjidhje janë:

- (i)** Duke konsideruar situatën e prezantuar më sipër, a do të konsiderohen si huadhënës në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, z. A. C. apo z. U. C.?
- (ii)** Në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit a ka mundur të provojë se huadhënësi ka provuar krijimin e shumës 80.000 euro me burime të ligjshme?

18.8 Trupi gjykues, në funksion të zgjidhjes së shkakut të mësipërm të ankimit, mori fillimisht në analizë përcaktimin e statusit të personit tjetër të lidhur në raport me dy shtetasit e deklaruar prej subjektit si huadhënës, për shkak të marrjes së huasë prej 80.000 eurosh, që ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë në Tiranë. Nga të dhënat që kanë rezultuar nga hetimi administrativ në Komision, rezultojnë disa fakte që, në vlerësimin e trupit gjykues, përcaktojnë se këtë cilësi, në kuadër të kontrollit të huasë, në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, e ka z. A. C., të tilla si vijnë: **(i)** deklaratimet e subjektit në deklaratën *vetting* përcaktojnë se huaja në vlerën prej 80.000 eurosh është marrë prej dajës së saj, z. A. C.. Të njëjtin fakt ajo ka deklaruar edhe në DPV-në e vitit 2012, duke përcaktuar se shuma është marrë hua prej bashkëshortit nga daja i saj; **(ii)** në deklaratën *vetting* është përcaktuar se kthimi i huasë i është

⁴⁵ Në ankim, paragrafi 146, subjekti shpreh se: “Por pavarësisht kësaj marrëdhënieje, burim i drejtpërdrejtë i shumës së marrë prej meje shtetasit A. C., në formën e huasë, është shtetasi U. C.”.

Në ankim, në paragrafin 156, subjekti i rivlerësimit shpreh se: “Pavarësisht sa më sipër, lidhur me gjendjen financiare të huadhënësit A. C., shpjegoj edhe një herë se nuk disponoj akte që provojnë të ardhurat e tij para vitit 1998, dhe jam në pamundësi për të siguruar këtë dokumentacion, për shkak të faktit se A. jeton familjarisht prej vitit 1998 në ShBA, por edhe për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar”.

⁴⁶ Në kontratën e huasë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.01.2012, për shumën 80.000 euro, të lidhur midis bashkëshortit të subjektit (huamarrësi) dhe shtetasit A. C. (huadhënësi), është evidentuar në mënyrë të shprehur deklarimi i huadhënësit se: “Këtë shumë ai ua kishte dhënë në huapërdorje njerëzve të afërt të familjes së tij përpara disa vjetësh dhe kjo shumë i është kthyer në këtë periudhë”.

⁴⁷ Në paragrafin 6, faqe 50 e parashtrimeve.

bërë z. U. C., jo me cilësinë e huadhënësit, por të personit të besuar të huadhënësit, z. A. C., për shkak të pamundësisë së tij për të qenë prezent në Shqipëri në kohën e kthimit të huasë, duke qenë se jetonte në ShBA; (iii) z. A. C., në kontratën e huadhënies së shumës 80.000 euro, në janar 2012 ka deklaruar ndër të tjera se: *jep hua shumë 80.000 euro, shumë të cilën e ka në pronësi të tij, shumë të cilën ai deklaron që ua kishte dhënë në huapërdorje njerëzve të afërm të familjes së tij përpara disa vitesh dhe kjo shumë i është kthyer në këtë periudhë*; (iv) në deklaratën noteriale⁴⁸ nr. {***}, datë 7.2.2015, të nënshkruar prej z. U. C., dorëzuar në ILDKPKI prej vetë subjektit, deklarohet prej tij se kthimi i huasë nga bashkëshorti i subjektit në fund të vitit 2012 dhe marrja në dorëzim prej tij e kësaj shume, ka ndodhur për shkak të pamundësisë së z. A. C. për të qenë vetë prezent në Shqipëri, duke qenë se ndodhej në ShBA, deklaram i cili potencon faktin se huaja ishte marrë nga z. A. dhe se ai gëzonte të drejtat e pronësisë mbi të hollat e kthyer mbrapsht po në emër dhe për llogari të tij; (v) deklaratimet e subjektit gjatë hetimit administrativ, sipas të cilave: shuma prej 80.000 eurosh është marrë dhe i është kthyer në cash U. C.; si edhe deklaratimet e këtij të fundit në deklaratën noteriale me nr. {***}, datë 23.03.2021, të përpiluar në funksion të procesit të rivlerësimit, me të cilën ai deklaron se në cilësinë e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK dhe aksionerit në masën 80%, ka tërhequr shumë nga arka e kësaj shoqërie që administrohej prej tij, dhe menjëherë pas kthimit nga ana e subjektit, ajo është arkëtuar prej tij sërish në gjendjen e arkës së shoqërisë, përveç se nuk gjejnë mbështetje në akte të kohës, por edhe bien në kontradiksion me sa është deklaruar që në fazë të hershme, të paktën që në vitin 2012, se kjo shumë i përkiste z. A. C. dhe ai ka qenë huadhënësi i saj të bashkëshorti i subjektit, duke e bërë këtë version të fakteve të mbetet në nivel deklarativ e, për pasojë, i pabesueshëm.

18.9 Nga sa më sipër përshkruar, trupi gjykues vlerëson se edhe në versionin që z. U. C. ka administruar fizikisht paratë e dhëna hua sipas deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, ai nuk është cilësuar prej saj si huadhënës dhe nuk mund të shërbejë kjo rrethanë për të cilësuar atë si të tillë. Sipas nenit 1050 të Kodit Civil⁴⁹, me anë të kontratës së huasë, realizohet kalimi i pronësisë së një sendi të përcaktuar në gjini, në këtë rast vlerat monetare, nga huadhënësi të huamarrësi, për një periudhë të caktuar. Ky përcaktim i kontratës sipas Kodit Civil, përcakton njëkohësisht faktin juridik se sendet e dhëna hua janë në pronësi të huadhënësit dhe jo të ndonjë personi tjetër. Në këtë kuptim, përderisa subjekti ka cilësuar si huadhënës z. A. C., dhe me të është lidhur edhe kontrata e huasë në vitin 2012, ai prezumohet

⁴⁸ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.02.2015, lëshuar nga U. C., në të cilën deklaron se: “Shtetasi A. C. është xhaxhai im dhe ai është larguar nga Shqipëria në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitin 1998. Po në këtë vit, para largimit të tij, unë kam marrë prej këtij shtetasi shumë prej 5.000.000 lekësh, me përqindje 10% në vit. Kjo shumë është përdorur prej meje për qëllime të ushtrimit të aktivitetit tim privat në fushën e nxjerrjes së mineralit të kromit, aktivitet për të cilin jam licencuar që në vitin 1999 e në vazhdim, dhe janë përdorur prej meje në fillimin e këtij aktiviteti. Shuma e marrë përfaqëson kursimet familjare të shtetasit A. C.. Dua të theksoj se për shkak të lidhjes së afërt familjare me këtë shtetas, ne nuk kemi përpiluar akt shkresor për këtë shumë.

Në muajin janar të vitit 2012, shtetasi A. C. është kthyer përkohësisht në Shqipëri për të vizituar të afërmit e tij. Në këtë periudhë, prej meje i është kthyer shuma e marrë së bashku me kamatat, në shumë gjithsej 80.000 euro, kjo për faktin se këtë shumë ai ia ka dhënë hua për ta përdorur për nevoja të familjes së tij, shtetasit M. S., i cili është gjithashtu i afërm i yni (bashkëshortja e tij Lindita Sinanaj është vajza e motrës së A. dhe njëherësh dhe vajza e hallës sime). Këtë shumë, shtetasi M. S. ma ka kthyer mua sërish në muajin dhjetor të vitit 2012, për t’ia kthyer vetë shtetasit A. C., i cili jeton në ShBA. Kjo shumë sërish është përdorur prej meje në ushtrimin e aktivitetit tim privat”.

⁴⁹ Me kontratën e huasë, njëra palë (huadhënësi) i jep në pronësi palës tjetër (huamarrësit) një shumë të hollash ose sende që përcaktohen në numër, me peshë ose me masë dhe huamarrësi detyrohet t’i kthejë huadhënësit atë që holla, ose atë që sende të atij lloji dhe të asaj cilësie, brenda afatit të caktuar në kontratë ose, kur nuk është caktuar afat, me kërkesën e huadhënësit.

të jetë pronari i parave të dhëna hua, pavarësisht faktit se fizikisht ato mund të gjendeshin në duart e dikujt tjetër, në këtë rast z. U. C.. Me fjalë të tjera, të drejtën për disponimin e tyre e kishte vetëm z. A. dhe pikërisht këtë të drejtë ai ka ushtruar, për pasojë, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai dhe subjekti kanë detyrimin të provojnë burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj shume, pavarësisht ngjarjeve të tjera me natyrë faktike apo ligjore që kanë ndodhur pasi kjo marrëdhënie është krijuar. Në kuptim të procesit të rivlerësimit kalimtar, momenti i krijimit të marrëdhënies është ai që përcakton si rrethin e personave që duhet t'i nënshtrohen kontrollit, ashtu edhe kufijtë e tij. Në këto kushte, trupi gjykues arriti në përfundimin se detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të shumës prej 80.000 eurosh, të dhënë hua në vitin 2012, e ka subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur, daja e saj, z. A. C..

18.10 Në vijim të këtij konkluzioni, trupi gjykues kontrolloi konkluzionin e Komisionit për sa i përket verifikimit të burimeve të personit tjetër të lidhur për krijimin e kësaj shume.

18.11 Lidhur me mundësinë e huadhënësit, z. A. C., për të krijuar me të ardhura të ligjshme shumën prej 80.000 eurosh, të dhënë hua subjektit në janar të vitit 2012, konstatohet fillimisht se gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe në ankim, subjekti i rivlerësimit ka theksuar dhe evidentuar faktin se kjo shumë përbëhet prej shumës 5.000.000 lekë, krijuar prej tij deri në vitin 1998. Sipas këtyre deklarimeve, në vitin 1998 ajo iu dha hua nga z. A. C., nipit të tij U. C., për qëllime të ushtrimit të aktivitetit privat në fushën e nxjerrjes së mineralit të kromit, me përqindje interesi 10% në vit. Këtë marrëdhënie duket se e konfirmon edhe z. U. C. në deklaratimet e bëra në deklaratën noteriale me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 07.02.2015, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, si dokumentacion mbështetës i deklaratës *vetting* të plotësuar prej saj dhe prej personave të lidhur. Mbi bazën e këtij shpjegimi dhe qëndrimit të mbajtur nga subjekti si në ILDKPKI, ashtu edhe gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka kryer analizën financiare të huadhënësit A. C. dhe ka konkluduar se ai nuk kishte të ardhura të ligjshme për të krijuar deri në fund të vitit 1998 shumën prej 5.000.000 lekësh, të dhënë hua fillimisht z. U. C., situatë e cila, për rrjedhojë, pamundëson krijimin me burime të ligjshme të shumës 80.000 euro (që përfshin edhe interesat) në janar të vitit 2012, të cilën subjekti e ka marrë hua me qëllim blerjen e apartamentit dhe garazhit në {***}, Tiranë.

18.12 Për të kundërshtuar këtë konkluzion të Komisionit, ndryshe nga qëndrimi i mbajtur gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe në ankim, subjekti me parashtrimet e depozituara para seancës gjyqësore, në zbatim të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, pretendon që analiza financiare e huadhënësit A. C., në terma kohorë të kryhet deri në janar të vitit 2012, që është pikërisht momenti kur kjo shumë i është dhënë hua bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, evidenton me parashtrimet para seancës gjyqësore, se në Komision ka paraqitur të dhëna që provojnë të ardhurat në ShBA të huadhënësit A. C. dhe të bashkëshortes së tij, të cilat ajo pretendon se nuk janë vlerësuar nga Komisioni. Gjithashtu, po me parashtrimet, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkëlidhur tyre edhe akte që provojnë edhe të ardhura të tjera që kanë pasur në Shqipëri z. A. C. dhe bashkëshortja e tij, që kanë derivuar nga të ardhurat nga pagat (të evidentuara në praktikat e pensioneve të pleqërisë), si dhe nga shitja e një pasurie për vlerën prej 2.598.446 lekësh, për të cilën ka paraqitur një kontratë shitblerje apartamenti me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.01.2012.

18.13 Trupi gjykues konstaton fillimisht se ky pretendim i subjektit shfaqet rishtas në parashtrime dhe nuk përputhet me shpjegimet që subjekti ka dhënë gjatë hetimit dhe në ankim, se huadhënësi, paratë që kanë shërbyer për krijimin e shumës prej 5.000.000 lekësh, i ka krijuar deri në vitin 1998, kohë në të cilën ai është larguar nga Shqipëria për në ShBA. Pavarësisht këtij fakti, trupi gjykues e mori në analizë atë në raport me të dhënat që kanë rezultuar nga hetimi, e që janë përshkruar më lart. Sipas këtyre të dhënave, deklarimeve të subjektit, por edhe të z. U. C., paratë e dhëna hua janë krijuar prej z. A. C. deri në vitin 1998, në vlerën prej 5.000.000 lekësh, janë dhënë në përdorim të z. U. C. dhe janë kthyer së bashku me interesat në vitin 2012, në vlerën prej 80.000 eurosh dhe i janë dhënë hua subjektit prej huadhënësit, z. A. C.. Sipas këtij versioni, të ngritur e pretenduar prej vetë subjektit, analiza financiare për krijimin e shumës me të drejtë ka ndjekur kohën e krijimit të tyre, sipas një analize logjike e cila nuk mund të lejojë verifikimin e burimeve deri në vitin 2012, përderisa historia e krijimit të tyre ka pasur një rrugë të ndryshme. Në njëjtën logjikë u konsiderua edhe pretendimi i ri se si burim kanë shërbyer edhe disa të ardhura të krijuara nga shitja e një pasurie të paluajtshme, e cila për më tepër daton pas datës së marrjes së huasë.

18.14 Për sa më sipër, trupi gjykues, në kryerjen e analizës financiare të huadhënësit, konsideroi shpjegimet e dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ në Komision, të cilat duken se përputhen edhe me deklaratimet e dhëna në deklaratën noteriale të shtetasit U. C., me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 7.2.2015, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI, në të cilën deklarohet se: *Shtetasi A. C. është larguar nga Shqipëria në ShBA në vitin 1998. Po në këtë vit, para largimit të tij, kam marrë prej këtij shtetasi shumën prej 5.000.000 lekësh të reja me përqindje 10% në vit. Kjo shumë është përdorur prej meje për aktivitetin tim privat. Në muajin janar 2012, shtetasi A. C. është kthyer përkohësisht në Shqipëri. Në këtë periudhë, prej meje i është kthyer shuma e marrë hua së bashku me kamatat, gjithsej në vlerën prej 80.000 eurosh.* Nisur nga këto të dhëna, trupi gjykues e vlerësoi të drejtë shtrirjen e analizës financiare për huadhënësin A. C. deri në vitin 1998, duke mos përfshirë në këtë analizë të ardhurat e krijuara prej tij në emigracion pas këtij viti, si të papërcaktuara prej vetë subjektit se kanë shërbyer për krijimin e kësaj shume.

18.15 Trupi gjykues mori në analizë burimet e pretenduara prej subjektit se kanë shërbyer për krijimin e shumës së dhënë hua, prej personit tjetër të lidhur A. C.. Subjekti ka shpjeguar që z. A. C. ka pasur një marrëdhënie huaje me nipin e tij U. C. që prej vitit 1998, kur ky i fundit ka themeluar shoqërinë e tij “{***}” ShPK. Kjo marrëdhënie, për shkak të lidhjes familjare, nuk është materializuar me ndonjë akt të shkruar, por ka funksionuar në kushte mirëbesimi. Z. A. C. që prej vitit 1998 jeton në ShBA, dhe subjekti ka deklaruar në ankim se nuk disponon akte që provojnë të ardhurat e z. A. C. para vitit 1998, pasi është në pamundësi për të siguruar dokumentacion për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar dhe mosruajtjes së akteve që mund të provojnë sigurimin e tyre. Dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti në Komision, që u referohet formularëve W2 (formularët e përvitshëm të plotësuar sipas kërkesave të shtetit amerikan) për deklarimin e të ardhurave dhe pagimin e detyrimeve tatimore, të cilët japin informacion mbi të ardhurat e siguruara prej z. A. C. dhe bashkëshortes së tij në vitet 1998-2012, në shumën mbi 1.000.000 USD, siç u arsyetua më lart, janë krijuar pas largimit nga Shqipëria dhe nuk mund të përdoren për të justifikuar burimin e ligjshëm të shumës së dhënë hua nipit të tij U. C. që në vitin 1998, para largimit në emigracion. Mbështetur në sa analizuar dhe konkluduar më sipër lidhur me segmentin kohor të kryerjes së analizës financiare për huadhënësin A. C., bazuar në të dhënat e disponuara në fashikullin e hetimit administrativ, rezulton se subjekti rivlerësimi

nuk ka arritur të dorëzojë asnjë dokumentacion apo provë mbi burimin dhe të ardhurat e ligjshme të përfituara përpara vitit 1998 dhe, në këto kushte, nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të shumës prej 5.000.000 lekësh të dhënë z. U. C., nga personi tjetër i lidhur në vitin 1998.

18.16 Në vijim, trupi gjykues u ndal në analizimin e pretendimit për gjenerim të interesave mbi shumën e dhënë hua nga z. A. C. te z. U. C., që evidenton: *Së pari*, se përfitimi i interesave nga z. A. C., për shkak të huadhënies, është një e dhënë që mbështet qëndrimin se shuma 5.000.000 lekë është krijuar nga z. A. C. deri në vitin 1998. *Së dyti*, trupi gjykues konstaton se në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, referuar interesave dhe kamatave të përfituara nga huadhënia nga z. A. C. te z. U. C. (prej përafërsisht 30.000 eurosh), nga subjekti nuk është paraqitur asnjë dokumentacion justifikues/provues për të vërtetuar shlyerjen e detyrimeve tatimore, lidhur me këto të ardhura. Në fashikullin e hetimit administrativ, nuk disponohet asnjë provë që këto detyrime të jenë shlyer nga z. A. C., duke aplikuar tatim mbi të ardhurat personale, dhe as nga z. U. C. në cilësinë e huamarrësit, si “individ” apo si “shoqëri”, për të cilat të jetë aplikuar tatimi i mbajtur në burim. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se dhe pjesa e gjeneruar nga interesat/kamatat për përdorimin e shumës për periudhën 1998-2012 (rreth 14 vite), edhe në versionin se do të provohej burimi i ligjshëm i krijimit të shumës prej 5.000.000 lekësh, sërish nuk mund të konsiderohej si një e ardhur e ligjshme në kuptim të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

18.17 Për sa më sipër, trupi gjykues, ashtu si edhe Komisioni, konkludon se, në kuptim të përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/20016, subjekti i rivlerësimit nuk mundi të provojë mundësinë e huadhënësit A. C. për të krijuar me të ardhura të ligjshme shumën 80.000 euro, të dhënë hua subjektit të rivlerësimit.

18.18 Pavarësisht qëndrimit të mbajtur se statusin e personit tjetër të lidhur, me shumën prej 80.000 eurosh, e ka z. A. C., trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të parashtruara në ankim, edhe lidhur me konkluzionet e Komisionit për mundësinë e z. U. C., për krijimin e shumës prej 80.000 eurosh, sipas versionit se ai ka qenë personi që e ka dhënë huanë fizikisht. Subjekti, në këtë version ka pretenduar se z. U. C. ka qenë administrator i shoqërisë “{***}” ShPK dhe shumën e ka siguruar duke tërhequr likuiditet nga arka e saj. Ashtu siç i ka rezultuar edhe Komisionit, kjo shoqëri ka pasur mundësi financiare për dhënien e kësaj shume, pasi pasqyrat financiare të vitit 2012, të depozituara në QKB, shfaqin një situatë të shëndoshë financiare, në të cilën evidentohen mjete monetare të disponueshme⁵⁰. Sipas subjektit, z. U. C. ka disponuar 80% të kuotave të shoqërisë, dhe kjo tregon për pozitën dominuese në të, për rrjedhojë të së cilës z. U. C. ka vepruar në mënyrë të pavarur dhe pa nevojën e një autorizimi të veçantë nga aksioneri tjetër i shoqërisë, për kryerjen e transaksioneve si nga arka, ashtu edhe nga llogaritë bankare⁵¹ të disponuara në emër të saj. Sipas subjektit, meqenëse shuma e marrë hua në fillim të vitit 2012 i është kthyer shtetasit U. C. brenda vitit 2012 (me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në Fier), në pasqyrat

⁵⁰ Sipas pasqyrave financiare të vitit 2012, shoqëria “{***}” ShPK ka disponuar në fillim të vitit 2012, mjete monetare prej 69.543.930 lekësh, ndërsa më datë 31.12.2012, në shumën 64.883.133 lekë. Ndërsa gjendja monetare në llogaritë bankare të shoqërisë ka qenë 14.889.020 lekë më datë 01.01.2012 dhe në shumën 54.654.909 lekë, në datën 31.12.2012.

⁵¹ Nga statement-et e dorëzuara në Komision të llogarive të shoqërisë “{***}” ShPK rezulton se shtetasi U. C. ka kryer vetë tërheqje dhe derdhje në llogaritë e shoqërisë pa ndonjë autorizim të veçantë apo pa kundërfirmë të financierit apo të aksionerit tjetër të shoqërisë.

financiare të shoqërisë nuk figuron ndonjë shënim i veçantë në lidhje me këtë huadhënie dhe, anasjelltas, për shlyerjen e saj.

18.19 Komisioni, për z. U. C., ka arsyetuar se ai ka personalitet juridik të ndryshëm nga shoqëria tregtare që përfaqëson, si dhe rezulton se nga aktet e disponuara në fashikullin e hetimit administrativ, nuk figuron të këtë ndonjë transaksion apo dokument që të faktojë lëvizjen e shumës së dhënë hua me burim arkën e shoqërisë apo nga llogaritë bankare të saj, pavarësisht nga disponueshmëria e shumave në llogaritë e shoqërisë. Sipas Komisionit, shpjegimi i dhënë nga z. U. C., për mosregjistrim të kësaj huaje pasi ajo është shlyer brenda vitit, nuk mbështet nga kontrata e huasë, e cila ka të përcaktuar si afat fundor për shlyerjen e detyrimit periudhën 10-vjeçare. Gjithashtu, z. U. C. nuk ka pasur tagra të vepronte me arkën e shoqërisë si të ishin të ardhura personale. Ndërkohë shoqëria një vit (2011) përpara dhënies së huasë nuk kishte shpërndarë dividend, i cili mund të ishte në përdorim personal të ortakëve. Sipas këtij arsyetimi, nuk provohet që huadhënësi, z. U. C., si individ, të këtë disponuar këto shuma. Pretendimi i subjektit që z. U. C. të këtë tërhequr nga arka e shoqërisë shumën 80.000 euro dhe t'ia këtë dhënë subjektit nuk duket bindës dhe i provuar prej tij, pasi nuk ka asnjë gjurmë të tij në librat e shoqërisë apo transaksion të faktuar. Shpjegimet e dhëna nga subjekti nuk duken bindëse edhe për shkak se të gjitha transaksionet (marrja dhe dhënia) deklarohen që janë kryer në *cash*, pa pasur asnjë provë direkte apo indirekte të pagesave të ndërsjella. Në përfundim, Komisioni ka konkluduar se z. U. C., si individ, rezulton në pamundësi financiare për të provuar burimet e ligjshme të shumës së dhënë hua.

18.20 Trupi gjykues kontrollon vendimin e Komisionit lidhur me këtë version të pretenduar prej subjektit, **(i)** duke analizuar situatën financiare të shoqërisë “{***}” ShPK, për të shlyer deri në vitin 2012 huanë, interesat dhe kamatat e përlllogaritura për shumën e marrë hua prej 5.000.000 lekësh në vitin 1998, ose **(ii)** duke analizuar të ardhurat e ligjshme të shtetasit U. C. si individ për të shlyer huanë, interesat dhe kamatat e përlllogaritura për shumën e marrë hua, prej 5.000.000 lekësh, në vitin 1998.

18.21 Në drejtim të verifikimit të situatës financiare të shoqërisë “{***}” ShPK për të shlyer huanë, interesat dhe kamatat e përlllogaritura për shumën e marrë hua prej 5.000.000 lekësh në vitin 1998, në konsideratë të dokumentacionit ligjor⁵², referuar shoqërisë, depozituar në Komision nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se: **(i)** në të dhënat e pasqyrës financiare të vitit 2012 (e cila pasqyron informacion edhe për vitin paraardhës 2011), rezulton se në të, nuk ka gjurmë të regjistrimit të huasë prej 5.000.000 lekësh, të marrë prej z. A. C., dhe gjithashtu nuk ka gjurmë të shlyerjes së këtij detyrimi në vitin 2011 apo vitin 2012. Pasqyrat financiare të viteve 2011-2012 gjithashtu nuk pasqyrojnë në postet e bilancit as shlyerjen e interesave të gjeneruara ndër vite dhe as shlyerjen e detyrimeve tatimore të lidhura me to; **(ii)** pavarësisht se pasqyra financiare (bilanci kontabël) e shoqërisë “{***}” ShPK, më datë 31.12.2011, pasqyron mjete monetare të disponueshme në një shumë totale prej 69.543.930 lekësh (të përbëra nga 14.889.020 lekë likuiditete në bankë dhe 54.654.909 lekë gjendje arke), ato nuk pasqyrojnë veprime apo gjurmë të lëvizjeve apo pagesë (me përshkrim) për shlyerjen e detyrimit të huasë që korrespondon me shumën 80.000 euro. Subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ nuk ka paraqitur asnjë transaksion, bankar apo nga arka e shoqërisë, që të vërtetojë se kjo shumë është tërhequr nga kjo shoqëri. Nëse shuma prej 80.000 eurosh do të ishte tërhequr nga arka e shoqërisë, siç pretendon subjekti i rivlerësimit, ajo do të duhet të ishte

⁵² Pasqyrë financiare e vitit 2012.

shoqëruar minimalisht me një mandat pagese dhe me një regjistrim të këtij veprimi në librat kontabël të shoqërisë (libri i arkës), të cilët në kohën kur subjektit i ka kaluar barra e provës, ishin ende brenda afatit 10-vjeçar të ruajtjes së tyre, sipas rregullave të kontabilitetit; (iii) verifikimi i lëvizjeve të llogarive bankare të shoqërisë, ndonëse rezulton se nga ortaku maxhoritar, z. U. C., përgjatë vitit 2011 janë kryer tërheqje të likuiditeteve nga bankat⁵³, nga të cilat rezulton se U. C. në periudhën 01.10.2011 - 31.12.2011, ka kryer tërheqje në *cash* nga llogaritë bankare të shoqërisë “{***}” ShPK, në shumën totale prej 40.000 USD dhe 41.500 eurosh, në fashikullin e hetimit administrativ nuk ka të dhëna që tregojnë se për çfarë janë përdorur shumat e tërhequra në *cash*, të cilat logjikshëm duket se kanë shërbyer për pagesa për veprimtarinë tregtare të saj, pasi nëse do të ishin përdorur për shlyerjen e borxhit që shoqëria mund të kishte ndaj z. A. C., ato duhet të ishin reflektuar në dokumentet kontabël; (iv) kontrata e huasë ishte me afat 10-vjeçar dhe në momentin e dhënies së saj, z. U. C. nuk kishte pritshmëri që ajo të kthehej dhe të mbyllej si transaksion brenda vitit, prandaj ajo duhej të ishte dokumentuar në dokumentacionin kontabël të shoqërisë.

18.22 Nga sa më sipër, nga aktet në fashikullin e hetimit administrativ, nuk provohet/gjendet ndonjë transaksion apo dokument i dedikuar që të faktojë lëvizjen e shumës së dhënë hua, me burim arkën e shoqërisë apo nga llogaritë bankare të saj, pavarësisht nga disponueshmëria e shumave në llogaritë e shoqërisë. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se mbetet i paprovuar pretendimi i subjektit që shuma prej 80.000 eurosh e ka burimin nga likuiditeti i disponuar nga aktiviteti i shoqërisë “{***}” ShPK në fillim të vitit 2012.

18.23 Trupi gjykues shqyrtoi pretendimin e subjektit edhe në drejtim të kontrollit të mundësive të z. U. C. si individ, për shkak të një personaliteti juridik të ndryshëm nga shoqëria tregtare që ai përfaqëson, për të disponuar shumën prej 80.000 eurosh në vitin 2012, me burim nga huaja e vitit 1998 me xhaxhain e tij, z. A. C..

18.24 Në drejtim të kontrollit të të ardhurave të z. U. C. si individ, konstatohet se nga pasqyra financiare e vitit 2011, nuk rezultojnë shpërndarje të dividendit nga veprimtaria e shoqërisë “{***}” ShPK, i cili mund të ishte në përdorim personal të tij si ortak i shoqërisë. Gjithashtu, nga të dhënat e disponuara në fashikull, nuk rezultojnë burime apo të ardhura të tjera të ligjshme në favor të shtetasit U. C., për t’u konsideruar se kanë shërbyer për krijimin e shumës 80.000 euro, të kthyer fillimisht z. A. C. e të dhënë më pas subjektit të rivlerësimit për blerjen e apartamentit. Në këto kushte, edhe në këtë version të analizës, trupi gjykues konstaton se z. U. C., as si individ, nuk provohet të ketë disponuar këto shuma të cilat pretendon se ia ka kaluar subjektit. Për sa më sipër, trupi gjykues konkludon se me të drejtë Komisioni ka vlerësuar se z. U. C. edhe si individ rezulton në pamundësi financiare për të provuar burimet e ligjshme të shumës së dhënë hua, në vlerën 80.000 euro.

18.25 Në përfundim të analizimit të këtij shkak ankimi, bazuar në sa analizuar më sipër, në kushtet kur për blerjen e apartamentit dhe garazhit në {***}, Tiranë, sipas përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, huaja në shumën 80.000 euro, e deklaruar si burim i

⁵³ Nga tërësia e këtyre veprimeve/tërheqje bankare, evidentohen lëvizjet e 4 muajve të fundit të vitit 2011, në Credins Bank, të cilat kanë të dhënat:

- llogaria në USD: datë 10.10.2011, tërhequr shuma 40.000 USD;
- llogaria në euro: datë 10.10.2011, tërhequr shuma 30.000 euro; datë 17.10.2011, tërhequr shuma 6.500 euro; datë 03.11.2011, tërhequr shuma 5.000 euro.

financimit të këtyre pasurive, rezultoi e paprovuar si e krijuar me burime të ligjshme, u gjend i drejtë qëndrimi i mbajtur nga Komisioni në vendim, se subjekti i rivlerësimit për këto pasuri gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 19 Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit me anë të të cilit kundërshton *konkluzionin e Komisionit për blerjen e automjetit, tip “Volkswagen Golf”, me targë {***}, vit prodhimi 2014, si të gabuar, të pabazuar në të dhënat e provave të administruara, si dhe në referencë të rrethanave të prezantuara, tërësisht joobjektiv.*

19.1 Në vendimin e Komisionit, për këtë pasuri, është arsyetuar se duke qenë se si burim për blerjen e automjetit, subjekti ka deklaruar se është përdorur shuma 5.000 euro, e kështu të fundit të paguar nga blerësi i apartamentit në Fier, në vitin 2016, z. I. B., shitje e cila është konsideruar prej Komisionit si fiktive, ajo (subjekti) nuk arriti të provonte burimin e ligjshëm, që ka shërbyer për blerjen e automjetit. Gjithashtu, Komisioni lidhur me këtë pasuri, ka konkluduar se duke qenë se subjekti nuk arriti të provonte aksidentin e pësuar me automjetin nga shitësja e tij, çmimi i blerjes së automjetit nuk paraqet vlerën reale të tij.

19.2 Në ankim, në parashtrime, ashtu si dhe përgjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit pretendon se: (i) për blerjen e automjetit, janë përdorur të ardhurat/kësti i fundit i paguar nga blerësi i apartamentit në Fier, z. I. B., veprim i cili është deklaruar në deklaratën *vetting* dhe në DVP-në e vitit 2017. PAGESA E KËSAJ SHUME, SIPAS SUBJEKTI, PROVOHET NËPËRMJET KONTRATËS SË SHITBLERJES SË APARTAMENTIT 2+1 NË FIER, ME NR. {***} REP., NR. {***} KOL., DATË 21.01.2016, NË TË CILËN KONFIRMOHET SHLYERJA E GJITHË VLERËS SË RËNË DAKORD NË KONTRATËN PARAPRAKË TË SHITJES, VEPRIM I CILI PO ASHTU PASQYRIM EDHE NË DEKLARATËN NOTERIALE NR. {***} REP., NR. {***} KOL., DATË 17.1.2014⁵⁴, ME ANË TË SË CILËS ËSHTË RËNË DAKORD SHTYRJA E AFATIT TË PAGESËS SE APARTAMENTIT; (ii) lidhur me çmimin e shitjes së automjetit në vlerë 5.000 euro, subjekti në ankim, si dhe gjatë hetimit në Komision, shpjegon se çmimi i shitjes së automjetit prej 5.000 eurosh, është i ulët për shkak të dëmtimit që ka pësuar automjeti nga aksidenti në dhjetor të vitit 2016. Shitësja, për shkaqe psikologjike, nga tronditja që pësoi për shkak të aksidentit, nuk donte që të vijonte ta mbante këtë automjet. Gjithashtu, subjekti sjell në vëmendje se çmimi është i tillë edhe për shkak të marrëdhënies familjare, pasi shitësja e automjetit është nusja e djalit të dajës (U. C.); (iii) ndërsa referuar dëmtimeve në automjet, subjekti në ankim dhe parashtrime evidenton se, në mbështetje të pretendimeve të saj, ka depozituar në Komision akte që provojnë riparimet e mjetit në dhjetor 2016, si dhe një raport vlerësimi të një inxhinieri të licencuar, i cili ka arritur në konkluzionin se automjeti i është nënshtruar një aksidenti, i cili ka ulur vlerën e tij, në çmimin që e ka blerë subjekti. Nga të dhënat e fashikullit të hetimit administrativ, si dhe nga përmbajtja e procesverbalit të seancës

⁵⁴ Në ankim, ashtu si edhe gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti ka deklaruar se shlyerja e shumës 5.000 euro nga blerësi I. B., e cila ngeli e pashlyer në dhjetor të vitit 2012 kur u lidh kontrata paraprake e shitjes së apartamentit në Fier, u shlye në vitin 2015, përtej afatit të përcaktuar në kontratën për shitje. PAGESA E VONESË E VLERËS 5.000 EURO DUKET SE KA GJETUR PASQYRIM NË DEKLARATËN NOTERIALE NR. {***} REP., NR. {***} KOL., DATË 17.1.2014, SIPAS SË CILËS DEKLAROHET SE: “Në bazë të kontratës për shitje, datë 6.12.2012, është lidhur një kontratë paraprake për blerjen e apartamentit me sip. 83,3 m², me nr. pasurie {***}, me vendndodhje në lagjen “{***}”, Fier, kundrejt vlerës së përgjithshme 73.000 euro. Sipas kontratës, z. I. B. i ka shlyer palës shitëse shumën prej 68.000 eurosh dhe i detyrohet edhe një vlerë në shumën prej 5.000 eurosh. Sipas kontratës, ky detyrim duhet t’i shlyej palës shitëse brenda muajit dhjetor 2013, por për arsye shëndetësore, ky detyrim nuk i është shlyer palës shitëse. Në këto kushte, pala shitëse ra dakord që kësti i fundit do të shlyej brenda vitit 2015. M. S. deklaroi se është dakord me sa më sipër, dhe se në momentin që pala blerëse do ta likuidojë atë me kështu të fundit do të realizohet kontrata përfundimtare e shitblerjes”.

dëgjimore, rezulton se subjekti ka dorëzuar gjatë seancës dëgjimore publike në Komisionin faturën nr. {***}, datë 23.12.2016, të cilën ka deklaruar se është gjendur në servis ku është riparuar automjeti ({***}) së bashku me fotot e mjetit të aksidentuar, si dhe një raport vlerësimi të automjetit me targë {***}, të hartuar nga ing. N. H. më datë 16.06.2021.

19.3 Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues, pasi mori në analizë deklaratimet e bëra nga subjekti në deklaratën *vetting*, në deklaratimet vjetore periodike, si dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, konstatoi se: (i) në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Automjet Volkswagen Golf, me targë {***}, blerë me kontratë⁵⁵ me nr. {***} rep., {***} kol., datë 24.01.2017. Vlera 5.000 euro. Burimi i krijimit: Automjeti është blerë me shumën e mbetur pa shlyer nga shitja e banesës 2+1 në Fier, të deklaruar në pikën 1 të D-Vetting, shumë e cila është paguar nga blerësi i banesës në fjalë në vitin 2016, në kohën e lidhjes së kontratës përfundimtare të shitjes;* (ii) në DVP-2016, subjekti ka deklaruar si të ardhur shumën 5.000 euro, me përshkrimin: *Të ardhura të realizuara nga pagesa e shumës së mbetur pa u shlyer nga blerësit e ap. 2+1 në lagjen "{***}" në Fier, pas shitjes përfundimtare të banesës me kontratën, datë 21.01.2016;* (iii) në DPV-2017, subjekti ka deklaruar: *Automjet "Volkswagen Golf", me targë {***}, blerë me kontratën me nr. {***} rep., {***} kol., datë 24.01.2017. Vlera 5.000 euro, përfituar nga pagesa e mbetur e pashlyer nga blerësi i ap. 2+1, ndodhur në lagjen "{***}", Fier. Pas shitjes përfundimtarë të banesës me kon. nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.01.2016, shumë kjo e deklaruar prej meje në deklarinimin e të ardhurave të vitit 2016.*

19.4 Lidhur me pretendimin e subjektit që i adresohet konkluzionit të burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, trupi gjykues, në reflektim të konkluzionit të arritur në paragrafin 17 dhe nënparagrafët e tij, lidhur me fiktivitetin e kontratës së shitjes së apartamentit në Fier në vitin 2016, në ndryshim nga Komisioni, përmes një analize të thjeshtë logjike, shkon në një konkluzion të ndryshëm edhe lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie. Siç u evidentua më lart, subjekti ka deklaruar në mënyrë konsistente se burimi i krijimit të kësaj pasurie është vlera e këstit të tretë të shitjes së pasurisë apartament, në vlerën prej 5000 eurosh, e cila është përfituar në fund të vitit 2016. Duke pranuar si më sipër arsyetuar, se shitja e apartamentit ka ndodhur, trupi gjykues arrin në konkluzionin se shuma e përfituar si këst i fundit të çmimit të shitjes së tij, vlerësohet si një burim i ligjshëm që justifikon blerjen e kësaj pasurie. Për pasojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi për të financuar me burime të ligjshme blerjen e automjetit "Volkswagen Golf", me targë {***}, në shumën 5.000 euro, më datë 24.01.2017.

19.5 Gjithashtu, në vijim, trupi gjykues mori në analizë edhe pretendimet e subjektit lidhur me qëndrimin e Komisionit se: *duke qenë se subjekti nuk arriti të provojë pretendimet e saj, në lidhje me aksidentin e pësuar në automjet, rezultoi se çmimi i blerjes së automjetit nuk paraqet vlerën reale të tij.* Lidhur me këtë çështje së pari, trupi gjykues konstatoi se në përmbajtjen e vendimit të Komisionit janë lënë jashtë vlerësimit të dhënat e akteve të paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ, siç janë ato që rezultojnë nga fatura e riparimit të automjetit me nr. {***}, datë 23.12.2016, lëshuar nga servisi "{***}". Përveç sa më sipër, rezulton se Komisioni, në mbështetje të qëndrimit se çmimi i blerjes së automjetit nga subjekti nuk përbën vlerën reale të tij, duket se nuk ka bërë as një analizë paraprake/hipotetike, se sa do të ishte

⁵⁵ Kontrata e shitblerjes së këtij automjeti nr. {***}, datë 24.1.2017, me shitëse Sh. C. (nusja e djalit të dajës U. C.).

vlera e këtij automjeti, sipas normave të amortizimit të aplikuara për mjetet motorike, dhe as ka vlerësuar, në versionin që pranohet se mjete është aksidentuar, sa mund të ketë ndikuar kjo ngjarje në vlerën e tij, krahas vlerës së amortizuar. Në kushtet e mungesës së një vlere të identifikuar nga Komisioni si vlera reale e automjetit në momentin e blerjes së tij nga subjekti, dhe mungesës së një hetimi dhe analize më të plotë rreth kësaj çështjeje, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit mbi vlerën e blerjes nuk gjendet plotësisht i argumentuar. Për më tepër, ky konkluzion i Komisionit nuk duket se asociohet me ndonjë prej parashikimeve të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në drejtim të ndikimit për një konkluzion në raport me kriterin e vlerësimit të pasurisë. Në kushtet e mësipërme, në mungesë edhe të një vlere të mundshme të përcaktuar prej Komisionit se duhet të kishte automjeti, trupi gjykues e gjen atë pa një peshë specifike lidhur me kriterin, e vlerësimit të pasurisë e të panevojshëm për t'u elaboruar më tej si pjesë e këtij arsyetimi.

19.6 Në përfundim, për këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson, në ndryshim nga Komisioni, se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme për të financuar blerjen e kësaj pasurie në vitin 2017. Konkluzioni i Komisionit rreth vlerës së çmimit të blerjes së tij u konsiderua prej trupit gjykues si jopërcaktues në vlerësimin e kësaj pasurie.

20 Në përfundim, trupi gjykues mori në shqyrtim edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj, me të cilat ajo *paraqet kundërshti në lidhje me analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 2003-2016, të cilën e konsideron jo të saktë dhe jo në përputhje me situatën faktike*. Për këto pretendime, trupi gjykues analizon sa vijon.

20.1 Në vendimin e Komisionit, për periudhën 2003-2016, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e një balance financiare negative për të përballuar investimet dhe kostot e jetesës në masën (-) 10.120.387 lekë. Trupi gjykues mori në analizë çdo pretendim lidhur me analizën financiare, duke arsyetuar si vijon.

20.2 Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për kursimet në *cash*, janë analizuar situatat si vijojnë.

(i) Subjekti pretendon që në DVP-në e vitit 2011 ka deklaruar kursime në shumën 200.000 lekë, nga të cilat 33.170 lekë janë në llogari bankare dhe pjesa tjetër duhet të konsiderohet si gjendje *cash*. Nga kontrolli i analizës financiare të kryer nga Komisioni, rezulton se pretendimi i subjektit për konsiderimin e shumës prej 166.830 lekësh si gjendje *cash*-i në vitin 2011, është njohur dhe reflektuar si e tillë në analizën financiare.

(ii) Subjekti pretendon që gjendja e *cash*-it prej 300.000 lekësh, e deklaruar si shtesë në vitin 2013, është pakësuar në fillim të vitit 2015 (datë 5.01.2015), nëpërmjet derdhjes që është bërë prej saj në shumën ekuivalente prej 2.050 eurosh në llogarinë pranë Intesa Sanpaolo Bank. Trupi gjykues, ashtu si edhe Komisioni, çmon se ky pretendim nuk mund të merret në konsideratë, pasi vetë subjekti shprehet në ankim se ky pakësim i gjendjes së *cash*-it është harruar të deklarohet në DVP-në e vitit 2015 e, në të tilla kushte, nuk mund të bëhet pjesë e analizës financiare, referuar detyrimeve për deklarim sipas ligjit nr. 9049/2003, si edhe jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit lidhur me interpretimin e deklarimeve për gjendjet *cash*.

(iii) Subjekti pretendon se ka përfituar shumën prej 5.000 eurosh, që përfaqëson këstin e fundit nga shitja e apartamentit në Fier, të cilin e ka deklaruar në DVP-në e vitit 2016 në seksionin “Të ardhura dhe angazhime në veprimtari publike dhe/ose private”, me përshkrimin: *Të ardhura të realizuara nga pagesa e shumës së mbetur pa shlyer nga blerësi i ap. 2+1, me sip.*

83,3 m², i ndodhur në Fier, pas shitjes përfundimtare të banesës me kontratën nr. {***}, datë 21.01.2016. Ndonëse nga subjekti nuk është deklaruar shtesë e gjendjes së *cash*-it prej 5.000 eurosh në DVP-në e vitit 2016, ajo pretendon të njihet përdorimi i kësaj shume si burim për blerjen e pasurisë automjet në janar të vitit 2017. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues, në reflektim të konkluzionit për përfitimin e shumës së siguruar nga shitja e apartamentit në Fier, si dhe në kushtet kur në deklaratën *vetting* dhe në DPV-në e vitit 2017, subjekti ka deklaruar se blerja e automjetit me targë {***}, më datë 24.01.2017, është financuar me shumën e fundit të shlyer nga shitja e apartamentit në Fier në vitin 2016, vlerësoi se kjo shumë është deklaruar në mënyrë të plotë dhe të saktë prej subjektit si burim krijimi për pasurinë automjet në muajin janar 2017, duke afektuar këto deklarime paralelisht edhe mënyrën se si duhet të kryhet analiza financiare për vitin 2016, në raport me gjendjen *cash*, ndonëse në këtë deklaratë shtesa e likuiditeteve nuk është deklaruar gjendje në fund të vitit.

20.3 Lidhur me pretendimet e subjektit se në analizën e kryer nga Komisioni ka pasur pasaktësi që lidhen me mosllogaritjen e saktë të gjendjes së llogarive bankare për periudhën 2008-2016, trupi gjykues analizon sa vijon.

(i) Nga verifikimi i të dhënave dhe korrespondencës me Raiffeisen Bank, rezulton se bashkëshorti i subjektit ka depozituar më datë 08.04.2010, shumën prej 1.000.000 lekësh, në depozitë 1-vjeçare, e cila është maturuar më datë 27.10.2011, në shumën prej 1.052.200 lekësh, (së bashku me interesat). Nga verifikimi i të dhënave të tabelës së analizës financiare të vendimit të Komisionit, rezulton se ky pretendim i subjektit është marrë në konsideratë nga Komisioni dhe, si i tillë, është konsideruar dhe nga Kolegji.

(ii) Në vitin 2016 (datë 31 dhjetor), shuma e likuiditeteve në bankë, të përfshira fillimisht në analizën financiare të Komisionit, ka qenë në vlerën 3.094.961 lekë, ndërkohë që gjendja e këtyre likuiditeteve e pretenduar nga subjekti përpara Komisionit, ishte në shumën 2.977.211 lekë. Nga verifikimi i analizës financiare në vendimin e Komisionit, rezulton se ky pretendim i subjektit për likuiditetet, i ngritur gjatë hetimit administrativ, nuk është marrë në konsideratë. Për rrjedhojë, mbështetur në të dhënat bankare të evidentuara më sipër, në analizën financiare të bërë në Kolegj, vlera e likuiditeteve në banka, më datë 31.12.2016, është përfshirë sipas pretendimit të subjektit, në shumën 2.977.211 lekë, e cila rezulton të jetë me diferencë të papërfillshme nga vlera e konsideruar nga Komisioni në analizën financiare, prej 3.094.961 lekësh.

20.4 Lidhur me pretendimin e subjektit se në analizën financiare të kryer nga Komisioni nuk janë përfshirë të ardhurat nga interesat bankarë për periudhën 2004-2016, nga kontrolli i analizës financiare të kryer në Komision, rezultoi se “të ardhurat nga interesat”, për vitet me diferencë negative përgjatë periudhës së sipërcituar, janë përfshirë në zërin “Të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit”. Paga e subjektit, sipas vërtetimit të lëshuar nga Gjykata Administrative e Apelit për vitin 2015, është në shumën 1.339.482 lekë, ndërsa në vitin 2016 është në shumën 1.378.494 lekë që, së bashku me interesat, në tabelën e Komisionit janë vendosur për vitin 2015, në shumën 1.514.357 lekë, ndërsa për vitin 2016, në shumën 1.395.509 lekë. Në këto kushte, edhe pse konstatohet vështirësi në identifikimin e përfshirjes së kësaj të ardhure në analizën financiare të Komisionit, trupi gjykues vëren se kjo e ardhur është bërë pjesë e saj, duke mos e ndikuar negativisht analizën për këtë shkak. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit duket se ka gjetur reflektim nga vetë Komisioni dhe se nuk ka kushte për ta korrigjuar këtë pjesë të analizës nga Kolegji.

20.5 Lidhur me pretendimin e subjektit se analiza financiare e Komisionit është ndikuar negativisht për shkak se në vitin 2007, shpenzimet për kosto jetese janë përfshirë dy herë më të larta se ato të vitit paraardhës 2006, trupi gjykues vlerëson se në funksion të kontrollit të analizës financiare të Komisionit, do të zbatohet metodologjia e përlogaritjes së shpenzimeve të jetesës për të gjitha vitet, duke përfshirë edhe vitin 2007, e cila është aplikuar deri aktualisht nga Kolegji. Kjo analizë referon në të dhënat që Kolegjit i janë vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja⁵⁶ për mënyrën se si ky organ ka përlogaritur shpenzimet e jetesës së subjekteve deklaruese të pasurisë, mbi bazën e të dhënave të INSTAT-it ndër vite për shpenzime bazike jetese. Në këto kushte, trupi gjykues e konsideron të paargumentuar pretendimin për të aplikuar në vitin 2007, kosto jetese më të ulëta se ato të INSTAT-it, edhe sipas një qëndrimi tashmë të konsoliduar e të gjithëpranuar nga jurisprudenca e Kolegjit.

20.6 Lidhur me pretendimin e subjektit se analiza financiare e Komisionit ka aplikuar shpenzime të larta për shkollimin e djalit të subjektit në Francë, trupi gjykues analizon sa vijon.

i. Subjekti pretendon në ankim për korrigjim të shpenzimeve të jetesës së djalit të saj (Eljor Sinanaj) gjatë periudhës së studimeve në Francë (2014-2016), pasi Komisioni ka përlogaritur shpenzime mujore 600 euro/muaj, shpenzime qiraje 400 euro/muaj, si dhe shpenzime shkollimi afërsisht 400 euro/vit. Ndërkohë, subjekti pretendon që në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga Komisioni, si dhe në deklaratimet periodike vjetore⁵⁷, ka shpjeguar se shpenzimet në total për *qira dhe kosto jetese*, kanë qenë rreth 600 euro/muaj, duke theksuar që shpenzimet e qirasë janë pjesë e shumës prej 600 eurosh dhe nuk duhet të llogariten si një shpenzim shtesë. Subjekti ka shpjeguar që në llogarinë bankare⁵⁸ të djalit në Francë, gjatë vitit 2015⁵⁹ janë dërguar 11.000 euro, nga të cilat janë shpenzuar 8.380 euro për qira, jetesë dhe shkollim, ndërsa pjesa e mbetur prej 2.620 eurosh është gjendje në llogari bankare në fund të vitit. Ndërsa gjatë vitit 2016, sipas subjektit, janë dërguar në llogarinë e djalit në Francë shuma prej 7.000 eurosh, nga të cilat janë shpenzuar 6.722⁶⁰ euro dhe pjesa e mbetur, prej 2.898 eurosh, është gjendje në llogari bankare në fund të vitit.

ii. Subjekti kërkon korrigjim të shpenzimeve të jetesës së djalit gjatë periudhës së studimit në Francë, kryesisht për dy vitet, 2015 dhe 2016 (të cilat, sipas analizës financiare, janë me rezultat negativ). Këtë pretendim subjekti e mbështetet në të dhënat që gjenden të publikuara në

⁵⁶ Me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 04.03.2019.

⁵⁷ **Në DVP-në e vitit 2014**, subjekti ka deklaruar: “Shpenzime jetese për djalin E. S. në qytetin {***}, Francë, për efekt të vazhdimit të studimeve të larta (përfshirë edhe qiranë e banesës), theksoj se tarifa vjetore e shkollës e paguar nuk kalon vlerën 300.000 lekë (< 400 euro). Shuma e shpenzuar rreth 550 euro/muaj.

- Hapur llogaria në LCL France, në emër të E. S., për efekt të transferimit të shpenzimeve për jetesë pasi ndjek studimet e larta në {***}, Francë. Gjendja më 31.12.2014, në shumën 155 euro”.

Në DVP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: “Shpenzime jetese për djalin E. S. në qytetin {***}, Francë, për efekt të vazhdimit të studimeve të larta (përfshirë edhe qiranë e banesës), theksoj se tarifa vjetore e shkollës e paguar nuk kalon vlerën 300.000 lekë (< 400 euro). Shuma e derdhur në llogarinë bankare në LCL Francë, 7.000 euro për vitin shkollor 2015-2016.

- Gjendja më 31 dhjetor 2015 në llogarinë bankare në LCL France, në emër të E. S., 2.620 euro.

Në DVP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “Shpenzime jetese për djalin E. S. në qytetin {***}, Francë, për efekt të vazhdimit të studimeve të larta (përfshirë edhe qiranë e banesës), theksoj se tarifa vjetore e shkollës e paguar nuk kalon vlerën 300.000 lekë (< 400 euro). Shuma e derdhur në llogarinë bankare në LCL France, shuma 7.000 euro për vitin shkollor 2016-2017.

- Gjendja më 31 dhjetor 2016 në llogarinë bankare në LCL France, në emër të E. S., 2.897 euro”.

⁵⁸ Subjekti ka përcjellë në Komision statement të llogarisë bankare në bankën LCL France të djalit, për periudhën nga 1 janar 2016 e në vijim.

⁵⁹ Shumat e transferuara në llogarinë bankare në Francë gjatë vitit 2015 (11.000 euro): 2.000 euro në datën 05.01.2015; 2.000 euro në datën 12.06.2015; 7.000 euro në datën 26.08.2015.

⁶⁰ Gjatë vitit 2016, është kredituar në llogari shuma prej 7.000 eurosh. Në bankë, më datë 1 janar kanë qenë 2.620 euro. Në bankë, më datë 31 dhjetor kanë qenë 2.898 euro. Shuma e debituar nga banka 6.722 euro.

adresën e {***} e cila është agjenci⁶¹ që ofron informacion dhe udhëzime për studentët e huaj që duan të studiojnë në këtë vend. Kjo agjenci informon se vlera totale e shpenzimeve mujore të një studenti është rreth 600-800 euro, vlerë në të cilën përfshihen shpenzimet e ushqimit, transportit dhe shpenzimet e banimit.

iii. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar gjatë hetimit administrativ që djali, për periudhën nëntor 2015 - prill 2017, ka përfituar subvencion⁶² nga shteti francez për kompensimin e shpenzimeve të qirasë në shumën 177 euro/muaj, të dhëna të cilat konfirmohen dhe nga vërtetimi i disponuar në fashikullin e Komisionit. Sipas subjektit, mbështetur në rrethanat e parashtruara me sipër, nuk ka arsye për të rritur shpenzimet e qëndrimit të djalit në Francë, pasi deklaratimet në DVP, shpjegimet gjatë procesit, si dhe informacioni që gjendet në portale, mbështesin masën e shpenzimeve të pretenduara nga subjekti, si dhe konfirmohen nga transfertat bankare.

20.7 Nga kontrolli i tabelës financiare, pjesë e vendimit të Komisionit, rezulton se në përllogaritjen e këtyre shpenzimeve, Komisioni është udhëhequr nga të dhënat e marra nga Eurostat, të cilat konfirmojnë një shpenzim mujor (akomodim dhe jetesës) në masën 1.041 euro/muaj për vitin 2015 dhe në 938 euro/muaj për vitin 2016. Ndërkohë që përllogaritja e bërë nga Komisioni duke konsideruar shpenzime qiraje në masën 400 euro së bashku me kompensimin e dhënë, si dhe shpenzime jetese në masën 600 euro, shkojnë në vlerën 970 euro/muaj për vitin 2015 dhe 938 euro/muaj për vitin 2016, vlera të cilat janë më të ulëta se vlera e Eurostat-it, dhënë për këtë qëllim. Gjithashtu Komisioni, mbështetur në të dhënat e *statement*-it të llogarisë bankare të djalit të subjektit pranë Bankës LCL në Francë, ka identifikuar vetëm për vitin 2016, një shpenzim mesatar mujor në shumën 578 euro, duke i zhveshur shpenzimet me vlerat e kredituara në kuadër të mbështetjes për reduktimin e qirasë nga shteti francez.

20.8 Lidhur me këtë pretendim të subjektit, duke i parë ato në raport me përllogaritjet e kostove të shkollimit të djalit të saj në Francë, sipas analizës së Komisionit, trupi gjykues konstaton se: **(i)** shpenzimet e shkollimit janë vlera të cilat nuk ankimohen nga subjekti pasi janë pagesa fikse të konfirmuara nga vetë subjekti nëpërmjet vërtetimeve të lëshuara ndër vite nga universiteti, të cilat janë pjesë e fashikullit gjyqësor; **(ii)** për shpenzimet e qirasë, edhe pse subjekti pretendon që për to nuk është aplikuar reduktimi i subvencionit⁶³ të dhënë nga shteti për vitin 2016, nga verifikimi i përllogaritjeve të bëra nga Komisioni, rezulton se ato janë marrë në konsideratë në vlerën e reduktuar të qirasë; **(iii)** për shpenzimet e jetesës në Francë, mbështetur në shpjegimet e dhëna në pyetësorë, si dhe në deklaratimet e bëra në DVP nga subjekti, pretendohet që këto shpenzime të kenë variuar nga 200⁶⁴ euro/muaj në 377 euro/muaj.

⁶¹ Informacion që, sipas subjektit, gjendet në adresën: <https://www.campusfrance.org/en/faq/what-is-the-cost-of-life-in-france>.

⁶² Sipas vërtetimit të dërguar në Komision, datë 28 shkurt 2019, nga "Caisse d'Allocation Familiales, CAF de Loire Atlantique".

⁶³ Viti 2014 – për 4 muaj kemi shpenzime qiraje prej: 4 muaj x 400 euro/muaj = 1.600 euro/vit (ekuivalent me 224.176 lekë), për vitin 2014 nuk ka subvencion nga shteti.

Viti 2015 – për 12 muaj kemi shpenzime qiraje prej: 12 muaj x 400 euro/muaj = 4.800 euro - (2 muaj x 177 euro subvencion) = 4.446 euro (ekuivalent me 611.992 lekë). Në vitin 2015 kemi vetëm 2 muaj subvencion nga shteti.

Viti 2016 – për 12 muaj kemi shpenzime qiraje prej: 12 muaj x 400 euro/muaj = 4.800 euro - (12⁶³muaj x 177 euro subvencion) = 3.030 euro (ekuivalent me 361.983 lekë). Vlera e komisionit për vitin 2016, prej 409.861 lekësh, do të korrektohet me vlerën 361.983 lekë, në të cilën është marrë në konsideratë rimbursimi i qirasë sipas vërtetimit të lëshuar nga CAF de Loire Atlantique për 12 muaj dhe jo sipas *statement*-it të bankës në të cilin janë rimbursuar vetëm 10 muaj.

⁶⁴ Sipas subjektit, shpenzimet janë 550-600 euro /muaj. Në muajt kur ka subvencion të qirasë, këto shpenzime duket të jenë maksimalisht 370 euro dhe minimalisht 200 euro.

Subjekti në përgjigje të pyetësorit, ka vënë në dispozicion *statement*-in e llogarisë bankare të djalit, ku veçanërisht viti 2016 është i detajuar në lidhje me debitimet dhe kreditimet e kryera, nga të cilat rezulton se shpenzimet mujore për jetesë, janë në vlera me të larta se shifra e pretenduar nga subjekti, prej 377 eurosh. Në këtë vit, janë depozituar 7.000 euro, që së bashku me gjendjen e llogarisë në fund të vitit 2015, kanë krijuar një buxhet nga i cili janë konsumuar vetëm 6.722 euro, të cilat të shpërndara gjatë vitit kalendarik 2016, përlllogariten si shpenzime mujore me rreth 560 euro në muaj. Nga *statement*-i i vitit 2016, rezulton që djali i subjekti të rivlerësimi të ketë kryer pagesa të ndryshme nga llogaria bankare, të cilat nuk janë pagesa qiraje, që do të thotë që shuma e vjetore e shpenzuar prej rreth 6.722 eurosh, të ketë shkuar për shpenzime të tjera të ndryshme nga ato të qirasë.

Në këto kushte, vlera e konsideruar prej Komisionit si kosto jetese, në shumën prej 600 eurosh/muaj, rezulton të jetë një vlerë e përafërt me vlerën që rezulton si shpenzim nga llogaria bankare, prej rreth 560 eurosh/muaj, e cila është përfshirë si kosto jetese në analizën e kryer në Kolegj. Duke qenë se për vitin 2015, nuk gjendet në dosje *statement*-i bankar, duke konsideruar me analogji të dhënat e vitit 2016 si të aplikueshme edhe në vitin 2015, i vetmi korrektim që vlerësohet se duhet t'i bëhet analizës financiare lidhur me shpenzimet e jetesës së djalit në Francë, është aplikimi i shumës prej 560 eurosh në muaj (6.722 euro në vit) si kosto jetese, korrektim i cili ndryshon shifrën e vitit 2015 në zërin "Shpenzime jetese në Francë", në shumën 925.008 lekë dhe në vitin 2016, në shumën 909.014 lekë.

20.9 Në funksion të kontrollit të analizës financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit nga Komisioni për vitin 2012, trupi gjykues mori në analizë edhe mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të shlyer me burime të ligjshme shumën e marrë hua prej 80.000 eurosh.

20.10 Lidhur me këtë moment, rezulton se Komisioni ka ngritur një sërë dyshimesh, të cilat duket se mbështeten mbi pabesueshmërinë e deklarimeve të subjektit lidhur me këtë financim, si për faktin e marrjes së huasë, shitjen e apartamentit, si edhe shlyerjen e huasë duke renditur disa argumente që pasqyrojnë këtë qëndrim të tij si vijon: **(i)** është e paqartë se përse shlyerja e huasë i është bërë z. U. C. nëse, siç deklarohet nga subjekti i rivlerësimit, "burimi" i huasë është z. A. C.; **(ii)** nuk ka asnjë provë që të vërtetojë se z. U. C. kishte një detyrim prej 80.000 eurosh ndaj z. A. C., për shkak të një huaje të marrë në vitin 1998; **(iii)** nuk është paraqitur asnjë provë që vërteton se z. A. C. ka autorizuar z. U. C. të marrë shumën për shlyerjen e huasë për llogari të tij; **(iv)** nuk ka asnjë provë ose mandat/dokument tjetër që të vërtetojë shlyerjen e huasë *cash*, e cila bie në kundërshtim me natyrën formale të transaksionit të zgjedhur për të marrë hua me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.01.2012, marrë në konsideratë edhe faktin që huaja është kthyer shumë më përpara se afati i dakordësuar; **(v)** së fundmi (kjo ngre, gjithashtu, pikëpyetje rreth vërtetësisë së gjithë veprimit), shuma që i është kthyer z. U. C., për llogari të z. A. C., deklarohet ende e disponuar nga z. U. C.; **(vi)** burimi i deklaruar për shlyerjen e huasë janë të ardhurat nga shitja e apartamentit, i cili, siç shpjegohet më sipër, dyshohet të jetë një transaksion fiktiv.

20.11 Trupi gjykues konstaton se arsyetimi i mësipërm lidhet me vlerësimin e Komisionit, kryesisht mbi dyshimet për fiktivitet të shitjes së apartamentit në Fier, si pasojë e të cilit është bërë e pabesueshme edhe shlyerja e huasë.

20.12 Trupi gjykues, në reflektim të qëndrimit të mësipërm lidhur me shitjen e pasurisë apartament në Fier, i cili është i ndryshëm nga ai i Komisionit, e gjen të pambështetur konkluzionin e Komisionit për mosbesueshmërinë e shlyerjes së huasë në vlerën 80.000 euro.

Duke pranuar logjikën që shitja e apartamentit ka ndodhur dhe çmimi i shitjes është përfituar prej subjektit, në mungesë të ndonjë investimi tjetër të financuar me këto para, gjendet i padrejtë konkluzioni se këto para nuk kanë shërbyer për të shlyer huanë, siç subjekti ka deklaruar. Shpjegimet e dhëna për kthimin e shumës të z. U. C. dhe jo të huadhënësi A. C., duket se kanë qenë në funksion të përcaktimit të burimit të krijimit të shumës së dhënë hua dhe jo aq shumë të dedikuara mënyrës së kthimit të saj, për të cilën subjekti nuk duket se ka pasur ndonjë kujdes të veçantë në dokumentimin e veprimit. Pavarësisht këtyre rrethanave, dhe transaksionit të kryer në *cash*, si një formë atipike për të kryer veprime juridike të kësaj natyre, në konsideratë dhe të marrëdhënies familjare mes palëve, element që duket se ka përcaktuar edhe modalitetet e ndërveprimit mes tyre, trupi gjykues vlerëson se ato janë të pamjaftueshme për të arritur në konkluzion se ky transaksion nuk është kryer dhe se e gjithë sjellja e subjektit është një mënyrë për të legjitimuar veprime që nuk kanë ndodhur.

20.13 Për sa më sipër, trupi gjykues, për efekt të kontrollit të analizës financiare për vitin 2012, të kryer nga Komisioni, përfshiu si të ardhur shumën 73.000 euro të siguruar nga shitja e apartamentit 2+1 në lagjen “{***}” në Fier dhe gjithashtu ngarkoi me shpenzime për shlyerjen e huasë në shumën 80.000 brenda të njëjtit vit financiar. Për rrjedhojë, nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezultoi se subjekti i rivlerësimi në vitin 2012 nuk gjendej në kushtet e mungesës së të ardhurave për shlyerjen e huasë, duke korrigjuar rezultatin financiar për këtë vit, pa ndikuar kjo në pamjaftueshmërinë e burimeve financiare për blerjen e apartamentit, për shkak të mosprovimit të burimeve të krijimit të shumës së marrë hua prej 80.000 eurosh, prej personit tjetër të lidhur. Në këto rrethana, vlen të nënvizohet fakti se rezultati financiar pozitiv për vitin 2012, përfaqëson vetëm një korrigjim matematikor të analizës financiare për këtë vit, por nuk shëron mungesën e burimeve për blerjen e apartamentit dhe as eliminon përgjegjësinë e subjektit për të,

20.14 Në përfundim të pretendimeve të subjektit lidhur me analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 2003-2016, trupi gjykues, në reflektim të sa analizuar më sipër, konstaton se: **(i)** subjekti ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për blerjen e apartamentit dhe garazhit në shumën (-) 9.478.040 lekë në vitin 2012, për shkak të mosprovimit të burimeve të ligjshme të krijimit të shumës së marrë hua; **(ii)** subjekti ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për një diferencë negative prej (-) 790.810 lekësh për mbulimin e shpenzimeve me të ardhura të ligjshme në vitin 2015; **(iii)** referuar korrigjimit të rezultatin financiar në vitin 2016, të nxjerrë nga Komisioni, si pasojë e konkluzioneve të mësipërme për shumën 5.000 euro, me burim nga shitja e apartamentit në Fier, mundësia financiare e subjektit për të mbuluar shpenzimet me të ardhura të ligjshme në fund të vitit, do të rezultojë me balancë pozitive prej (+) 267.147 lekësh.

- 21** Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues, pasi reflektoi në kontrollin e kësaj analize disa prej pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, konfirmoi rezultatin negativ të vitit 2015, si edhe mungesën e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë apartament në vitin 2012, duke e vendosur sërish subjektin në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
- 22** Në vlerësim dhe analizë të qëndrimeve të mësipërme, Kolegji arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk përmbush kriteret kushtetuese dhe ligjore për arritjen e një niveli të besueshëm në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, sipas kërkesave të nenit D, pikat 1, 3 të Aneksit të Kushtetutës. Konkluzionet e mësipërme e vendosin subjektin në kushtet e një

deklarimi të pamjaftueshëm të pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke passjellë vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit të tij nga detyra. Për pasojë, Kolegji arrin në përfundimin se vendimi nr. 417, datë 08.07.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është marrë mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi,

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 417, datë 08.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Sinanaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 30.04.2024

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi